

Dr. OLIVER BAKRESKI

Dr. ALEKSANDRA
DEANOSKA-TRENDAFILLOVA

KOMENT I

LIGJIT PËR

INFORMACIONE

TË KLASIFIKUARA

Dr. OLIVER BAKRESKI

Dr. ALEKSANDRA DEANOSKA-TRENDAFILLOVA

“

KOMENT I
LIGJIT PËR INFORMACIONE
TË KLASIFIKUARA

”

SHKUP, 2021

KOMENT I LIGJIT PËR INFORMACIONE TË KLASIFIKUARA

Autorë:

Dr. Oliver Bakreski
Dr. Aleksandra Deanoska-Trendafillova



Botues:

©DCAF, 2021

All rights reserved

DCAF – Geneva Center for Security Sector Governance

Chemin Eugène-Rigot 2E, CH-1202 Geneva, Switzerland

©DCAF, 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

DCAF – Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura – filiali Shkup

Rr. Maqedonia 11-1/2, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Për DCAF

DCAF - Qendra e Gjenezës për qeverisjen e sektorit të sigurisë është e përkushtuar në përmirësimin e sigurisë të shteteve dhe popullit të tyre në kuadër të qeverisjes demokratike, sundimit të së drejtës, respektimit të së drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar për një paqe dhe zhvillim më të qëndrueshëm duke u ndihmuar shteteve partnere dhe aktorëve ndërkombëtarë të cilët mbështesin këto shtete, që të përmirësojnë qeverisjen me sektorin e tyre të sigurisë përmes reformave përfshirëse dhe participative. Krijon produkte inovative të njohurisë, promovon norma dhe praktika të mira, jep këshilla juridike dhe politike dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve të përfshira nga sektori shtetëror dhe joshetëror i sigurisë.

Këshilli për themelimin e DCAF përbëhet nga përfaqësues të rreth 60 shteteve – anëtare dhe Kantonit të Gjenezës. Aktiv në mbi 80 vende, DCAF njihet ndërkombëtarisht si një qendër udhëheqëse për qeverisjen e përkryer me sektorin e sigurisë (SSG) dhe reformat në sektorin e sigurisë (SSR). DCAF udhëhiqet sipas parimeve të neutralitetit, paanshmërisë, pronësisë lokale, pjesëmarrjes inkluzive dhe barazisë gjinore. Për më shumë informacione vizitoni faqen www.dcaf.ch dhe na ndiqni në Twitter në @DCAF_Geneva.

DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance

Maison de la Paix

Chemin Eugène-Rigot 2E

CH-1202 Geneva, Switzerland

Tel: +41 22 730 94 00

info@dcaf.ch

www.dcaf.ch

 Twitter @DCAF_Geneva



Kingdom of the Netherlands



Sweden
Sverige



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
KREU I PARË	7
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	7
Kuptimi i shprehjeve të përdorura në këtë ligj	11
KREU I DYTË	17
KLASIFIKIMI I INFORMACIONEVE DHE NIVELET E KLASIFIKIMIT	17
Informacione të klasifikuara të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare	29
KREU I TRETË	31
KRITERE, MASA DHE AKTIVITETE PËR MBROJTJEN E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA	31
Siguria administrative	32
Siguria fizike	34
Siguria e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara	36
Siguria e sistemeve të komunikimit-informacionit	37
Siguria industriale	40
Shkëmbimi i informacioneve të klasifikuara me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare	42
Përdorimi i informacioneve të klasifikuara	44
Procedurat e lëshimit të certifikatave të sigurisë	50
Kohëzgjatja e certifikatave të sigurisë	56
KREU I KATËRT	66
AUTORITETET PËR MBROJTJEN E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA	66
Oficer i sigurisë së informacioneve të klasifikuara	66
Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara	70
Regjistrat dhe pikat e kontrollit	73
KREU I PESTË	80
PLANE DHE PROGRAME PËR PUNËN E DREJTORISË DHE FINANCIMI I DREJTORISË	80
KREU I GJASHTË	82
MBIKËQYRJA	82
KREU I SHTATË	99
DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE	99
Procedura e barazimit me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje	103
KREU I TETË	105
DISPOZITA NDËSHKUESE	105
Zbulimi i informacioneve të klasifikuara të nivelit "TËPËR SEKRET" dhe "SEKRET"	105
Zbulimi i paautorizuar i informacionit të klasifikuar të përdorur në procedurë gjyqësore ose në procedurë tjetër	107
KREU I NËNTË	109
DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	109

PARATHËNIE

Me vendosjen e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, u fuqizua sistemi ekzistues i mbrojtjes së informacioneve me interes për shtetin dhe u vendos një bazë e fuqishme për bashkëpunim kredibil me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e huaja sa u përket çështjeve me karakter sensitiv që kanë të bëjnë me sigurinë. Aktet normative për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara u miratuan me qëllim të vendosjes së praktikës pozitive për mbrojtjen e interesave kombëtare të sigurisë, me qëllim të parandalimit të shkaktimit të dëmit nga politika mbi sigurinë kombëtare dhe mbi interesat e shtetit, në mënyrë të qartë të përcaktohet ndarja e kompetencave dhe përgjegjësi, të përjashtohet abuzimi i mundshëm gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve të punës, të mundësohet kontroll efikas dhe sistem për sanksionim, si dhe sigurimi i fitimit të kredibilitetit të nevojshëm në punë.

Kuadri ligjor në Republikën e Maqedonisë së Veriut për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara korrespondon me standardet e NATO-s dhe BE-së. Implementimi i tij, si dhe rezultatet e mira nga puna e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, si autoriteti i vetëm për zbatimin e politikës së përcaktuar kombëtare dhe standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe për realizimin e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara në përputhje me procedurat e specifikuar, kontribuojnë në ngritjen e shkallës së sigurisë dhe në mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara si dhe në avancimin e edukatës së sigurisë tek të punësuarit në administratën shtetërore të cilët punojnë me informacione të kësaj natyre. Një gjë të këtillë e konfirmon edhe fakti se gjatë përgatitjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në NATO një rëndësi e madhe iu përkushtua avancimit të shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara si njëra nga llojet e bashkëpunimeve të privileguara me organizatat ndërkombëtare dhe me shtetet e huaja. Siguria e informacioneve të klasifikuara, po ashtu, është njëra nga çështjet kryesore të Kapitullit 31 – Politika e Jashtme e Sigurisë dhe e Mbrojtjes (PJSM) në kuadër të Programit Nacional për Miratimin e të Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA).

Ligji për informacione të klasifikuara për herë të parë u miratua në muajin mars të vitit 2004, ndërsa pastaj konform nevojave të cilat rezultonin nga zbatimi i tij i drejtpërdrejt në fushën që e rregullon ose për shkak të harmonizimit me ligjet e tjerë dispozitat e të cilëve duhet të inkorporohen në tekstin ligjor, u ndryshua

dhe plotësua disa herë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 09/04, 113/07, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18). Gjatë implementimit të Ligjit u detektua nevoja e inkorporimit të zgjidhjeve ligjore për harmonizimin me legjislacionin ekzistues në fusha të tjera (për shembull, kryerja e mbikëqyrjes inspektuese), për rregullimin e çështjeve të cilat paraprakisht nuk ishin përfshirë me aktet normative (për shembull, përdorimi i informacioneve të klasifikuara në procedurën gjyqësore ose në ndonjë procedurë tjetër), si dhe për inkorporimin e bazës ligjore për miratimin e aktit nënligjor i cili e rregullon kriptombrojtjen në vend. Për më tepër, në përputhje me proceset integruuese të vendit në NATO dhe BE, u detektua edhe nevoja për përcaktimin më të saktë të kompetencave të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në domenin e shkëmbimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me organizatat ndërkombëtare.

Në funksion të implementimit përkatës të standardeve të pranura ndërkombëtare për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, gjatë vitit 2018 në Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara u bë një analizë komparative të zgjidhjeve ligjore të 12 vendeve anëtare të NATO-s dhe BE-s me të cilat Qeveria e Republikës së Maqedonisë kishte nënshkruar marrëveshje bilaterale për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara. Në bazë të rezultateve nga analiza e bërë, nga përvojat e shkëmbyera me shërbimet simotra të vendeve të rajonit me të cilat Drejtoria ka zhvilluar një bashkëpunim të ngushtë, si dhe në bazë të përvojave të fituara nga leksionet e mësuara nga zbatimi i Ligjit që nga miratimi i tij në vitin 2004, në vitin 2018 u ngrit iniciativë për hartimin e tekstit të ri të Ligjit për informacione të klasifikuara.

Ligji i ri për informacione të klasifikuara në të cilin është sanksionuar Vendimi i Këshillit nga data 23 shtator i vitit 2013 në lidhje me rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të BE, CELEX numër 32013D0488, u miratua kah fundi i muajit dhjetor të vitit 2019 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/19), ndërsa i njëjti hyri në fuqi më datë 3 janar të vitit 2020.

Me këtë Ligj trajtohet sistemi i mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa theksi vihet mbi klasifikimin e informacioneve, përcaktimin e niveleve të klasifikimit, kriteret, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, shkëmbimin e informacioneve të klasifikuara me shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare, procedurat e lëshimit dhe kohëzgjatjen e certifikatave të sigurisë, autoritetet

për mbrojtje të informacioneve të klasifikuara, planet dhe programet e punës së Drejtorisë, kryerjen e mbikëqyrjes, dispozitat për kundërvajtje dhe ndëshkuese gjatë zbulimit të paautorizuar të informacioneve të klasifikuara, si dhe mbi çështje të tjera që kanë të bëjnë me sistemin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara.

Synimi për një sqarim të detajuar të risive të përfshira në këtë Ligj, si dhe dëshira që i njëjti të interpretohet në mënyrë të drejtë në kuptimin e idesë së tij themelore dhe përcaktimeve të vlerave e potencuan nevojën e hartimit të komentit të Ligjit. Në këtë koment, përveç interpretimit të dispozitave me të cilat rregullohen disa risi të rëndësishme të Ligjit, një vëmendje e posaçme do t'i përkushtohet edhe çështjeve të cilat e vënë në dukje nevojën e trajtimit të tyre plotësues me qëllim që të mos shkaktojnë mosmarrëveshje dhe dyshime gjatë zbatimit të Ligjit. Pikërisht në këtë drejtim, edhe pse ky koment u hartua menjëherë pas miratimit të Ligjit, synimi konsiston me atë që përmes këtij versionit të parë të stimulohet një debat plotësues i cili i plotësuar me përvojën praktike nga zbatimi i Ligjit, padyshim se do ta avancojë cilësinë e ndonjë edicioni të ardhshëm.

Komenti fillimisht u dedikohet përdoruesve të informacioneve të klasifikuara, megjithatë teksti gjithsesi se do të jetë një dokument i dobishëm edhe për të gjithë personat e tjerë të cilët do të trajnohen për punë me informacione të klasifikuara, për të punësuarit në sektorin e sigurisë, si dhe për studentët e drejtësisë dhe sigurisë dhe për punonjësit shkencorë.

Si autorë duam t'u shprehim falënderime Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) për mbështetjen dhe ndihmën për realizimin e këtij projekti, si dhe të gjithë lexuesve dhe përdoruesve qëllim-mirë të komentit të cilët me kritikën e tyre konstruktive ndaj tekstit të komentit do të kontribuojnë në procesin e analizës profesionale të dispozitave të përfshira në Ligjin për informacione të klasifikuara(*).

Autorët
Shkup, Mars 2021

LIGJI PËR INFORMACIONE TË KLASIFIKUARA(*)¹

KREU I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen klasifikimi i informacioneve, kushtet, kriteret, masat dhe aktivitetet që ndërmerren për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e krijuesve dhe përdoruesve të informacioneve të klasifikuara, shkëmbimi kombëtar dhe ndërkombëtar, mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji, si edhe çështje të tjera në lidhje me qasjen dhe trajtimin e informacioneve të klasifikuara.

Në kuadër të nenit të parë parimisht janë rregulluar çështjet të cilat janë objekt i rregullimit të Ligjit (*ratione materiae*). Është e evidente, se ky nen në mënyrë eksplicite e përcakton qëllimin themelor, përmbajtjen dhe çështjet sipas të cilave janë rregulluar kriteret, masat dhe aktivitetet që ndërmerren për mbrojtjen dhe sigurinë e informacioneve të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisve të krijuesve dhe përdoruesve të informacioneve të klasifikuara, shkëmbimin kombëtar dhe ndërkombëtar, mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji, si edhe çështje të tjera në lidhje me qasjen dhe trajtimin e informacioneve të klasifikuara. Megjithatë, përmbajtja e këtij neni, në masë të madhe, varet nga e drejta në kuptimin më të gjerë, përkatësisht nga ligje të tjerë me të cilët rregullohen një varg çështje që kanë të bëjnë me pozitën statusore-juridike të të gjithë personave fizikë dhe juridikë. Së këtijmi, çështjet të cilat janë rregulluar me këtë Ligj e determinojnë pozitën statusore-juridike dhe kauzalitetin e të gjitha marrëdhënieve të cilat paraqiten gjatë gjithë procesit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve deri te recipientët e fundit të informacioneve të klasifikuara të cilët në mënyrë eksplicite janë numëruar në këtë nen. Nevoja e qartë për shkëmbimin e informacioneve në mënyrë eksplicite theksohet nga niveli kombëtar deri në atë ndërkombëtar dhe anasjelltas ku në mënyrë evidente vjen në shprehje dominimi i qartë i koncepteve të këtilla në të gjitha legjislacionet bashkëkohore kombëtare, por edhe në aktet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me këtë materie.

Neni 2

Detyrim për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me këtë ligj kanë të gjithë përdoruesit të informacioneve të klasifikuara të cilët kanë pasur qasje dhe/ose janë njoftuar me përmbajtjen e tyre.

¹ Në Ligj transponohen dispozitat e Vendimit të Këshillit nga data 23 shtator 2013 në lidhje me rregullat e sigurisë së mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të BE-së (CELEX 32013D0488), kështu që i njëjti është përcaktuar në përputhje me Vendimin për caktimin e shenjës në aktet normative të Bashkimit Evropian në aktet nënligjore me të cilat bëhet harmonizimi me të drejtën e Bashkimit Evropian ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 38/10).

Ligji e përcakton detyrimin, përkatësisht obligimin që të gjithë përdoruesit e informacioneve të klasifikuara të cilët kanë pasur qasje dhe/ose kanë qenë të njoftuar me përmbajtjen e tyre ta mbrojnë përmbajtjen e informacionit. Detyrimi për mbrojtje e bartë me vete edhe përgjegjësinë e një personi në situatë kur nuk respektohen rregullat e përcaktuara ose nëse i njëjti nuk i kryen ose në mënyrë të pandërgjegjshme i mbron informacionet, dhe nëse lejon me ose pa dashje subjekte të tjerë të njoftohen me përmbajtjen e informacionit i cili ka detyrim të përgjithshëm që ta mbrojë. Duke pasur një natyrë lapidare, dispozita e nenit 2 ka rëndësi esenciale meqë pesha dhe rëndësia e detyrimit është supozim i nevojshëm për sjellje të ndërgjegjshme të personave të theksuar.

Detyrimi për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara ka rëndësi të jashtëzakonshme në kuadër të qasjes klasike në të cilën prevalojnë elementë të marrëdhënies profesionale dhe të shkallës së lartë të edukatës së sigursë, që do të thotë se mbrojtja duhet të perceptohet nga prizmi i proceseve kognitive të cilët, nga ana tjetër, në bazë implikojnë njohuri për sigurinë, mbrojtjen dhe rëndësinë e informacioneve etj. Këto janë gjykime të vlerave sa i përket sensitivitetit të punës dhe trajtimit të informacioneve të cilat kryesisht përfshijnë edhe kombinime të vlerave, standardeve dhe kritereve.

Në mënyrë që të reduktohet insuficienca potenciale e sjelljes së përgjegjshme, me ç'rast theksohet mbrojtja e informacioneve, vet qasja ndaj këtij problemi është e rëndësishme dhe implikon një proces kompleks brenda institucionit/institucioneve dhe personave fizikë dhe cili është orientimi i sigursë së përdoruesve i cili ka një sërë dimensionesh të cilat ndikojnë mbi procesin politik-të sigursë. Interpretimi i vetëm relevant nënkupton një mjedis të rregulluar demokratik-të sigursë në të cilin ka strukturë të ndërtuar hierarkike. Këtu, edukata e sigursë e implikon respektimin e rregullimit shtetëror, rregullimin e institucionit, rregullimin e vlerave, rregullimin e interesave etj. Së këtejmi, ambiciet e lartpërmendura në mënyrë të pashmangshme pasqyrohen edhe mbi individët, mbi grupet shoqërore dhe veçanërisht mbi elitat shoqërore, me ç'rast ndikohet në formimin e qasjes së tyre dhe mbi vet implementimin e qasjes në praktikën e sigursë. Nga ana tjetër, vetëm një qasje aktive shoqërore ndaj kësaj problematike do të kontribuojë në afirmimin dhe zhvillimin e postulateve themelore në të cilat aspekti i sigursë do ta bëjë hapin e nevojshëm që të rezultojë me akumulimin e kapitalit të edukatës-të sigursë nga individit drejt shoqërisë.

Detyrimi i mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara, siç është theksuar në nenin 2 u përket të gjithë përdoruesve të informacioneve të klasifikuara të cilët kanë pasur qasje dhe/ose kanë qenë të njoftuar me përmbajtjen e tyre, me vete e bartë përgjegjësinë dhe është relevant edhe nga aspekti juridiko-penal, përkatësisht bart me vete përgjegjësi juridike-penale për personat dhe subjektet juridikë të cilët do të kryejnë veprim të kundërligjshëm përmes abuzimit dhe dhënies/zbulimit të paautorizuar të informacioneve dhe rrjedhimisht me këtë, ata mund ta kenë përgjegjësinë për veprimin e kryer me çka do të mundësojnë që me përmbajtjen e informacionit të njoftohen persona të cilët zakonisht nuk duhet të vijnë në kontakt me informacionet e këtilla.

Neni 3

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i përdorimit të ligjshëm të informacioneve të klasifikuara dhe pamundësimi i çdo lloji të qasjes së kundërligjshme ose të paautorizuar, abuzimit dhe komprometimit të informacioneve.

Në nenin 3 në mënyrë eksplicite përcaktohet qëllimi i Ligjit i cili është në drejtim të sigurimit të përdorimit të ligjshëm të informacioneve të klasifikuara, pamundësisit dhe parandalimit të çdo lloji të qasjes së kundërligjshme ose të paautorizuar, abuzimit dhe komprometimit të informacioneve. Qëllimi, mes tjerash, e përshkruan imperativin e llojit të tij në punën e të gjitha subjekteve juridike të cilat kanë pika të përbashkëta dhe autorizime në fushën e informacioneve të klasifikuara, ndërsa të njëjtat janë edhe sfidë dhe detyrim për të gjithë ata që punojnë dhe janë të lidhur me institucionin i cili është më kompetent për ta udhëhequr procesin e përgjithshëm dhe ta sigurojë mbrojtjen e përgjithshme të informacioneve, dhe për këtë mund të identifikohen me qëllimin dhe objektivin e ekzistimit të tij.

Qëllimi i këtij ligji definohet si gjendje, situatë ose rezultat i caktuar specifik, megjithatë ekzistojnë edhe mekanizma sipas të cilëve matet realizimi i tij. Ky qëllim i përcaktuar në këtë mënyrë ofron efikasitet që duhet ta pamundësojë veprimin e kundërligjshëm, qasjen e paautorizuar, abuzimin dhe komprometimin, që nënkupton se duhet të sigurohet një qasje unike në sigurimin, ndërsa një gjë e këtillë kërkon ko-ekzistencë organizative.

Arritja e qëllimit e nënkupton edhe pjesëmarrjen dhe kontributin participativ, por edhe idenë si të stimulohet kreativiteti i cili në bazë e nënkupton inovacionin, vendosmërinë, si dhe ndërmarrjen e veprimit që të mundësohen ndryshimet në kuptimin e sigurisë së fjalës. Dalja nga kornizat dhe kushtet strikte ligjore për veprim nënkupton trajtim dhe abuzim të paautorizuar dhe të kundërligjshëm të informacioneve, ndërsa në disa raste mund të ketë madje edhe pasoja tepër serioze, skandale publike dhe ngjashëm, që e imponon nevojën sanksionimit serioz të personave kryerës të veprimeve të kundërligjshme. Nevojitet që detyrimet, autorizimet dhe funksionet e autoriteteve përgjegjëse të përcaktohen në mënyrë të qartë, me qëllim që puna e niveleve të ndryshme të hierarkisë të mbikëqyret dhe vlerësohet me sukses.

Neni 4

Dispozitat e këtij ligji zbatohen mbi informacionet e klasifikuara kombëtare dhe mbi informacionet e klasifikuara të pranuar nga shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare ose të krijuara në bashkëpunim të ndërsjellë nëse me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare), nuk është rregulluar ndryshe.

Kuptimi i nenit 4 konsiston me përcaktimin e shtrirjes, përkatësisht me kufirin deri ku shtrihet zbatimi i dispozitave të këtij ligji, kështu që ashtu siç është theksuar në nenin 4, dispozitat nuk janë kufizuar vetëm në informacionet e klasifikuara kombëtare, por edhe më gjerë, përkatësisht edhe në informacionet e klasifikuara të cilat janë pranuar nga shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare, si edhe me informacionet e klasifikuara të krijuara me bashkëpunimin e ndërsjellë nëse një gjë e këtillë nuk është rregulluar ndryshe me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare konform Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke e pasur parasysh faktin se marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare bëhen pjesë e të drejtës pozitive vendore.

Baza e vendosur në këtë mënyrë e jep kornizën e gjerë të përfshirjes për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacioneve të klasifikuara. Ky precizim i zbatimit të dispozitave në kuptimin e ndalimit implicit në situata të ndryshme e jep kornizën e zbatimit dhe subjektet

të cilët bashkëpunojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shkëmbejnë informacione të klasifikuara në drejtim të sigurimit të funksionit preventiv me qëllim të parandalimit të abuzimit të mundshëm.

Neni 5

Për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe për zbatimin e standardeve ndërkombëtare, për realizimin e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese të zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera nga fusha e informacioneve të klasifikuara, si dhe për kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me këtë ligj, kompetente është Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në tekstin në vijim: Drejtoria).

Në nenin 5 është vendosur kompetenca themelore e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, përkatësisht është apostrofuar e drejta dhe detyrimi (prej të cilave pastaj rezultojnë edhe ingerencat) i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në drejtim të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara. Për më tepër, për shkak të specifikës së materies dhe rëndësisë së madhe, para së gjithash nga aspekti i sigurisë, parashikohet ekzistimi i institucionit të veçantë i cili do ta mbështes dhe ruaj sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes së informacioneve (që e nënkupton aplikimin e qasjes dinamike dhe specifike të punës që duhet të jetë në korrelacion me politikën dhe strategjinë mirë të krijuar e cila do të mundësojë që veprimi dhe puna e përgjithshme të mbështetet mbi njohuritë dhe premisat profesionale, etike, legjitime dhe nga përvoja). Me këtë ndërlidhet edhe nevoja për një sinergji dhe dialektikë të qartë në drejtim të implementimit efikas të parimeve të punës të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave specifike. Nga strukturat udhëheqëse të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në mënyrë të veçantë kërkohet të krijojnë me kujdes dhe pa kushte një klimë për pranimin dhe organizimin në kohë të detyrave të punës në të gjitha nivelet e hierarkisë.

Në këtë kuptim, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare, si dhe për realizimin e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative nga fusha e informacioneve të klasifikuara, si dhe për kryerjen e punëve të tjera të përcaktuara me këtë ligj, përcaktohet, siç është theksuar më lartë, kompetenca e Drejtorisë.

Të qenit të përgatitur për operacionalizimin e detyrave konkrete në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e nevojshme e informacioneve fshehtësia e të cilave duhet të sigurohet, në të vërtetë në masë më të madhe varet nga puna e Drejtorisë.

Nga aspekti i realizimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara, Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara doemos duhet të posedojë pushtet dhe autoritet të mjaftueshëm që ta ushtrojë punën e vet, por jo në atë masë që të imponohet mbi sistemin ose të mbetet jashtë çdo kontrolli. Së këtijmi, përgjigjja normale e kësaj dileme potencon tre aspirata: legjitimiteti, profesionalizmi dhe përgjegjësia. Për më tepër, qëllimet kryesore janë fokusuar drejt legjitimitetit të vazhdueshëm, profesionalizimit të vazhdueshëm dhe përgjegjësisë së vazhdueshme. Të tre kushtet duhet të përmbushen në mënyrë kumulative që të flasin për ekzistimin e administrimit demokratik. Sjellja dhe

përgjegjësia profesionale e mbështesin legjitimitetin, ndërsa përgjegjësia e mundëson profesionalizmin, ndërkaq vet legjitimiteti e mundëson nivelin e nevojshëm të pavarësisë profesionale të Drejtorisë.

KUPTIMI I SHPREHJEVE TË PËRDORURA NË KËTË LIGJ

Neni 6

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon: 2

1. "Informacion" është informatë e cila mund të transferohet në cilëndo qoftë formë;³

2. "Informacion me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut" është çdo informacion i hartuar nga autoriteti i pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika dhe nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, personi fizik ose juridik, si dhe nga autoriteti i një shteti të huaj, përkatësisht nga personi i huaj fizik dhe juridik, i cili ka të bëjë me sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit, me integritetin territorial dhe sovranitetin e tij, me rendin kushtetues, interesin publik dhe me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit;

3. "Informacion i klasifikuar" është informacion nga fushëveprimi i punës së autoritetit të pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personit juridik të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit ose persona tjerë juridikë, e cila ka të bëjë me sigurinë publike, mbrojtjen, me punët e jashtme ose me aktivitetet e sigurisë apo të zbulimit të shtetit i cili në përputhje me ligjin duhet të mbrohet nga qasja e paautorizuar dhe është shënuar me nivelin përkatës të klasifikimit në përputhje me këtë ligj. Informacione të klasifikuara mund të jenë edhe dokumentet, mjetet teknike, makinat, pajisja, përkatësisht, komponenta të ndara ose armë apo vegla të cilat janë prodhuar ose janë në proces të prodhimit, si dhe zbulimet konfidenciale që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe janë në interes të sigurimit të shtetit;

4. "Dokument" është çdo tekst i shkruar, draft ose skicë, reproduksion, kopje, fotografi, regjistrim audio, regjistrim video, regjistrim magnetik, elektronik, optik, ose ndonjë lloj tjetër i regjistrimit i cili përmban informacione;⁴

5. "Dëm" është cenim i interesave të shtetit si pasojë nga rrezikimi i sigurisë së informacioneve të klasifikuara me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut ose të informacioneve të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut e ka për detyrë t'i mbrojë në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;

6. "Rreziku i sigurisë" është mundësia për çrregullimin e sigurisë së informacionit të klasifikuar;

7. "Siguria e informacioneve të klasifikuara" është përmbledhje e aktiviteteve dhe masave me të cilat sigurohet mbrojtja e informacioneve të klasifikuara nga qasja e paautorizuar dhe trajtimi i paautorizuar;

8. "Certifikatë sigurie për person fizik" është dokument me të cilin konfirmohet se për

² Për definimin e shprehjeve të këtij neni janë përdorur dispozitat e dokumenteve në vijim: Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-COR1-12, GLOSSARY, February 2013, *Amdt. no 9* и Council Decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information 32013D0488 (Official Journal of the European Union L274/1).

³ Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-COR1-12, GLOSSARY, February 2013, *Amdt. no 9*, стр. 3.

⁴ По аты.

personin fizik nuk ekziston rrezik i sigurisë për qasje dhe për trajtimin e informacioneve të klasifikuara;

9. "Certifikatë sigurie për person juridik" është dokument me të cilin konfirmohet se për personin juridik nuk ekziston rrezik i sigurisë dhe se posedon kapacitete fizike ose organizative për trajtimin e informacioneve të klasifikuara dhe/ose për ruajtjen e informacioneve të klasifikuara, në përputhje me ligjin;

10. "Leje për qasje në informacione të klasifikuara" është dokument me të cilin konfirmohet se personi i huaj fizik ose juridik posedon certifikatë sigurie të lëshuar në shtetin amë dhe ka të drejtë të qasjes dhe përdorimit të informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

11. "Duhet të dini" është parim sipas të cilit përcaktohet përdoruesi i cili ka nevojë për qasje në informacione të klasifikuara për shkak të kryerjes së funksionit ose të detyrës zyrtare dhe autorizimeve zyrtare, të veprimtarisë ose për zbatimin e marrëveshjeve të klasifikuara;⁵

12. "Krijues i informacionit të klasifikuar" është përpilues i autorizuar i informacionit të klasifikuar. Krijues të informacioneve të klasifikuara janë autoritetet e pushtetit shtetërorë dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, persona juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit dhe nga persona të tjerë fizikë dhe juridikë të cilët krijojnë informacione të rëndësishme për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe për aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit të shtetit;

13. "Diseminacioni i informacioneve të klasifikuara" e nënkupton shpërndarjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini" deri te personat të cilët posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë;

14. "Përdorues i informacionit të klasifikuar" është personi fizik ose juridik i cili ka nevojë për qasje në informacione të klasifikuara për shkak të kryerjes së funksionit, detyrës zyrtare dhe autorizimeve zyrtare apo për zbatimin e marrëveshjeve të klasifikuara dhe i cili posedon certifikatë sigurie, përkatëse me klasifikimin e informacionit.

15. "Trajtimi i informacioneve të klasifikuara" është proces i cili e përfshinë çdo veprim me informacionet e klasifikuara në kohëzgjatje të ekzistimit të tyre. Kjo e nënkupton krijimin, evidencën, transferimin, përdorimin, shpërndarjen, riklasifikimin, deklasifikimin, arkivimin dhe shkatërrimin.

16. "Brezi i sigurisë" është hapësira rreth objektit e cila e paraqet largësinë minimale nga objekti nga e cila mund të rrezikohen objektet dhe informacionet e klasifikuara brenda tij;

17. "Zona e sigurisë" është hapësirë ose ambient brenda objektit në të cilin trajtohet dhe në të cilin ruhen informacionet e klasifikuara deri në nivelin "SEKRET SHTETËROR" dhe ka nevojë për mbrojtje përkatëse fizike;

18. "Zona administrative" është hapësirë mbrojtëse e përcaktuar në mënyrë të qartë që përcaktohet përreth ose para zonave të sigurisë në të cilat ekzistojnë mundësi për kontrollin e personave dhe automjeteve.⁶

19. "Marrëveshje e klasifikuar" është çdo formë e marrëveshjes ose marrëveshje e cila buron nga e njëjta, duke i përfshirë edhe negociatat për lidhjen e të njëjtës, e cila

⁵ Po aty, f. 6.

⁶ Council Decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information 32013D0488 (Official Journal of the European Union L274/1), Annex II, PHYSICAL SECURITY, IV. Physically Protected Areas, точка 12.

përmban ose mundëson qasje në informacione të klasifikuara;

20. "Oficer i sigurisë së informacioneve të klasifikuara" është personi i autorizuar nga personi përgjegjës i autoritetit të pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit ose në personin juridik i cili e ka për detyrë të kujdeset për kryerjen e efikase dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve të cilat burojnë nga ky ligj;

21. "Siguria kriptografike" është komponentë i sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit e cila e përfshin mbrojtjen kriptografike, administrimin me materialet kriptografike dhe zhvillimin e metodave të mbrojtjes kriptografike, të cilat zbatohen përmes shifrave, kodit dhe nënshkrimit digjital;

22. "Mbrojtja kriptografike" është aktivitet operativ-planor në sistemin e materialeve dhe produkteve kriptografike të cilat përdoren për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara nga qasja e paautorizuar gjatë përpilimit, trajtimit dhe ruajtjes së informacioneve të klasifikuara;

23. "Produkt kriptografik" është softueri, sistemi ose instalimi me të cilin bëhet mbrojtja kriptografike;

24. "Materiale kriptografike (kriptomateriale)" janë algoritma kriptografikë, harduerë kriptografikë dhe module softuerike, kriptot çelësa, udhëzimet për implementimin e tyre dhe dokumentacioni shoqërues;⁷

25. "Akreditimi i sigurisë së sistemeve të komunikimit dhe informacionit" është proces i aprovimit formal të sistemeve të komunikimit-informacionit për punë deri në nivelin e caktuar të klasifikimit, në kushte të posaçme sigurie në mjedisin e tij operativ dhe në nivel të pranueshëm të rrezikut të sigurisë;

26. "Procesi i menaxhimit të rrezikut të sigurisë" është proces i identifikimit, kontrollimit, minimizimit ose eliminimit të ngjarjeve të cilat mund të ndikojnë mbi sigurinë e një organizate ose të sistemit të cilin ajo e përdor;⁸

27. "Sistemi i Komunikimit-Informacionit (SKI)" është çdo sistem i cili e mundëson krijimin, ruajtjen, trajtimin ose transferimin e informacioneve në formë elektronike. Sistemi i komunikimit-informacionit i përfshin të gjitha mjetet e nevojshme për funksionimin e tij, siç është infrastruktura, organizimi, personeli dhe resurset elektronike të informacionit, komunikimit dhe resurset e tjera elektronike.

Neni 6 i Ligjit i përfshin nocionet/termat, përkatësisht përmban definicione të nocioneve/termave të cilat e përbëjnë sistemin e kategorizimit të inkorporuar në Ligjin për informacione të klasifikuara(*).

Ekzistimi i listës së nocioneve, përkatësisht të nenit të veçantë për "kuptimin e shprehjeve" që është përfshirë në ligj është një element i ligjvënës që praktikohet në fillim të tekstit ligjor, në pjesën e dispozitave të përgjithshme i përcakton termat kryesorë, konceptet dhe shprehjet nga të cilët varet zbatimi i drejtë i Ligjit. Me këtë do të pengohet që në praktikë të paraqiten interpretime të ndryshme të ekzagjeruara ose interpretime fare të padrejta; në të vërtetë, në raste të kështilla vet ligjvënësi, i cili është më i thirruri në këtë drejtim, e jep interpretimin e nevojshëm, ndërsa në literaturën juridike kjo e nënkupton njërën nga format e interpretimit ligjor, përkatësisht të interpretimit

⁷ Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-COR13, GLOSSARY, February 2013, Amdt. no 9, crp. 2; Council Decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information 32013D0488 (Official Journal of the European Union L274/1), Appendix A, Definitions

⁸ Council Decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information 32013D0488 (Official Journal of the European Union L274/1), Appendix A, Definitions

autentik apo interpretim përmes të ashtuquajturave definicione legale.⁹ Në rastin konkret, siç është theksuar, bëhet fjalë për divergjencat terminologjike rreth nocioneve të cilat janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me materien ligjore dhe në mënyrë evidente janë në funksion të sqarimit të kategorive dhe nocioneve kryesore me çka në mënyrë të drejtpërdrejt do të kontribuohet në formimin e tablosë së plotë në mënyrë që të shmangen mëdyshjet gjatë zbatimit të Ligjit. Kjo dispozitë është më se e nevojshme nëse e marrim parasysh ligjin i cili rregullon një fushë jashtëzakonisht specifike dhe sensitive.

Në listën e nocioneve të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) janë definuar nocione që kanë të bëjnë me informacionin dhe informacionet e klasifikuara, terminologjinë e sigurisë, subjektet të cilat krijojnë, përdorin dhe trajtojnë informacione, zonën e sigurisë, termine që kanë të bëjnë me sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit etj. Domethënë, janë përcaktuar shumë termine dhe nocione me të cilat operon Ligji dhe të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për t'i kuptuar nocionet e realitetit të përgjithshëm të përcaktuar në tekstin e ligjit.

Zbatimi praktik së shpejti do të tregojë (duke e pasur parasysh faktin se ky ligj u miratua kah fundi i vitit 2019) se ligjvënësit a i është përvjedhur edhe ndonjë nocion i cili në praktikë do të paraqitet si i nevojshëm.

Nocionet kryesore të këtij ligji, siç janë: informacion, informacion me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe informacion i klasifikuar, janë nocionet e para të listës me 27-të nocione. Definicioni i parë ofron një pasqyrë dhe sqarim teorik të nocionit informacion si informatë në cilëndo qoftë formë.

Në alinenë 4 dhe alinenë 5 të nenit 6 është definuar dokumenti si formë e tekstit të shkruar, draft ose skicë, reproduksion etj., në të cilin janë përfshirë informacione; dhe dëmi i cili është cenim i interesave të shtetit si pasojë nga rrezikimi i sigurisë së informacioneve të klasifikuara me interes për Republikën e Maqedonisë së Veriut ose të informacioneve të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut e ka për detyrë t'i mbrojtë në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Në alinetë e ardhshme shqyrtohet siguria nga prizmi i rrezikut të sigurisë dhe sigurisë së informacioneve të klasifikuara. Marrë në përgjithësi, natyra e ndryshuar e rreziqeve të sigurisë e kushtëzoi nevojën e ridefinimit të sigurisë, megjithatë e imponoi edhe miratimin e qasjeve të reja të sigurisë. Duke e pranuar realitetin e këtillë, shtetet duhet t'u përshtaten rrethanave të reja me qëllim të mbrojtjes së interesave kombëtare dhe me qëllim të garantimit të nivelit optimal të sigurisë. Adaptimi i rreziqeve të sigurisë e shpreh edhe nivelin e lartë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara e që është përmbledhje e aktiviteteve dhe masave me të cilat sigurohet mbrojtja e informacioneve të klasifikuara nga qasja e paautorizuar dhe trajtimi i paautorizuar. Kjo kërkon inkluzion gjithëpërfshirës të të gjitha subjekteve të përfshira dhe që e realizojnë komponentën mbrojtëse.

Në alinetë 8 dhe 9 që kanë të bëjnë me certifikatën e sigurisë si dokument i cili e konfirmon se tek personi fizik ose juridik nuk ekziston rrezik për qasje dhe trajtim me informacione të klasifikuara precizohet se certifikatë sigurie për persona fizikë, në kuptimin e Ligjit, në të vërtetë e nënkupton lëshimin e dokumentit se personi fizik i përmbush kushtet që të qaset dhe trajtojë informacione të klasifikuara, ndërsa certifikata e sigurisë për persona juridikë është shumë preciz në argumentimin, përkatësisht bëhet fjalë për person juridik i cili posedon kapacitete fizike dhe organizative për trajtimin

⁹ Kambovski Vllado, E drejta penale - pjesa e përgjithshme, Shkup, 2011, f. 114.

dhe/ose ruajtjen e informacioneve të klasifikuara. Kjo nënkupton se nuk ekziston rrezik (kërcënime ndaj informacioneve) dhe nuk ka rrezik nga shkatërrimi, veprimi i kundërligjshëm, abuzimi dhe nga forma të tjera të veprimeve të dëmshme.

Në alinenë 10 në mënyrë decide, përmes lejes për qasje në informacionet e klasifikuara, konfirmohet se personi i huaj fizik ose juridik posedon certifikatë sigurie të lëshuar në shtetin amë dhe përcaktohet se ka të drejtë për qasje dhe përdorim të informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Leja ka implikime të mëdha gjatë kryerjes së veprimtarisë, përkatësisht mospasja e lejes përkatëse do ta pamundësojë personin fizik dhe juridik të përdor informacione të klasifikuara në vend. Nëse personi i huaj fizik ose juridik ka nevojë të përdorë informacione të klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, atëherë për një gjë të këtillë doemos duhet të sigurojë leje.

Në alinenë 11 është specifikuar parimi "duhet të dini" sipas të cilit përcaktohet përdoruesi i cili ka nevojë për qasje në informacione të klasifikuara për shkak të kryerjes së funksionit ose të detyrës zyrtare dhe autorizimeve zyrtare, kryerjen e veprimtarisë ose për zbatimin e marrëveshjeve të klasifikuara. Zbatimi i parimit („need to know“) është jashtëzakonisht i rëndësishëm në pjesën e dhënies së qasjes në informacionet e klasifikuara meqë posedimi i certifikatës së sigurisë ose rangui i lartë, ose funksioni i lartë i personit nuk e nënkupton qasjen e drejtpërdrejt në informacione të caktuara të klasifikuara.¹⁰

Në alinenë 12 definohet krijuesi i informacionit të klasifikuar i cili është përpilues i autorizuar i informacionit të klasifikuar. Si krijues të informacioneve të klasifikuara janë përfshirë autoritetet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, persona juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe persona të tjerë fizikë ose juridikë, të cilët krijojnë informacione të rëndësishme për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe për aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit të shtetit. Çdo informacion tjetër i cili nuk është krijuar nga krijuesi i informacionit në kuptimin e Ligjit nuk ka bazë juridike dhe nuk është autentik dhe në asnjë rast nuk mund të ketë nivel të klasifikimit.

Në alinetë e ardhshme definohet diseminacioni, përdoruesi dhe procesi i trajtimit të informacioneve të klasifikuara, përkatësisht shpërndarja e informacioneve të klasifikuara deri te personat të cilët posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë dhe veprimi me informacione të klasifikuara gjatë kohëzgjatjes së ekzistimit të tyre.

Në alinetë 16, 17 dhe 18 definohen ligjet përkatës të cilët përcaktojnë largësi minimale të definuar si brezi i sigurisë, hapësira ose ambienti brenda objektit në të cilën trajtohen dhe ruhen informacionet e klasifikuara e përcaktuar si zonë e sigurisë dhe hapësira e mbrojtur e përcaktuar si zonë administrative e cila duhet të vendoset përreth dhe para zonave të sigurisë.

Alineja 19 e precizon se çka kuptohet me "marrëveshje e klasifikuar" me ç'rast nënkuptohet që kjo bazë juridike të konsiderohet valide duhet të krijohet në formë të shkruar dhe t'i përmbush të gjitha karakteristikat e tjera të parashikuara me dispozita të tjera në akte të tjera relevante në lidhje me atë se si lidhet kjo marrëveshje midis palëve kontraktuese, nëse përmban në vetvete ose nëse mundëson qasje në informacionet e klasifikuara, megjithatë veçanërisht theksohet edhe ajo se krahas marrëveshjes, mund

¹⁰ Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-REV1, Enclosure "C", 20 November 2020, f. C-1, pika 4.

të klasifikohen edhe negociatat për lidhjen e të njëjtës, meqë edhe nga negociatat mund të fitohen informata që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara.

Alineja 20 e determinon kuptimin e oficerit të sigorisë së informacioneve të klasifikuara si person i cili e ka për detyrë të kujdeset për kryerjen efikase dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve të cilat rezultojnë nga ligji dhe është person i autorizuar nga personi përgjegjës në autoritetin e pushtetit shtetëror, nga personi juridik ose subjekti tjetër nga fushëveprimi relevant i subjekteve të përcaktuara me Ligj. Alinetë 21, 22, 23 dhe 24 i definojnë nocionet "siguria kriptografike" e cila është komponentë e sistemeve të komunikimit-informacionit, që nënkupton "mbrojtje kriptografike" si aktivitet operativ-planor, pastaj produkti kriptografik dhe materialet kriptografike të cilat janë algoritma kriptografikë, module kriptografike harduerike dhe softuerike, kriptopelësa, udhëzimet e implementimit të tyre dhe dokumentacioni shoqërues.

Alineja 25 e sqaron nocionin "akreditimi i sigorisë së sistemeve të komunikimit-informacionit" ndërsa ligjvënësi jep sqarime se bëhet fjalë për një proces të aprovimit formal të sistemeve të komunikimit-informacionit për punë deri në nivelin e caktuar të klasifikimit, në kushte të posaçme të sigorisë në mjedisin e tij operativ dhe në nivel të pranueshëm të rrezikut të sigorisë; ndërsa alineja 26 e sqaron procesin e menaxhimit të rrezikut të sigorisë me elementët determinues.

Në alinenë e fundit 27, sqarohet nocioni "sistemi i komunikimit-informacionit" i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm nga aspekti i asaj që e mundëson krijimin, ruajtjen, përpunimin ose transferimin e informacioneve në formë elektronike.

KREU I DYTË

KLASIFIKIMI I INFORMACIONEVE DHE NIVELET E KLASIFIKIMIT

Neni 7

Me klasifikimin e informacionit nënkuptohet niveli i mbrojtjes së informacionit i cili duhet të korrespondojë me shkallën e dëmit që mund të shkaktohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga qasja e paautorizuar ose nga përdorimi i paautorizuar të informacionit.

Informacionet të cilat janë objekt i klasifikimit veçanërisht kanë të bëjnë me: sigurinë publike; mbrojtjen; punët e jashtme; aktivitetet e sigursë, zbulimit dhe kundërzbulimit të shtetit; sisteme, instalime, zbulime, projekte dhe plane me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme; hulumtime shkencore dhe punë teknologjike, ekonomike dhe financiare me rëndësi për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me nenin 7 përcaktohet se klasifikimi i informacionit bëhet përmes përcaktimit të nivelit të caktuar të klasifikimit me ç'rast rregullohet se i njëjti duhet të korrespondojë me shkallën e dëmit që mund të shkaktohet ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut në rastet kur ndonjë person në mënyrë të paautorizuar do të qaset apo në mënyrë të paautorizuar do ta përdorte atë informacion. Sipas kësaj, ekziston proporcion ndërmjet nivelit të klasifikimit dhe dëmit potencial i cili mund të shkaktohet me mos-klasifikimin e tij.

Në paragrafin e dytë të nenit rregullohet se niveli i klasifikimit përcaktohet për informacionet që kanë të bëjnë me sigurinë publike; mbrojtjen; punët e jashtme; sigurinë, aktivitetet e zbulimit dhe kundërzbulimit të shtetit; sisteme, instalime, zbulime, projekte dhe plane me rëndësi për sigurinë publike; mbrojtja; punët e jashtme; hulumtime shkencore, punë teknologjike, ekonomike dhe financiare me rëndësi për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në kontekst të ngjarjeve që kanë të bëjnë me pandeminë globale shëndetësore me virusin COVID-19, parashtrohet pyetja e shtrirjes së nocionit siguria dhe cilat aspekte duhet t'i mbulojë, pastaj parashtrohet edhe pyetja për nevojën e mbrojtjes së informacioneve që kanë të bëjnë ose që kanë ndikim mbi shëndetin publik të popullsisë. Në një diskutim më të gjerë në lidhje me atë nëse informacionet e këtilla duhet të kenë nivel të klasifikimit të sigursë, përkatësisht a mund të konsiderohen si informacione që kanë të bëjnë me sigurinë publike, atëherë duhet të merret parasysh konteksti më i gjerë i nocionit siguri i cili në vetvete e përmban edhe konceptin e sigursë humane ose individuale e cila thënë me fjalë të tjera, fokusohet mbi sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve. Siguria humane identifikon disa kërcënime ndaj sigursë në mesin e të cilave

janë edhe kërcënimet mbi sigurinë shëndetësore të njerëzve, duke përfshirë sëmundje të ndryshme infektive dhe parazitore, probleme shëndetësore dhe sociale të shkaktuara nga mungesa e ujit të pastër dhe nga ndotja e ajrit, nga mos ekzistimi i mbrojtjes adekuate shëndetësore dhe ngjashëm. Rrjedhimisht me këtë, mund të identifikohet karakteri i sigurisë i informacioneve që kanë të bëjnë me shëndetin dhe me mbrojtjen shëndetësore të popullsisë dhe si të këtyra të kenë mbrojtje adekuate.

Në Ligjin për menaxhimin me kriza,¹¹ risqet që e rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve janë vënë në korrelacion me nocionin "rreziku i sigurisë së Republikës".

Njëherësh, Koncepti Kombëtar për Siguri dhe Mbrojtje nga viti 2003¹², në të cilin janë përcaktuar interesat e shtetit, në interesat vital me të cilat avancohet gjendja e sigurisë dhe me të cilët krijohen kushte për një jetë më të mirë të qytetarëve dhe për funksionimin e shtetit dhe shoqërisë, mes tjerash, i numëron edhe interesat e "mbrojtjes dhe avancimit të paqes dhe sigurisë, jetës, shëndetit, pronës dhe sigurisë personale të qytetarëve së Republikës së Maqedonisë".

Rrjedhimisht me këtë, në kontekstin e pandemisë globale shëndetësore e cila mund të rezultojë me çrregullimin e gjendjeve të brendshme të shtetit dhe të marrëdhënieve të tij në planin ndërkombëtar, me ç'rast nëse merret parasysh se shkalla e rrezikut dhe shkaktimit të dëmit mbi interesat vital të shtetit ndikon mbi përcaktimin e nivelit të klasifikimit të informacioneve, ligjvënësi duhet ta identifikojë karakterin e sigurisë të informacioneve që kanë të bëjnë me mbrojtjen shëndetësore të njerëzve dhe ta rregullojë mbrojtjen e tyre.

Neni 8

Klasifikimi i informacioneve bëhet sipas përmbajtjes së tyre.

Nivelin e klasifikimit të informacionit e përcakton krijuesi i informacionit, ndërsa me autorizimin e tij me shkrim edhe ndonjë person tjetër.

Informacioni shënohet me njërin nga nivelet e klasifikimit:

- ▶ SEKRET SHTETËROR,
- ▶ TEPËR SEKRET,
- ▶ SEKRET dhe
- ▶ INTERN.

Në nenin 8 është përcaktuar se klasifikimi i informacioneve bëhet sipas përmbajtjes së tyre dhe se krijuesi e përcakton nivelin e klasifikimit, ndërsa me autorizimin e tij me shkrim edhe ndonjë person tjetër. Ky është një rregull botërisht i pranuar në politikat e sigurisë për trajtimin e informacioneve të klasifikuara në NATO dhe BE, si dhe në politikat e sigurisë të vendeve të tyre anëtare, përkatësisht në politikat kombëtare të sigurisë. Në këtë nen janë specifikuar edhe nivelet e klasifikimit: SEKRET SHTETËROR, TEPËR SEKRET, SEKRET dhe INTERN.

Me miratimin e Ligjit për informacione të klasifikuara në vitin 2004 u bë një hap i rëndësishëm në aspekt të harmonizimit të niveleve të klasifikimit me nivelet ndërkombëtare të pranuar të klasifikimit dhe shfuqizimi i llojeve të kualifikimeve deri atëherë ekzistuese.

Ligji i ri për informacione të klasifikuara(*) e ndjek këtë zgjidhje, megjithatë duhet të harmonizohet mbrojtja juridike-penale dhe eventualisht zgjidhjet në ligje të tjerë për shkak të konsistencës. Me fjalë të tjera është inkriminuar zbulimi i sekretit shtetëror në nenin 317 të Kodit Penal, megjithatë nivelet e tjerë të klasifikimit nuk janë përfshirë, ndërsa ekzistojnë inkriminime për mbrojtjen e sekretit ushtarak dhe ngjashëm, që është një element i zgjidhjeve të mëhershme për momentin pa mbështetje në legjislacionin pozitiv.¹³

Neni 9

Informacioni i klasifikuar i nivelit "SEKRET SHTETËROR" është informacion zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë rrezikim dhe dëme të pariparueshme mbi interesat e përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "TEPËR SEKRET" është informacion zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëme jashtëzakonisht serioze mbi interesat vital të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "SEKRET" është informacion zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëm serioz mbi interesat e rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "INTERN" është informacion zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëm mbi punën e autoriteteve të pushtetit shtetërorë dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit, të cilët janë të rëndësishëm për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit të shtetit.

Në nenin 9 më për së afërmi janë rregulluar nivelet e klasifikimit në përputhje me rëndësinë e pasojave nga zbulimi i paautorizuar të përmbajtjes së informacioneve me çdo nivel të caktuar të klasifikimit. Për më tepër, interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat mund të rrezikohen me zbulimin e paautorizuar të informacioneve të klasifikuara janë harmonizuar me interesat e përcaktuara në konceptin Kombëtarë për Siguri dhe Mbrojtje.¹⁴

Së këtëjmi, është rregulluar se niveli "SEKRET SHTETËROR" i përcaktohet informacionit zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë rrezikim dhe dëme të parikuperueshme mbi interesat e përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut; niveli "TEPËR SEKRET" i përcaktohet informacionit zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëm jashtëzakonisht serioz mbi interesat vitale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa niveli "SEKRET" i përcaktohet informacionit zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëm serioz mbi interesat e rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Njëherësh, është rregulluar se niveli më i ulët i klasifikimit "INTERN" i përcaktohet informacionit zbulimi i paautorizuar i të cilit mund të shkaktojë dëm mbi punën e autoriteteve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika dhe nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, të cilët

janë me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit të shtetit.

Neni 10

Gjatë klasifikimit të informacionit, krijuesi, përkatësisht personi i autorizuar nga ai, duhet ta shënojë informacionin e klasifikuar me nivelin më përkatës të klasifikimit me të cilin sigurohet mbrojtja e nevojshme e interesave shtetërorë dhe siguria e nenit 9 të këtij ligji.

Përcaktimi i nivelit përkatës të klasifikimit të informacionit bëhet në bazë të vlerësimit të dëmit të mundshëm dhe pasojave të cilat mund të shfaqen nga qasja e paautorizuar te ai.

Në nenin 10 ligjvënësi e ka rregulluar detyrimin e krijuesit të informacionit, përkatësisht të personit të autorizuar nga ana e tij, ta shënojë informacionin e klasifikuar me nivelin më përkatës të klasifikimit me të cilin do të sigurohet mbrojtja e nevojshme e interesave shtetërorë dhe siguria të përcaktuara në nenin 9. Së këtejmi, e ka vënë në dukje se përcaktimi i nivelit përkatës të klasifikimit të informacionit bëhet në bazë të vlerësimit të dëmit të mundshëm dhe pasojave të cilat mund të shfaqen nga qasja e paautorizuar në informacion.

Qëllimi i dispozitave të këtij neni konsiston me reduktimin e tendencës së klasifikimit të tepërt të informacioneve e që pastaj rezulton me detyrime serioze për përdoruesit e informacioneve të klasifikuara në kuptimin e trajtimit dhe ruajtjes së të njëjtave. Njëherësh, kjo nënkupton edhe dhënie të rëndësisë më të madhe të procesit të vlerësimit të saktë të dëmeve të mundshme e që do të rezultojë me zgjedhjen më të drejtë të nivelit të klasifikimit.

Kjo zgjidhje është inkorporuar me ligjin e ri si rezultat i informatave nga analizat e bëra dhe përvojat e fituara nga praktikantët e zbatuara të trajtimit të informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat e vënë në dukje se krijuesit e informacioneve të klasifikuara për shkak të sigurisë më të madhe ose për shkak të mungesës së njohurive shpeshherë përcaktojnë nivel më të lartë të klasifikimit të informacioneve ose në raste të rralla madje pa nevojshëm i klasifikojnë informacionet. Me qëllim që t'u ndihmojë përdoruesve të informacioneve të klasifikuara gjatë përcaktimit të nivelit përkatës të klasifikimit të informacioneve, Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara hartoi Udhëzues për përcaktimin e nivelit të klasifikimit të informacioneve.¹⁵

Neni 11

Informacion të klasifikuar të nivelit "SEKRET SHTETËROR" përcaktojnë: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrat në kuadër të ministrive të tyre, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryeshefi i Shtatmadhorisë së Armatës së

¹⁵ Udhëzues për përcaktimin e nivelit të klasifikimit të informatave (i aksesshëm në: https://www.dbki.gov.mk/files/pdf_files/Vodic_za_odreduvanje_stepen_na_Kl.pdf).

Republikës së Maqedonisë së Veriut, drejtori i Agjencisë së Zbulimit, drejtori i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare, drejtori i Agjencisë Teknike Operative, drejtori i Qendrës për Menaxhimin me Kriza, drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara si dhe personat e autorizuar nga ana e subjekteve të lartpërmendura.

Nëse kështu është përcaktuar me ligj, me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare ose me ndonjë akt tjetër normativ, atëherë informacionin e klasifikuar të nivelit "SEKRET SHTETËROR" e përcaktojnë edhe personat e parashikuar në ato akte.

Në nenin 11 përcaktohen subjektet të cilët në përputhje me Ligjin janë të autorizuar ta bëjnë klasifikimin e informacioneve të nivelit më të lartë – "SEKRET SHTETËROR". Së këtejmi, në mënyrë taksative janë përcaktuar bartësit e funksioneve më të larta publike në shtet, përkatësisht Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrat në kuadër të ministrive të tyre, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryeshefi i Shtatmadhorisë së Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe drejtorët e autoriteteve shtetërore të cilët kanë kompetenca në domenin e sigurisë dhe mbrojtjes së shtetit përkatësisht drejtori i Agjencisë së Zbulimit, drejtori i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare, drejtori i Agjencisë Teknike Operative, drejtori i Qendrës për Menaxhim me Kriza, drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara.

Kjo dispozitë parashikon që nivelin "SEKRET SHTETËROR" të mund ta përcaktojnë edhe personat e tjerë të cilët janë të autorizuar nga subjektet e lartpërmendura.

Në paragrafin e dytë të këtij neni lihet mundësia që informacion të klasifikuar të nivelit "SEKRET SHTETËROR" të përcaktojnë edhe personat të cilët shprehimisht janë përcaktuar me ligj, me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare ose me ndonjë akt tjetër normativ.

Së këtejmi, parashtrohet pyetja a është zgjidhje e mirë mundësia të cilën ligjvënësi e ka përcaktuar edhe me akt tjetër që të caktohen persona të cilët do t'i përcaktojnë informacionet e klasifikuara të nivelit "SEKRET SHTETËROR", meqë kjo në të vërtetë do të nënkuptohet edhe me akte nënligjore të cilat miratohen shumë më lehtë, (nuk e kalojnë procedurën e miratimit të ligjeve) dhe në mënyrë potenciale ndryshohen më shpesh dhe më lehtë, të zgjerohet fushëveprimi i personave të cilët do t'i klasifikojnë informacionet me nivelin më të lartë të klasifikimit.

Ligjvënësi nuk i ka përcaktuar subjektet të cilat janë të autorizuar ta bëjnë klasifikimin e informacioneve të nivelit "TEPËR SEKRET" dhe "SEKRET", megjithatë në përputhje me aktet normative pozitive për organizimin dhe punën e autoriteteve të administratës shtetërore, nënkuptohet se ky është personi përgjegjës në subjektin ose personi i autorizuar nga ai për nënshkrimin e akteve, zgjidhjen e çështjeve të caktuara ose për kryerjen e punëve të tjera në kompetencë të autoritetit.¹⁶

Neni 12

Informacionet me zbulimin e të cilave mund të reduktohet efikasiteti i punës së

¹⁶ Ligji për organizimin dhe punën e autoriteteve të pushtetit shtetëror, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 96/19, 110/19, neni 47 dhe neni 52.

autoriteteve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika dhe nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, shënohen me "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR".

Shënimi "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" nuk është nivel i klasifikimit, megjithatë në informacionet e këtilla nuk lejohet qasje e lirë.

Mënyra e ruajtjes dhe trajtimit të informacioneve për përdorim të kufizuar më për së afërmi me Urdhëresë i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me nenin 12 definohet përcaktimi i shënimit "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" të informacioneve me zbulimin e të cilave mund të reduktohet efikasiteti i punës së autoriteteve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit. Ashtu siç është rregulluar në paragrafin e dytë të këtij neni, shënimi nuk paraqet nivel të klasifikimit, megjithatë, e kufizon qasjen publike deri te informacionet e këtilla.

Për më tepër, shënimi "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" u përcaktohet informacioneve të cilat përdoren për qëllime zyrtare madje edhe pse nuk e imponon nevojën e masave strikte për trajtimin dhe ruajtjen e informacioneve të këtilla, megjithatë, e vë në dukje mbrojtjen e nevojshme nga publikimi i tyre në publik. Me fjalë të tjera, me këtë në mënyrë të qartë delimitohen informacionet e këtilla nga ato informacione deri te të cilat mund të lejohet qasje e lirë.¹⁷

Në politikën e sigurisë së NATO-s informacionet e këtilla shënohen si UNCLASSIFIED, ndërsa në BE informacionet e këtilla shënohen me LIMITE. Për më tepër, në politikën e sigurisë së NATO-s dhe BE-së theksohet se shënimet nuk paraqesin nivel të klasifikimit por shënim për shpërndarjen e informacioneve i cili nënkupton trajtim me informacionet e këtilla nga ana e personave në kuadër të organizatës për qëllime zyrtare.

Për shkak të karakterit specifik të informacioneve me shënimin "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" në paragrafin e tretë të këtij neni parashikohet Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Urdhëresë për së afërmi ta rregullojë mënyrën e ruajtjes dhe trajtimit të informacioneve të këtilla.

Neni 13

Nëse në një informacion janë përfshirë të dhëna për më shumë nivele të klasifikimit, krijuesi e ka për detyrë ta përcaktojë nivelin e klasifikimit të secilit veç e veç.

Tërësia e informacionit klasifikohet sipas nivelit më të lartë të klasifikimit, ndërsa në faqen e parë të materialit shënohen pjesë të tjera me nivele të klasifikimit të cilat i përkasin informacionit.

Nëse një pjesë e dokumentit përmban informacion të klasifikuar me nivel më të lartë të klasifikimit, kjo pjesë mund të veçohet si dokument i veçantë me nivel përkatës

¹⁷ Për atë se cilat informacione mund të konsiderohen si informacione deri te të cilat lejohet qasje e lirë, Ligji për qasje të lirë deri te informacione të karakterit publik, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër, 101/19.

të klasifikimit.

Fusnotat nuk klasifikohen përveç nëse përmbajnë ose zbulojnë informacione të klasifikuara.

Me qëllim të shmangies së rriskut të sigurisë përdorimi i fusnotave duhet të jetë në minimum.

Në nenin 13 rregullohet mënyra e klasifikimit të një informacionit i cili përbëhet nga pjesë të cilat kanë nivel të ndryshëm të klasifikimit.

Dispozitat e nenit e vënë në dukje detyrimin e krijuesit që ta përcaktojë nivelin e klasifikimit të çdo pjesë të informacionit veç e veç, ndërsa tërësinë e informacionit ta klasifikojë sipas nivelit më të lartë të klasifikimit. Së këtejmi, krahas nivelit më të lartë me të cilin e klasifikoi informacionin, krijuesi e ka për detyrë në faqen e parë të materialit t'i shënojë pjesët e tjera me nivele të klasifikimit të cilat i përkasin informacionit. Me këtë, trajtuesit e ardhshëm të informacionit të klasifikuar do ta kenë të qartë, varësisht nga niveli më i lartë, se si veprohet me informacionin integral, por edhe se përmbajtja e tij është e ndryshme sa i përket klasifikimit.

Në paragrafin e tretë të këtij neni është përcaktuar mundësia një pjesë e dokumentit i cili përmban informacion të klasifikuar me nivel më të lartë të klasifikimit të mund të veçohet si dokument i veçantë me nivel përkatës të klasifikimit. Nga ana tjetër, nëse nevojitet të zbatohen masa të rrepta të mbrojtjes vetëm për një pjesë të informacionit të klasifikuar, me ndarjen e tij në dokument të veçantë mundësohet një trajtim më i lehtë me pjesët e tjera të informacionit të klasifikuar të cilat fare nuk kanë nivel ose kanë nivel më të ulët të klasifikimit.

Në praktikë, gjatë punës me informacionet e klasifikuara kombëtare rrallëherë ndodhë ndarja e pjesëve të informacionit të klasifikuar si dokument i veçantë, megjithatë një gjë e këtillë është praktikë e zakonshme gjatë punës me informacione të klasifikuara në NATO-s.¹⁸

Në këtë nen rregullohet edhe përdorimi i fusnotave, me ç'rast vihet në pah se ato sipas rregullit nuk duhet të klasifikohen përveç nëse përmbajnë ose zbulojnë informacione të klasifikuara, ndërsa me qëllim të shmangies së rriskut të sigurisë, dispozita e paragrafit të pestë të këtij neni vë në dukje se përdorimi i tyre duhet të jetë në minimum.

Për shkak të faktit se fusnotat paraqesin referenca, përkatësisht çdoherë ndërliiden me tekstin bazik, praktikisht është vështirë të realizohet e gjithë mbrojtja në praktikë nëse teksti është i klasifikuar, ndërsa fusnota e tekstit nuk është, apo nëse hipotetikusht ka nivele të ndryshme të klasifikimit të tekstit nga fusnota. Së këtejmi, është pragmatik orientimi i përcaktuar në paragrafin e fundit të këtij neni që ka të bëjë me shmangien e përdorimit të fusnotave në informacionet e klasifikuara.

Neni 14

Krijuesi i informacionit të klasifikuar detyrimisht e shënon në vend të dukshëm nivelin e klasifikimit, në përputhje me këtë ligj.

¹⁸ Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-REV1, Enclosure "E", 20 November 2020, стр. E-2, точка 12.

Në nenin 14 ligjvënësi e ka parashikuar detyrimin e krijuesit të informacionit të klasifikuar nivelin e klasifikimit të tij detyrimisht ta shënojë në vend të dukshëm. Një gjë e këtillë është e rëndësishme nga aspekti i vizibilitetit më të lehtë dhe më të shpejtë të faktit se bëhet fjalë për informacion të klasifikuar, si dhe për cilin nivel bëhet fjalë, me ç'rast do të parandalohen rastet e qasjes neglizhente.

Shënimi i informacionit të klasifikuar detajisht rregullohet në aktin nënligjor në të cilin janë përcaktuar masat e domenit të sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara.

Neni 15

Nëse informacioni nuk ishte i shënuar me nivelin e klasifikimit, ndërsa krijuesi nuk mund të përcaktohet ose ka pushuar së ekzistuari, klasifikimin e informacionit e bën pasardhësi juridik i krijuesit.

Nëse nuk mund të përcaktohet as pasardhësi juridik nga paragrafi 1 i këtij neni, atëherë shënimin e nivelit të informacionit të klasifikuar e bën Drejtoria.

Në rastin kur informacioni nuk është shënuar me nivelin e klasifikimit, ndërsa krijuesi nuk mund të përcaktohet ose ka pushuar së ekzistuari, ligjvënësi në nenin 15 ka parashikuar se klasifikimin e informacionit e bën pasardhësi juridik i krijuesit, ndërsa nëse nuk mund të përcaktohet as pasardhësi juridik, ligjvënësi ka përcaktuar se shënimin e nivelit të informacionit të klasifikuar e bënë Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara.

Baza e arsyeshmërisë së zgjidhjes së këtillë të ligjvënësit korrespondon me nenin 5 të Dispozitave të përgjithshme ku Drejtoria specifikohet si autoritet kompetent për implementimin e politikës së sigurisë në lidhje me mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe kryerjen e punëve të rregulluara me këtë ligj, ndërsa qëllimi konsiston me atë që çdoherë kur ka nevojë që të klasifikohet ndonjë informacion i caktuar të ekzistojë zgjidhje për atë se kush do të jetë subjekti i autorizuar në rastin e pamundësisë së përcaktimit ose në rastin e mosekzistimit aktual të krijuesit së informacionit.

Ligjvënësi këtu nuk e ka parashikuar rolin e Drejtorisë në rastin kur nevojitet të riklasifikohet ose të deklasifikohet informacioni i klasifikuar krijuesi i të cilit nuk mund të përcaktohet ose ka pushuar së ekzistuari.

Neni 16

Me riklasifikim bëhet ndryshimi i nivelit të klasifikimit të informacionit.

Ndryshimin e nivelit të klasifikimit e bën krijuesi ndërsa me autorizimin e tij me shkrim edhe ndonjë person tjetër.

Për ndryshimin e nivelit të klasifikimit të informacionit detyrimisht njoftohen përdoruesit e informacionit.

Mënyra e ndryshimit të nivelit të klasifikimit të informacionit më për së afërmi me Urdhëresë e rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 16 në të vërtetë definohet nocioni riklasifikim dhe rregullohet procedura e riklasifikimit, përkatësisht ndryshimi i nivelit të klasifikimit të informacionit, të cilën gjë e bën krijuesi i informacionit ose personi i autorizuar nga ai. Së këtejmi, ligjvënësi nuk e specifikon në mënyrë precize në cilin drejtim duhet të zhvillohet ndryshimi, përkatësisht se ndryshimi i nivelit të klasifikimit të informacionit duhet të shkojë nga niveli më i lartë në nivel më të ulët të klasifikimit, e që në të vërtetë është objektivi i procedurës së riklasifikimit. Nuk është logjike informacioni i shënuar me nivel më të ulët të klasifikimit dhe si i këtillë ka qenë i aksesshëm për një rreth të caktuar të përdoruesve, në mënyrë plotësuese të mbrohet me nivel më të lartë të klasifikimit, ndërsa rrjedhimisht me këtë edhe me masa plotësuese për mbrojtjen dhe kufizimin e qasjes.

Në paragrafin e tretë të nenit përcaktohet detyrimi që për ndryshimin të njoftohen të gjithë përdoruesit e informacionit të klasifikuar. Detyrimi i këtillë është përcaktuar me qëllim që të sigurohet mbrojtje përkatëse e informacionit të klasifikuar, veçanërisht nëse është rritur niveli i mbrojtjes, por gjithashtu edhe të shmangët përdorimi i më shumë resurseve nga e nevojshmja për këtë qëllim ose përgjithësisht, nëse është përcaktuar nivel më i ulët i klasifikimit.

Dispozita e paragrafit të katërt të këtij neni parashikon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për së afërmi me Urdhëresë ta rregullojë mënyrën e ndryshimit të nivelit të klasifikimit të informacionit, me ç'rast jepet mundësia për rregullimin e detajuar të procedurës dhe operacionalizimi i kësaj dispozite dhe procedurës në aktin nënligjor. Mënyra e ndryshimit të nivelit të klasifikimit të informacionit është objekt rregullimi në aktin nënligjor në të cilin janë përcaktuar masat nga domeni i sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara.

Neni 17

Klasifikimi i informacionit pushon:

- ▶ në datën e shënuar në dokument,
- ▶ me ndodhjen e ngjarjes së caktuar të theksuar në dokument,
- ▶ me skadimin e periudhës kohore të shënuar në dokument dhe
- ▶ me deklasifikim.

Në nenin 17 ligjvënësi i përcakton mënyrat sipas të cilave mund të pushojë, përkatësisht të përfundojë klasifikimi i një informacioni, pastaj përcakton se klasifikimi i informacionit pushon në datën e shënuar në dokument, me ndodhjen e ngjarjes me të cilën ka të bëjë dokumenti, me skadimin e periudhës kohore të shënuar në dokument dhe me deklasifikim.

Në të vërtetë, këto janë disa mënyra me të cilat pushon klasifikimi, dhe jo kushte të përcaktuara kumulative të cilat duhet të përmbushen për pushimin e klasifikimit. Me fjalë të tjera, tek informacione të caktuara mund të theksohet data e saktë se kur do të pushojë klasifikimi, por tek informacione të tjera kjo gjë nuk është e mundshme meqë ndërlidhen me ngjarje për të cilën paraprakisht nuk mund të dihet se kur do të ndodhë, ndërsa tek informacione të treta përcaktohet periudha kohore, ndërsa tek disa informacione të tjera do të bëhet deklasifikimi.

Me rregullimin e pushimit të klasifikimit të informacionit ofrohet mundësia që i njëjti të jetë i aksesshëm për publikun meqë tanimë nuk ekziston rreziku që të rrezikohet ose cenohet ndonjë interes i caktuar i shtetit, ndërsa në mënyrë plotësuese me këtë

të kursehen resurse që do të dedikoheshin për mbrojtjen e mëtutjeshme të tij. Aksesit i publikut veçanërisht e nënkupton aksesin në informacion për qëllime shkencore, për hulumtime dhe analiza.

Neni 18

Me deklasifikimin bëhet ndryshimi i informacionit të klasifikuar në informacion i cili është i paklasifikuar.

Deklasifikimin nga paragrafi 1 të këtij neni e bën krijuesi i informacionit ose personi i autorizuar nga ai, për çka detyrimisht i njofton përdoruesit e informacionit.

Mënyrën e deklasifikimit të informacionit me për së afërmi me Urdhëresë e rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 18 është rregulluar procedura e deklasifikimit të informacionit të klasifikuar me ç'rast i njëjti bëhet i paklasifikuar. Në të vërtetë bëhet fjalë për njërin nga shumica e mënyrave me të cilat pushon klasifikimi i një informacioni.

Sipas rregullit, ndryshimin e nivelit të informacionit të klasifikuar mund ta bëjë krijuesi ose personi i autorizuar nga ai, dhe rrjedhimisht me këtë ligjvënësi përcakton se edhe vet deklasifikimin e bën krijuesi i informacionit ose personi i autorizuar nga ai. Ashtu si edhe në rastin e procedurës së riklasifikimit të informacionit të klasifikuar, dispozita e paragrafit të dytë të këtij neni parashikon që përdoruesit detyrimisht të njoftohen për informacionin e deklasifikuar. Me qëllim të rregullimit më të detajuar të procedurës së deklasifikimit, në paragrafin e tretë të këtij neni përcaktohet që Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Urdhëresë më për së afërmi ta rregullojë mënyrën e deklasifikimit të informacionit. Ky është objekt i rregullimit në aktin nënligjor në të cilin përcaktohen masa nga domeni i sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara.

Praktika tregon se procedura e deklasifikimit nuk zbatohet shpesh, megjithatë ka përvoja nga puna me informacione të klasifikuara në NATO, ku ekziston një Komitet i posaçëm përmes të cilit zbatohet deklasifikimi i informacioneve të klasifikuara në NATO.¹⁹

Për nevojat e procedurave gjyqësore (më saktësisht për procedurën penale), tek ne shpeshherë deklasifikohen provat e siguruar përmes përdorimit të masave të posaçme hetuese (MPH) të cilat paraprakisht, sipas rregullit, klasifikohen. Me këtë, de facto ato bëhen informacione të paklasifikuara, kështu që për shkak të pengimit të qasjes së lirë, përkatësisht kufizimit të qasjes deri te të njëjtat ndodhë që t'u përcaktohet shënimi "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR". Megjithatë, ky shënim nuk është nivel i klasifikimit. Konsiderojmë se nevojiten diskutime dhe trajnime plotësuese në këtë domen për të gjitha subjektet relevante, meqë këtu në mënyrë legjitime parashtrohen disa pyetje: së pari, për shembull ky shënim a është bazë e mjaftueshme për përjashtimin e publikut dhe së dyti a ka nevojë për deklasifikimin e të gjitha informacioneve paraprakisht të klasifikuara në këto raste (procedura penale), kur ligji përcakton që të njëjtat të mund të përdoren si të klasifikuara me përjashtimin e publikut?

Në këtë drejtim, autoritetet e jurisprudencës, por edhe krijuesit e informacioneve të klasifikuara për nevojat e drejtësisë penale, në mënyrë të veçantë duhet t'i kenë

¹⁹ ARCHIVES COMMITTEE, Directive on the Public Disclosure of NATO Information, AC/324-D(2014)0010-REV2, 16 January 2018

parasysh dispozitat e nenit 63 dhe nenit 104 të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) dhe dispozitat e nenit 354 të Ligjit për procedurë penale.

Neni 19

Krijuesi i informacionit të klasifikuar e shënon periudhën kohore ose ngjarjen pas të cilës informacioni mund të riklasifikohet ose të deklasifikohet.

Periudha kohore ose ngjarja pas të cilës informacioni i klasifikuar mund të rikualifikohet ose deklasifikohet nuk mund ta tejkalojë periudhën kohore prej dhjetë vitesh, përveç në rastin kur informacionit të klasifikuar i nevojitet mbrojtje më e gjatë e përcaktuar me ligj.

Në nenin 19 theksi vendoset mbi detyrimin e krijuesit të informacionit të klasifikuar ta shënojë periudhën kohore ose ngjarjen pas së cilës informacioni mund të riklasifikohet ose të deklasifikohet, me ç'rast e përcakton se të njëjtat nuk mund ta tejkalojnë periudhën kohore prej dhjetë vitesh, përveç në rastin kur informacionit të klasifikuar i nevojitet mbrojtje më e gjatë e përcaktuar me ligj.

Qëllimi i kësaj dispozite konsiston me atë që t'u ofrojë orientim krijuesve të informacioneve të klasifikuara për nevojën e rishikimit të vendimit të tyre dhe përcaktimin e maksimumit kohor për atë që u tha paraprakisht.

Neni 20

Informacionin e klasifikuar të nivelit "SEKRET SHTETËROR" krijuesi e shqyrton dhe vlerëson në një periudhë jo më të gjatë se dhjetë vjet në mënyrë që të vlerësohet nevoja e ruajtjes së mëtutjeshme të klasifikimit.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "TEPËR SEKRET" shqyrtohet dhe vlerësohet në një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet, në mënyrë që të vlerësohet nevoja e ruajtjes së mëtutjeshme të klasifikimit.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "SEKRET" shqyrtohet dhe vlerësohet në një periudhë jo më të gjatë se tre vjet në mënyrë që të vlerësohet nevoja e ruajtjes së mëtutjeshme të klasifikimit.

Informacioni i klasifikuar i nivelit "INTERN" shqyrtohet dhe vlerësohet në një periudhë jo më të gjatë se dy vjet në mënyrë që të vlerësohet nevoja e ruajtjes së mëtutjeshme të klasifikimit.

Me nenin 20 riprecizohet dispozita e nenit paraprak dhe përcaktohet periudha kohore sipas nivelit të klasifikimit për të cilin krijuesi shqyrton dhe vlerëson ndonjë informacion të caktuar të klasifikuar me qëllim të përcaktimit të nevojës së ruajtjes së mëtutjeshme të nivelit ekzistues të klasifikimit.

Së këtijmi, ligjvënësi përcakton se për informacionin e klasifikuar të nivelit "SEKRET SHTETËROR" kjo periudhë nuk është më e gjatë se dhjetë vjet, për informacionin e klasifikuar të nivelit "TEPËR SEKRET" nuk është më e gjatë se pesë vjet, për informacionin e klasifikuar të nivelit "SEKRET" nuk është më e gjatë se tre vjet, ndërsa për informacionin

e klasifikuar të nivelit "INTERN" kjo periudhë nuk është më e gjatë se dy vjet. Por pastaj në dispozitat për kundërvajtje, ligjvënësi nuk parashikon përgjegjësi për krijuesin nëse ai nuk e shqyrton dhe vlerëson nevojën e ruajtjes së mëtutjeshme të klasifikimit të informacionit në afatin e përcaktuar.

Vlerësimi i nevojës për ruajtjen e nivelit është parashikuar në mënyrë që të reduktohen masat e mbrojtjes ose të mundësohet qasje deri te informacioni i cili tanimë nuk ka nevojë të mbrohet. Me këtë, do të mundësohet ekonomizim më i mirë gjatë shfrytëzimit të resurseve dhe transparencë më e madhe në punën e autoriteteve dhe institucioneve shtetërore.

Neni 21

Nëse me informacionin e klasifikuar kamuflohet tejkalmi i autorizimit, abuzimi i funksionit ose ndonjë veprim tjetër i kundërligjshëm, përkatësisht vepër dënuese, informacioni i këtillë nuk do të llogaritet si i klasifikuar.

Personave të cilët do ta denoncojnë informacionin nga paragrafi 1 i këtij neni deri te autoriteti kompetent, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve, iu garantohe mbrojtje në përputhje me ligj.

Me qëllim që të pamundësohet që pas informacionit të klasifikuar të fshihet tejkalmi i autorizimit, abuzimi i funksionit ose ndonjë veprim tjetër i kundërligjshëm, përkatësisht vepër dënuese, në nenin 21 është përcaktuar se informacioni i këtillë nuk do të llogaritet si i klasifikuar.

Për më tepër, ka mundësi hipotetike që personi i autorizuar për përcaktimin e nivelit të klasifikimit të informacionit, ta abuzojë autorizimin e këtillë me qëllim që të fsheh ndonjë veprim të caktuar të kundërligjshëm dhe së këtejmi, me këtë nen parandalohet mbrojtja e këtillë e informacioneve përmes klasifikimit të përdoret për qëllime të kundërligjshme dhe jolegjitime.

Në krahasim me Ligjin për informacionet e klasifikuara nga viti 2004, në këtë ligj është inkorporuar dispozita për mbrojtjen e personave të cilët do të denoncojnë informacion të klasifikuar me të cilin fshihet veprimi i kundërligjshëm, përkatësisht mbrojtja e tyre është garantuar me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve²⁰ si një mekanizëm i ri në luftën kundër korrupsionit dhe krimit.

²⁰ Ligji për mbrojtjen e denoncuesve, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 196/15 dhe 35/18.

INFORMACIONE TË KLASIFIKUARA TË SHTETEVE TË HUAJA DHE ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE

Neni 22

Informacionet e klasifikuara të shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare ose në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ka aderuar, e ruajnë nivelin e klasifikimit i cili përdoret në atë shtet ose në organizatën ndërkombëtare.

Në nenin 22 është përcaktuar se informacionet e huaja të cilat u janë dhënë në përdorim Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa u përkasin shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare me të cilat ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare ose në të cilat ka aderuar, e ruajnë nivelin origjinal të klasifikimit, përkatësisht nivelin që përdoret në atë shtet ose në atë organizatë ndërkombëtare.

Me këtë dispozitë theksohet harmonizimi i standardeve kombëtare të sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me standardet ndërkombëtare të pranuar dhe njëherësh konfirmohet përcaktimi i shtetit për sigurimin e mbrojtjes së barabartë të informacioneve të klasifikuara të huaja si dhe për informacionet e klasifikuara kombëtare që e kanë nivelin e njëjtë të klasifikimit. Në rast të ndryshimit të sistemit të klasifikimit të informacioneve në ndonjë shtet të huaj me të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare, me këtë dispozitë të Ligjit mundësohet kontinuitet në mbrojtjen e shkëmbimit të informacioneve.²¹

Neni 23

Diseminacioni i informacioneve të klasifikuara të huaja bëhet në përputhje me parimin "duhet të dini" dhe posedimi i certifikatës përkatëse të sigurisë.

Mënyrën e përcaktimit të përdoruesve dhe kryerjen e diseminimit të informacioneve të klasifikuara të pranuar nga jashtë, më për së afërmi me Urdhëresë e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 23 përcaktohet diseminimi, përkatësisht shpërndarja e informacioneve të klasifikuara të huaja deri te personat të cilët posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë dhe në përputhje me parimin "duhet të dini". Kjo nënkupton se nuk mjafton një person i caktuar të posedojë vetëm certifikatë përkatëse të sigurisë, meqë në këtë rast informacionet e klasifikuara të huaja do t'u shpërndareshin të gjithë personave që posedojnë certifikatë sigurie me nivelin përkatës të klasifikimit. Përkundrazi, duke vepruar konform parimit "duhet të dini" („need to know”), informacionet e këtilla të klasifikuara (të huaja) do t'u shpërndahen vetëm atyre personave të cilët me të vërtetë është e nevojshme ta dinë përmbajtjen e informacionit përkatës.

Diseminimi i informacioneve të klasifikuara si nocion për herë të parë inkorporohet në këtë ligj për shkak të zbatimit të tij gjerësisht të pranuar në rrethin e përdoruesve të informacioneve të klasifikuara.

Paragrafi i dytë i këtij neni përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Urdhëresë më për së afërmi ta rregullojë mënyrën e përcaktimit të përdoruesve dhe

kryerjen e diseminacionit të informacioneve të klasifikuara të pranuar nga jashtë. Me konkretisht, kjo materie është objekt i rregullimit në aktin nënligjor në të cilin përcaktohen masa nga domeni i sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara.

KREU I TRETË

KRITERE, MASA DHE AKTIVITETE PËR MBROJTJEN E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Neni 24

Për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara ndërmerren masa dhe aktivitete për sigurinë administrative, fizike dhe industriale, për sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit, si dhe për sigurinë e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara.

Kreu i tretë i Ligjit fokusohet mbi kriteret, masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Si rezultat i kësaj, në nenin 24 janë përcaktuar domenet në të cilët zbatohen masat dhe aktivitetet, përkatësisht domeni i sigurisë administrative, domeni i sigurisë fizike, domeni i sigurisë industriale, domeni i sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit si dhe domeni i sigurisë së personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara.

Përcaktimi i këtillë i masave dhe aktiviteteve është harmonizuar me standardet e pranura ndërkombëtare për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Neni 25

Kritere të cilat veçanërisht merren parasysh gjatë përcaktimit të masave për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara janë:

- ▶ niveli i klasifikimit,
- ▶ vëllimi dhe forma e informacionit të klasifikuar dhe
- ▶ vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit të klasifikuar.

Në nenin 25 definojnë kriteret minimale të cilat merren parasysh gjatë përcaktimit të masave për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Vet shprehja "të cilat veçanërisht merren parasysh" nënkupton se gjatë përcaktimit të masave për mbrojtje duhet të merren parasysh sa më shumë kritere relevante për informacionin në fjalë, por ato që janë theksuar detyrimisht duhet të shqyrtohen.

Kriteri i parë është niveli i klasifikimit nga i cili pastaj varet vëllimi dhe serioziteti i masave dhe aktiviteteve që do të zbatohen për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Sipas rregullit, niveli më i lartë i klasifikimit nënkupton masa më të rrepta të mbrojtjes, ndërsa, së këtejmi, edhe angazhim të më shumë resurseve.

Vëllimi dhe forma e informacionit të klasifikuar është kriteri i radhës i cili merret

parasysh gjatë përcaktimit të masave për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Nëse informacioni i klasifikuar ka "gabarit" të madh, është në formë të makinës ose të ndonjë pajisje tjetër dhe ngjashëm, përdoruesi i informacionit të klasifikuar të këtillë duhet të sigurojë hapësira përkatëse për ruajtje, si dhe masa mbrojtëse. Nga ana tjetër, nëse bëhet fjalë për informacion të klasifikuar në formë elektronike, përdoruesi i të njëjtit duhet të ndërmarr masa përkatëse për mbrojtjen e sistemeve të komunikimit-informacionit në të cilët informacioni i këtillë përpunohet dhe ruhet.

Vlerësimi i rrezikut të sigurisë së informacionit të klasifikuar është kriteri i tretë por jo edhe më pak i rëndësishëm gjatë përcaktimit të masave mbrojtëse të informacioneve të klasifikuara. Ai paraqet analizë gjithëpërfshirëse të të gjithë faktorëve që mund ta prishin sigurinë e informacionit të klasifikuar, ndërkaq rezultatet pastaj e vënë në dukje vëllimin dhe nivelin e mbrojtjes që duhet të sigurohet për atë informacion.

SIGURIA ADMINISTRATIVE

Neni 26

Masat dhe aktivitetet për sigurinë administrative janë:

- ▶ përcaktimi i nivelit të klasifikimit dhe shënimi i informacionit të klasifikuar,
- ▶ pranimi dhe evidentimi i informacionit të klasifikuar,
- ▶ përcaktimi i mënyrës së ruajtjes, trajtimit dhe kontrollit të informacionit të klasifikuar,
- ▶ riprodhimi, përkthime dhe ekstrakte të informacionit të klasifikuar dhe përcaktimi i numrit të kopjeve dhe përdoruesve,
- ▶ diseminacioni i informacioneve të klasifikuara,
- ▶ transferimi i informacioneve të klasifikuara,
- ▶ shmangia dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë administrative me Urdhëresë më për së afërmi i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 26 përcaktohen masat dhe aktivitetet e sigurisë administrative, përkatësisht të sigurisë së informacioneve siç është e përcaktuar në direktivat dhe aktet e NATO-s dhe BE-së.²²

Alineja e parë e paragrafit 1 të këtij neni ka të bëjë me përcaktimin e nivelit të klasifikimit dhe shënimin adekuat të tij. Gjatë përcaktimit të nivelit të klasifikimit merren parasysh indikatorë të cilët më për së afërmi e vënë në dukje nivelin e dëmit eventual që mund të shkaktohet ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut ose ndaj ndonjë vendi të huaj apo organizate ndërkombëtare nga qasja e pa autorizuar në informacionin e

²² Për përcaktimin e nivelit të klasifikimit dhe shënimin e informacioneve të klasifikuara, për pranimin dhe evidentimin e informacioneve të klasifikuara, për rikualifikimin dhe deklasifikimin e informacioneve të klasifikuara, për transferimin dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara, për përgatitjen e përkthimeve, kopjeve dhe ngjashëm, Security Within the North Atlantic Treaty Organization (NATO) C-M(2002)49-REV1, Enclosure "E", 20 November 2020; Council Decision of 23 September 2013 on the security rules for protecting EU classified information 32013D0488 (Official Journal of the European Union L274/1), Annex III)

klasifikuar ose nga përdorimi i paautorizuar i tij. Pas përcaktimit të nivelit të klasifikimit krijuesi i informacionit të klasifikuar duhet ta shënojë në mënyrë përkatëse me qëllim që i njëjti ta ketë mbrojtjen përkatëse.

Alineja e dytë ka të bëjë me pranimin dhe evidentimin e informacionin e klasifikuar që kryhen në përputhje me rregullat ekzistuese për punë arkivore dhe punë në zyrë ndërkaq janë një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e informacionit meqë evidenca e rregullt e informacionit dhe "ndjekja" e lëvizjes së tij është njëri nga parakushtet e sigurimit të mbrojtjes përkatëse.

Alineja e tretë e paragrafit 1 të këtij neni ka të bëjë me përcaktimin e mënyrës së ruajtjes, trajtimit dhe kontrollit të informacionit të klasifikuar. Mënyra me të cilën informacioni i klasifikuar do të ruhet, mënyra e trajtimit dhe mënyra e kontrollit varet nga niveli i klasifikimit të informacionit në fjalë si dhe nga vëllimi dhe forma e informacionit.

Riprodhimi i informacionit të klasifikuar si dhe përkthimi dhe ekstraktet nga i njëjti, si dhe përcaktimi i numrit të kopjeve dhe të përdoruesve janë masat dhe aktivitetet e ardhshme të sigurisë administrative të specifikuara në këtë nen. Standardi ndërkombtarisht i pranuar në këtë rast konsiston me atë se të gjitha riprodhimet, përkthimet dhe kopjet i kanë shënimet e njëjta dhe e kanë mbrojtjen e njëjtë si edhe informacioni i klasifikuar origjinal, ndërkaq me qëllim që të mundësohet mbrojtja dhe kontrolli i tyre përkatës, duhet që numri i tyre të kufizohet me numrin e nevojshëm të kryerjes së detyrave zyrtare, ndërsa përdoruesit e tyre të evidentohen në mënyrë përkatëse.

Alineja e pestë ka të bëjë me diseminimin e informacionit të klasifikuar, përkatësisht me shpërndarjen e tij deri te përdoruesit e fundit, që e nënkupton dërgesën e informacionit të klasifikuar deri te personat të cilët posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë konform parimit "duhet të dini". Rrjedhimisht me këtë rregullohet edhe transferimi i informacionit të klasifikuar, me ç'rast mbahet llogari edhe për mënyrën e paketimit të të njëjtit, sipas nivelit të tij të klasifikimit.

Shmangia dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar është hapi i fundit i "ciklit jetësor" të tij dhe i njëjti zbatohet në përputhje me rregullat ekzistuese kombëtare për punë arkivore dhe punë në zyrë si dhe me rregulloret e NATO-s dhe BE-së për trajtimin e informacioneve të tyre të klasifikuara.

Paragrafi i dytë i këtij neni parashikon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Urdhëresë më për së afërmi t'i përcaktojë masat dhe aktivitetet e sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara.

SIGURIA FIZIKE

Neni 27

Siguria fizike realizohet përmes zbatimit të masave mbrojtëse fizike dhe teknike me qëllim që të parandalohet qasja e paautorizuar në informacionet e klasifikuara.

Masat e sigurisë fizike duhet ta parandalojnë ndërhyrjen e kamufluar ose të dhunshme nga personi i paautorizuar, të sprapsin, parandalojnë dhe detektojnë aktivitete të paautorizuara, si dhe të mundësojnë ndarje të personelit gjatë qasjes së tyre në informacionet e klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini".

Masat e sigurisë fizike aplikohen në objekte, ndërtesa, zyra, hapësira dhe në lokacione të tjera në të cilat informacionet e klasifikuara trajtohen, ruhen ose përpunohen në mënyrë elektronike.

Hapësirat në të cilat ruhen informacionet e klasifikuara të nivelit "SEKRET" dhe më lartë, përcaktohen si zona të sigurisë.

Për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të nivelit "SEKRET" dhe më lartë përdoret pajisje, sisteme ose mjete të tjera teknike të cilat i përmbushin standardet minimale, të përcaktuara nga drejtori i Drejtorisë.

Në paragrafin e parë të nenit 27 përcaktohet se siguria fizike realizohet përmes zbatimit të masave mbrojtëse fizike dhe teknike me qëllim të parandalimit të qasjes së paautorizuar në informacionet e klasifikuara.

Pastaj, dispozitat e nenit i vënë në dukje rezultatet që duhet të arrihen përmes zbatimit të masave të sigurisë fizike, ndërsa kjo ka të bëjë me parandalimin e ndërhyrjes së kamufluar ose të dhunshme nga personi i paautorizuar, me sprapsjen, parandalimin dhe detektimin e aktiviteteve të paautorizuara, si dhe me mundësimin e ndarjes së personelit gjatë qasjes së tyre në informacionet e klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini".

Paragrafi i tretë i nenit e vë në pah aspektin gjithëpërfshirës të zbatimit të masave për mbrojtje fizike, përkatësisht zbatimin e tyre në të gjitha lokacionet, objektet, ndërtesat, zyrat dhe hapësirat, në të cilat informacionet e klasifikuara trajtohen, ruhen ose përpunohen në mënyrë elektronike.

Në dy paragrafët e fundit të nenit theksohet vendosja e zonave të sigurisë në hapësirat në të cilat ruhen informacionet e klasifikuara të nivelit "SEKRET" dhe më lartë, si dhe përdorimi i pajisjes, sistemeve ose të mjeteve tjera teknike për mbrojtjen e informacioneve të këtilla. Së këtejmi, ligjvënësi është i mendimit se si zona të sigurisë duhet të përcaktohen hapësirat për informacionet e klasifikuara të nivelit "SEKRET", "TEPËR SEKRET" dhe "SEKRET SHTETËROR", përkatësisht për ato nivele për të cilat një person që të mund t'i trajtojë të njëjtat duhet të posedojë certifikatë përkatëse të sigurisë. Rrjedhimisht me këtë, kjo dispozitë është përjashtuese në drejtim të kundërt, përkatësisht *argumentum a contrario* hapësirat në të cilat ruhen informacionet e klasifikuara të nivelit "INTERN" nuk përcaktohen si zona të sigurisë.

Për më tepër përcaktohet se pajisja paraprakisht e theksuar, sistemet dhe mjetet duhet të përmbushin standarde minimale të cilat i përcakton drejtorit i Drejtorisë. Në të vërtetë, përcaktimi i këtyre standardeve bazohet në standardet ndërkombtarisht të pranuar të NATO-s dhe BE-së, përkatësisht në listat e produkteve të rekomanduara të cilat i përmbushin standardet e përcaktuara të atyre organizatave ndërkombëtare për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Neni 28

Masa dhe aktivitetet e sigurisë fizike janë:

- ▶ vlerësimi i çrregullimit të mundshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar,
- ▶ përcaktimi i brezit të sigurisë përreth objektit,
- ▶ përcaktimi i zonave të sigurisë dhe administrative,
- ▶ organizimi i mbrojtjes fizike dhe zbatimi i masave teknike për sigurimin e objekteve dhe hapësirave në të cilat gjenden informacionet e klasifikuara,
- ▶ kontrolli i hyrjes, lëvizjes dhe daljes së personave dhe automjeteve për transferimin e informacioneve të klasifikuara dhe
- ▶ sigurimi fizik gjatë transferimit të informacioneve të klasifikuara jashtë zonave të sigurisë.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë fizike më për së afërmi me Urdhëresë i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 28 theksi vihet mbi masat dhe aktivitetet e sigurisë fizike me ç'rast, jo rastësisht, në vend të parë është vlerësimi për çrregullimin e mundshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar. Rezultatet nga vlerësimi i mundësisë për rrezikimin e sigurisë së informacioneve të klasifikuara dhe të burimeve prej ku mund të gjenerohet ajo, japin bazë solide për përcaktimin e masave dhe aktiviteteve të sigurisë fizike për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Këtu, para së gjithash, mendohet në përcaktimin e brezit të sigurisë rreth një objekti konkret, përcaktimin e zonave të sigurisë dhe administrative në ndonjë objekt konkret, si dhe organizimi i mbrojtjes fizike dhe zbatimi i masave teknike për sigurimin e objekteve dhe hapësirave në të cilat gjenden informacione të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë fizike, veç tjerash, e përfshijnë edhe sigurimin e kontrollit të hyrjes, lëvizjes dhe daljes së personave dhe automjeteve për transferimin e informacioneve të klasifikuara, si dhe sigurimin fizik gjatë transferimit të informacioneve të klasifikuara jashtë zonave të sigurisë. Duke e pasur parasysh se mjedisi i sigurisë dhe burimet e kërcënimeve vazhdimisht ndryshojnë, ndërsa teknologjia shënon progres të shpejtë, në masat dhe aktivitetet e parashikuara për siguri fizike të informacioneve të klasifikuara duhet të ketë mundësi për avancim dhe plotësim.

Në paragrafin e dytë të këtij neni parashikohet baza e përcaktimit të mëtutjeshëm të detajuar të masave dhe aktiviteteve të identifikuar të sigurisë fizike të informacioneve të klasifikuara në Urdhëresën të cilën do ta miratojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SIGURIA E PERSONAVE-PËRDORUES TË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Neni 29

Masa dhe aktivitete të sigurisë së personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara janë:

- ▶ përcaktimi i oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara,
- ▶ kontrolli i sigurisë,
- ▶ lëshimi i certifikatës së sigurisë,
- ▶ lëshimi i lejes për qasje në informacione të klasifikuara dhe
- ▶ kontrolli dhe vlerësimi i aftësisë së veprimit me informacione të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë së personave përdorues të informacioneve të klasifikuara për së afërmi me Urdhëresë do t'i përcaktojë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë së personave përdorues të informacioneve të klasifikuara në mënyrë taksative janë përcaktuar në nenin 29 ndërsa pastaj në mënyrë të detajuar janë rregulluar me Ligj.

Përcaktimi i oficerit të sigurisë të informacioneve të klasifikuara si dhe detyrimet e tij në detaje janë përpunuar në Kreun e katërt të këtij Ligji. Oficerët e sigurisë të informacioneve të klasifikuara janë persona kyç të personelit për qëndrueshmëri, zbatim dhe mbikëqyrje të politikave të sigurisë për punë me informacione të klasifikuara në secilin nga autoritetet relevant të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe persona të tjerë juridikë, në të cilët informacionet e klasifikuara trajtohen dhe ruhen.

Bashkë me kontrollin e sigurisë të personave me qëllim të lëshimit të certifikatës së sigurisë për qasje në informacione të klasifikuara, lëshimi i certifikatës së sigurisë, lëshimi i lejes për personat e huaj fizikë dhe juridikë për qasje në informacionet e klasifikuara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe kontrolli dhe vlerësimi i aftësisë së veprimit të informacioneve të klasifikuara si masa dhe aktivitete sigurie të personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara, ligjvënësi e ka parashikuar për së afërmi të rregullohen me Urdhëresë të cilën e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SIGURIA E SISTEMEEVE TË KOMUNIKIMIT-INFORMACIONIT

Neni 30

Siguria e sistemeve të komunikimit-informacionit konsiston me zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e sistemeve elektronike të komunikimit, informacionit dhe të sistemeve të tjerë elektronik, si dhe të informacioneve të klasifikuara të cilat krijohen, ruhen, përpunohen ose transferohen në këto sisteme, me qëllim që të sigurohet konfidenca, integriteti, aksesit, autenticiteti dhe përvokueshmëria e tyre.

Me qëllim të sigurimit të qëllimeve nga paragrafi 1 të këtij neni implementohet sistemi përkatës i masave të sigurisë për sigurinë administrative dhe fizike, sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit, si dhe për sigurinë e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara, me qëllim të krijimit të mjedisit të sigurt në të cilin funksionojnë sistemet elektronike të komunikimit, të informacionit ose të sistemeve të tjerë elektronike.

Sistemi i masave të sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit duhet të bazohet në procesin e menaxhimit të riskut të sigurisë.

Në nenin 30 ligjvënësi e përcakton sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit (SKI), me ç'rast përcakton se e njëjta e nënkupton zbatimin e masave të sigurisë për mbrojtjen e sistemeve elektronike të komunikimit, informacionit dhe të sistemeve të tjerë elektronike dhe të informacioneve të klasifikuara të cilat krijohen, ruhen, përpunohen ose transferohen në këto sisteme, me qëllim që të sigurohet konfidenca, integriteti, aksesit, autenticiteti dhe përvokueshmëria e tyre.

Në paragrafin e dytë të këtij neni theksohet nevoja e implementimit të sistemit gjithëpërfshirës të masave të sigurisë për siguri administrative dhe fizike, për sigurinë e SKI, si dhe për sigurinë e personave përdorues të informacioneve të klasifikuara, me qëllim të krijimit të një mjedisi të sigurt në të cilin funksionojnë sistemet elektronike të komunikimit, informacionit ose sisteme të tjerë elektronik. Me këtë, ligjvënësi e vë në dukje kompleksitetin e masave dhe aktiviteteve të nevojshme për t'u arritur siguria e SKI dhe çon drejt ndërgjegjësimit të përdoruesve sa i përket sigurisë së informacioneve të klasifikuara gjatë trajtimit të tyre dhe ruajtjes së tyre në formë elektronike.

Për këtë shkak, në paragrafin e tretë të këtij neni ligjvënësi e vë në pah atë se sistemi i masave të sigurisë të SKI duhet të bazohet mbi procesin e menaxhimit të rrezikut të sigurisë. Nëse merret parasysh se administrimi me rrezikun e sigurisë tanimë është definuar si proces i identifikimit, kontrollimit, minimizimit ose eliminimit të ngjarjeve të cilat mund të kenë ndikim mbi sigurinë e ndonjë organizate ose mbi sigurinë e sistemit të cilin ajo e përdorë, mund të konkludojmë se ligjvënësi edhe një herë e thekson kompleksitetin e kësaj materie dhe nevojën e ruajtjes së nivelit të lartë të ndërgjegjësimit për sigurinë sa i përket mjedisit të ndryshueshëm të sigurisë dhe zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, veçanërisht të teknologjisë së informacionit dhe ekspansionit të kimit kibernetik.

Neni 31

Masa dhe aktivitete të sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit janë:

- ▶ akreditimi i sistemeve dhe proceseve të komunikimit-informacionit,
- ▶ vlerësimi i çrregullimit të mundshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar nga qasja e paautorizuar në sistemin e komunikimit-informacionit në të cilin ruhen, përpunohen dhe transferohen informacionet e klasifikuara,
- ▶ përcaktimi i metodave dhe procedurave të sigurisë për pranimin, përpunimin, transferimin, ruajtjen dhe arkivimin e informacioneve të klasifikuara në formë elektronike,
- ▶ mbrojtja gjatë krijimit, ruajtjes, përpunimit dhe transferimit të informacioneve të klasifikuara në sistemet e komunikimit-informacionit,
- ▶ siguria kriptografike e sistemeve elektronike të komunikimit, informacionit dhe të sistemeve të tjerë elektronikë përmes të cilëve krijohen, ruhen, përpunohen me kriptombrojtje dhe transferohen informacionet e klasifikuara, mbrojtja nga rrezatimi kompromitues elektromagnetik,
- ▶ përcaktimi i zonave dhe hapësirave të mbrojtura nga rrezatimi i kompromituar elektromagnetik dhe
- ▶ instalimi i pajisjeve për ruajtjen e informacioneve të klasifikuara.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit më për së afërmi me Urdhëresë i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë të sistemeve të komunikimit-informacionit (SKI) në mënyrë taksative janë përcaktuar në nenin 31, me ç'rast ligjvënësi e ka parashikuar rregullimin e tyre më për së afërmi me Urdhëresë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë numërimit të masave të aktiviteteve të sigurisë së SKI, ligjvënësi e apostrofon akreditimin e SKI dhe proceset e punës të të njëjtave me ç'rast e vë në dukje nevojën e miratimit formal të SKI për punë deri në nivelin e caktuar të klasifikimit. Miratimi formal i SKI si kompetencë e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara është rregulluar në vijim të këtij ligji, në nenin 69 paragrafi 2 alineja 9.

Si masë e radhës për sigurinë e SKI theksohet vlerësimi i çrregullimit të mundshëm të sigurisë së informacionit të klasifikuar nga qasja e paautorizuar në SKI në të cilin ruhen, përpunohen dhe transferohen informacionet e klasifikuara. Qëllimi i vlerësimit të këtillë konsiston me përcaktimin e rrisht, me vlerësimin e rrisht i cili nuk mund të shmanget, me vlerësimin e fragjilitetit dhe kërcënimeve, si dhe me përcaktimin e pasojave nga realizimi i kërcënimeve të caktuara.

Alineja e tretë ka të bëjë me përcaktimin e metodave dhe procedurave të sigurisë për pranimin, përpunimin, transferimin, ruajtjen dhe arkivimin e informacioneve të klasifikuara në formë elektronike. Bëhet fjalë për një procedurë gjithëpërfshirëse, me ç'rast duhet të mbahet llogari për zbatimin e masave dhe aktiviteteve përkatëse nga domeni i sigurisë administrative gjatë pranimin, përpunimit dhe transferimit të informacioneve të klasifikuara, pastaj nga domeni i sigurisë fizike në lidhje me përcaktimin e zonave të sigurisë në të cilat janë locuar SKI varësisht nga niveli i informacioneve të klasifikuara të cilat përpunohen në to, si dhe masa dhe aktivitete nga domeni i sigurisë së personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara në përputhje me të cilat qasje në SKI në

të cilin përpunohen informacione të klasifikuara mund të ketë vetëm përdoruesi i cili posedon certifikatë përkatëse të sigurisë konform nivelit të klasifikimit të SKI i cili është njoftuar në mënyrë përkatëse me detyrimet që rezultojnë nga procedurat e sigurisë-operative të SKI.

Pastaj, ligjvënësi i vënë në dukje masat e mbrojtjes gjatë krijimit, ruajtjes, përpunimit dhe transferimit të informacioneve të klasifikuara në SKI, sigurinë kriptografike të sistemeve elektronike të komunikimit, informacionit dhe të sistemeve tjera elektronike përmes të cilave krijohen, ruhen, përpunohen me kriptombrojtje dhe transferohen informacione të klasifikuara, si dhe mbrojtjen nga rrezatimi komprometues elektromagnetik dhe përcaktimin e zonave dhe hapësirave të mbrojtura nga rrezatimi komprometues elektromagnetik. Masat e mbrojtjes nga rrezatimi komprometues elektromagnetik nënkuptojnë matje teknike me të cilat përcaktohen zonat në objektet në të cilat janë locuar SKI dhe konform rezultateve të fituara përcaktohen masa përkatëse të mbrojtjes nga aspekti i sigurisë fizike.

Si masë e fundit e sigurisë së SKI ligjvënësi e thekson instalimin e pajisjeve për ruajtjen e informacioneve të klasifikuara, e që nënkupton të njëjtat të mund të instalohen nga persona profesionistë dhe të autorizuar.

Neni 32

Masa dhe aktivitete për siguri kriptografike janë:

- ▶ planifikimi, organizimi dhe implementimi i sigurisë kriptografike,
- ▶ evaluimi dhe miratimi i kriptomaterialeve dhe kriptoprodukteve,
- ▶ përpunimi dhe zhvillimi i algoritmeve dhe produkteve kriptografike,
- ▶ planifikimi, organizimi dhe administrimi me kriptomateriale,
- ▶ zbatimi i masave dhe procedurave për evidentimin, trajtimin e sigurt, ruajtjen dhe shpërndarjen e kriptomaterialeve dhe kriptoprodukteve,
- ▶ trajnimi i personave për punë me kriptomateriale dhe kriptoprodukte,
- ▶ kontroll mbi implementimin e masave dhe aktiviteteve për siguri kriptografike dhe mbi mënyrën e përdorimit të materialeve dhe produkteve kriptografike.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë kriptografike më për së afërmi me Urdhëresë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Si njëra nga masat dhe aktivitetet për sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit është edhe siguria kriptografike. Në nenin 32 në mënyrë taksative janë specifikuar masat dhe aktivitetet e sigurisë kriptografike, me ç'rast ligjvënësi e ka parashikuar rregullimin e tyre më të afërt me Urdhëresë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo nuk nënkupton se kjo materie deri më tani fare nuk ka qenë e rregulluar, por se Urdhëresa ekzistuese, e miratuar në vitin 1995 është klasifikuar në nivelin "SEKRET SHTETËROR", duhet të zëvendësohet me Urdhëresë të re në të cilën do të përfshihen rrjedhat aktuale në domenin e mbrojtjes kriptografike dhe me të njëjtën do të rregullohen marrëdhëniet midis të gjithë bartësve të mbrojtjes kriptografike në shtet.

Duke e marrë parasysh se ligjvënësi sigurinë kriptografike e definon si aktivitet operativ-planor në sistemin e materialeve dhe produkteve kriptografike të cilat përdoren

për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara nga qasja e paautorizuar gjatë përpilimit, trajtimit dhe ruajtjes së informacioneve të klasifikuara të gjitha masat dhe aktivitetet e theksuara e vënë në pah materien komplekse për implementimin e së cilës nevojitet një kuadër me arsim teknik dhe me trajnime përkatëse. Ligjvënësi ka identifikuar disa masa dhe aktivitete për sigurinë kriptografike të cilat vetvetiu paraqesin procese të veçanta që përfshijnë më shumë aktivitete. Procese të këtilla janë planifikimi, organizimi dhe implementimi i sigurisë kriptografike; evaluimi dhe miratimi i kriptomaterialeve dhe kriptoprodukteve që përdoren për sigurimin e mbrojtjes kriptografike; përpunimi dhe zhvillimi i algoritmeve dhe produkteve kriptografike; planifikimi, organizimi dhe avancimi i kriptomaterialeve; zbatimi i masave dhe procedurave të evaluimit, trajtimit të sigurt, ruajtjes dhe shpërndarjes së kriptomaterialeve dhe kriptoprodukteve; trajnimi i personave për punë me kriptomateriale dhe kriptoprodukte, si dhe kryerja e kontrollit mbi implementimin e masave dhe aktiviteteve të sigurisë kriptografike dhe mbi mënyrën e përdorimit të materialeve dhe produkteve kriptografike.

Për shkak të natyrës specifike të materies, miratimi i aktit të veçantë nënligjor me të cilin do të rregullohen marrëdhëniet midis autoriteteve të administratës shtetërore të cilët kanë kompetenca në domenin e mbrojtjes kriptografike ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 33

Transferimi i informacioneve të klasifikuara përmes sistemeve të komunikimit jashtë zonave të sigurisë bëhet ekskluzivisht përmes zbatimit të mbrojtjes kriptografike.

Në këtë nen ligjvënësi përcakton se transferimi i informacioneve të klasifikuara përmes sistemeve të komunikimit jashtë zonave të sigurisë kryhet ekskluzivisht përmes zbatimit të mbrojtjes kriptografike, me ç'rast nuk e ka parashikuar kufizimin e nivelit të klasifikimit të informacioneve në lidhje me transferimin elektronik. Kjo nënkupton se informacionet e klasifikuara të të gjitha niveleve të klasifikimit mund të transferohen në rrugë elektronike përmes zbatimit të detyrueshëm të mbrojtjes kriptografike.

SIGURIA INDUSTRIALE

Neni 34

Masat e sigurisë industriale zbatohen me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara nga ana e kontraktuesve dhe subjekteve të përfshira në negociatat para lidhjes së marrëveshjes dhe gjatë realizimit të marrëveshjes së klasifikuar.

Me masat e sigurisë industriale sigurohet mbrojtja e informacioneve të klasifikuara gjatë transportit dhe gjatë vendosjes së procedurave për vizitë të personave fizikë dhe juridikë në objektet në të cilat trajtohen informacionet e klasifikuara.

Për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara gjatë realizimit të marrëveshjeve të klasifikuara, transportit të informacioneve të klasifikuara dhe vizitave në objekte në të cilat trajtohen informacionet e klasifikuara, personat fizikë dhe juridikë

nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni duhet të posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë ose leje për qasje në informacionet e klasifikuara.

Për nevojën e klasifikimit të marrëveshjes dhe fazave të cilat i paraprinë lidhjes së marrëveshjes, duke e përfshirë këtu edhe thirrjen publike për pjesëmarrje në prokurimet publike, personi juridik duhet të siguroj mendim nga oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara i subjektit që e shpall thirrjen publike.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë industriale i përfshijnë masat dhe aktivitetet e nenit 26 paragrafi 1, neni 28 paragrafi 1, neni 29 paragrafi 1, neni 31 paragrafi 1 dhe neni 32 paragrafi 1 të këtij ligji.

Masat dhe aktivitetet e sigurisë industriale më për së afërmi me Urdhëresë i rregullon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 34 ligjvënësi përcakton se masat dhe aktivitetet e sigurisë industriale zbatohen me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara nga kontraktuesit dhe subjektet e përfshira në negociata para lidhjes së marrëveshjes dhe gjatë realizimit të marrëveshjes së klasifikuar. Kjo nënkupton mbrojtje e cila i përfshinë të gjitha fazat, madje edhe ato që i paraprijnë lidhjes së marrëveshjes. Kjo është e arsyeshme meqë madje edhe në ato faza mund të përdoren dhe shkëmbehen informacione që janë dhe/ose duhet të jenë të mbrojtura.

Në mënyrë plotësuese, përcaktohet se masat e sigurisë industriale sigurojnë mbrojtje të informacioneve të klasifikuara gjatë transportit dhe gjatë vendosjes së procedurave për vizitën e personave fizikë dhe juridikë në objekte në të cilat trajtohen informacione të klasifikuara. Së këtijmi ligjvënësi e vë në dukje lidhshmërinë e sigurisë industriale me masat dhe aktivitetet e sigurisë së personave përdorues të informacioneve të klasifikuara, me ç'rast ka parashikuar se për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara gjatë realizimit të marrëveshjeve të klasifikuara, gjatë transportit të informacioneve të klasifikuara dhe gjatë vizitave të objekteve në të cilat trajtohen informacionet e klasifikuara, personat fizikë dhe juridikë duhet të posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë ose leje për qasje në informacione të klasifikuara.

Në paragrafin e katërt të këtij neni përcaktohet se gjatë klasifikimit të marrëveshjes dhe fazave që i paraprinë lidhjes së marrëveshjes, duke e përfshirë këtu edhe thirrjen publike për pjesëmarrje në prokurime publike, personi juridik duhet të sigurojë mendim nga oficeri i sigurisë të informacioneve të klasifikuara i subjektit i cili e ka shpallur thirrjen publike.

Në këtë nen ligjvënësi nuk i specifikon në mënyrë taksative masat dhe aktivitetet e sigurisë industriale ashtu siç paraprakisht e ka bërë me masat dhe aktivitetet e tjera meqë siguria industriale i përfshinë të gjitha masat dhe aktivitetet e përcaktuara nga domeni i sigurisë administrative, nga domeni i sigurisë së personave përdorues të informacioneve të klasifikuara, nga domeni i sigurisë fizike dhe nga domeni i sigurisë së SKI.

Gjithëpërfshirjen e këtillë të masave dhe aktiviteteve të sigurisë industriale ligjvënësi e ka parashikuar më për së afërmi të rregullohet me Urdhëresë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SHKËMBIMI I INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA ME SHTETE TË HUAJA DHE ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

Neni 35

Informacioni i klasifikuar i shtetit të huaj ose organizatës ndërkombëtare është informacion të cilin autoriteti kompetent i shtetit të huaj ose organizata ndërkombëtare ia ka kaluar Republikës së Maqedonisë së Veriut me detyrimin të sigurohet mbrojtja e tij.

Me informacionet e klasifikuara të pranura nga shtetet e huaja ose organizata ndërkombëtare veprohet në mënyrë të parashikuar me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare.

Nëse marrëveshja ndërkombëtare nga paragrafi 2 të këtij neni nuk përmban dispozita për mënyrën e veprimit me informacionet e klasifikuara, atëherë veprohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Në paragrafin 1 të nenit 35 ligjvënësi informacionin e klasifikuar të shtetit të huaj ose organizatës ndërkombëtare e definon si informacion të cilin autoritetet kompetente të shtetit të huaj ose organizata ndërkombëtare ia ka kaluar Republikës së Maqedonisë së Veriut me detyrimin që të sigurohet mbrojtja e tij.

Rrjedhimisht me këtë, në paragrafin e dytë përcaktohet detyrimi i përdoruesve të informacioneve të klasifikuara në vend për veprimin me informacione të këtilla në mënyrë të përcaktuar me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare. Ndërkaq, nëse marrëveshja nuk përmban dispozita për mënyrën e veprimit me informacionet e klasifikuara, ligjvënësi ka parashikuar se do të zbatohen dispozitat e këtij ligji. Me këtë, para së gjithash përjashtohet zbatimi i dispozitave përkatëse të këtij ligji në rastin kur me marrëveshjen e ratifikuara ndërkombëtare është përcaktuar mënyra e veprimit të këtyre informacioneve. Zbatimi i legjislacionit vendor vjen parasysh kur marrëveshja ndërkombëtare nuk ka parashikuar dispozita për mënyrën e veprimit.

Me pranimin e zgjidhjes së këtillë manifestohet sjellja serioze ndaj mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar me standardet dhe masat e specifikuar ndërkombëtare të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara.

Neni 36

Në rast të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së krizës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të autoriteteve kompetente në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, Drejtoria mund të bëjë shkëmbim të informacioneve të klasifikuara me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare me të cilat nuk ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare sipas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse një gjë e këtillë është në interes të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas përfundimit të gjendjes së luftës, së jashtëzakonshme ose të krizës nga paragrafi 1 të këtij neni, Drejtoria paraqet raport pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkëmbimet e informacioneve të klasifikuara me shtete të huaja dhe

organizata ndërkombëtare me të cilat nuk ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 36 përmban dispozita me të cilat për herë të parë deri më tani rregullohet veprimi i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në lidhje me shkëmbimin e informacioneve të klasifikuara me shtetet e huaja dhe organizata ndërkombëtare me të cilat nuk janë lidhur marrëveshje ndërkombëtare në rast të gjendjes së luftës, së jashtëzakonshme ose gjendjes së krizës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Atëherë, bëhet fjalë për rast të jashtëzakonshëm (shkëmbim të informacioneve të klasifikuara me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare në mungesë të marrëveshjes përkatëse ndërkombëtare) në rrethana të jashtëzakonshme, (në gjendje të jashtëzakonshme, gjendje lufte ose gjendje të krizës).

Për më tepër, në paragrafin e parë të nenit përcaktohet se Drejtoria mund të bëjë shkëmbim të informacioneve të klasifikuara në raste të këtilla, nëse një gjë e këtillë është në interes të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të autoriteteve kompetente në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj dhe sipas pëlqimit paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në paragrafin e dytë të këtij neni ligjvënësi e ka parashikuar detyrimin e Drejtorisë që pas përfundimit të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së krizës në vend Qeverisë t'i dërgojë raport për shkëmbimin e informacioneve të klasifikuara me shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat nuk është lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Me zgjidhjen e këtillë ligjvënësi i rregullon marrëdhëniet dhe detyrimet e Drejtorisë në kontekst të asaj që u tha më lartë, ndërsa në rast të gjendjes së luftës, së jashtëzakonshme ose së krizës në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke theksuar se të njëjtat realizohen nëse një gjë e këtillë është në interes të shtetit.

Neni 37

Në përputhje me detyrimet e ndërmarra nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare Drejtoria mundëson kryerjen e kontrollit mbi përfaqësuesit e autorizuar të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, mbi mënyrën e përdorimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të cilat ata ia kanë kaluar në përdorim Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kontroll mbi mënyrën e përdorimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të dërguara nga Republika e Maqedonisë së Veriut deri te shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare ushtron Drejtoria në përputhje me këtë ligj dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Dispozita e këtij neni korrespondon me dispozitën e nenit 35 dhe në këtë dispozitë ligjvënësi i identifikon detyrimet e ndërmarra nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare si bazë për rregullimin e kontrollit të mënyrës së përdorimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të shkëmbyera midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare. Së këtejmi, vjen në shprehje parimi i reciprocitetit.

Rrjedhimisht me këtë, është parashikuar se përfaqësuesit e autorizuar të shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare mund të bëjnë kontroll mbi mënyrën e

përdorimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të cilat ato ua kanë kaluar në përdorim Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa sa i përket informacioneve të klasifikuara kombëtare që janë dërguar nga Republika e Maqedonisë së Veriut deri te shtetet përkatëse, ligjvënësi e ka parashikuar që kontrollin e mënyrës së përdorimit dhe mbrojtjes së këtyre informacioneve ta kryej Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara.

PËRDORIMI I INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Neni 38

Autoriteti i pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika dhe nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit ose personi fizik ose juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut i cili posedon certifikatë sigurie ose autoriteti institucioni ose personi fizik ose juridik i shtetit të huaj që posedon certifikatë sigurie të shtetit amë dhe leje për qasje në informacione të klasifikuara të lëshuar nga Drejtoria, mund të jetë përdorues i informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini".

Në nenin 38 ligjvënësi përcakton se kush mund të jetë përdorues i informacioneve të klasifikuara, me ç'rast e thekson nevojën e pëlqimit me parimin "duhet të dini". Veç tjerash, ka parashikuar se autoriteti i pushtetit shtetëror dhe lokal i themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personi juridik i themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit ose personi fizik ose juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duhet të posedojë certifikatë sigurie, ndërsa autoriteti, institucioni ose personi fizik ose juridik i shtetit të huaj duhet të posedojë certifikatë sigurie të shtetit amë dhe leje për qasje në informacione të klasifikuara të lëshuar nga Drejtoria. Me fjalë të tjera, ligjvënësi parashikon dy kushte kumulative të cilat një person (fizik ose juridik) duhet t'i plotësojë që të jetë përdorues i informacioneve të klasifikuara, ndërsa këto janë: 1. Posedimi i certifikatës përkatëse të sigurisë/certifikatë sigurie dhe leje për qasje (për personin fizik dhe juridik të huaj) dhe 2. Të mundet në rastin konkret të zbatohet parimi ("duhet të dini").

Zgjidhja e këtillë edhe një herë e afirmon parimin e lartpërmendur i cili që moti është i njohur dhe i aplikuar në teorinë dhe praktikën e sigurisë dhe i apostrofuat në shumë dokumente të NATO-s, megjithatë nga aspekti teorik e pamundëson që çdo person me certifikatë përkatëse të sigurisë të ketë qasje në të gjitha informacionet e klasifikuara të nivelit adekuat. Në këtë mënyrë, fshehtësia e informacioneve është siguruar në mënyrë plotësuese, ndërsa qasja deri te të njëjtat është kufizuar vetëm për personat të cilët me të vërtetë kanë nevojë ta dinë përmbajtjen e informacioneve konkrete për shkak të kryerjes/ushtrimit të funksioneve, detyrave dhe autorizimeve të tyre.

Këtu ligjvënësi (por madje në asnjë vend tjetër të Ligjit) nuk i ka parashikuar kushtet që duhet të plotësohen për lëshimin e lejes për qasje në informacionet e klasifikuara nga ana e Drejtorisë.

Neni 39

Për kryerjen e detyrave të punës, personave të cilët i trajtojnë informacionet e klasifikuara tek autoritetet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, tek personat juridikë të themeluar nga Republika dhe nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe tek persona të tjerë juridikë dhe fizikë u lëshohet certifikatë sigurie në përputhje me parimin "duhet të dini".

Certifikatë sigurie lëshohet për qasje deri në nivelin përkatës të informacioneve të klasifikuara.

Për lëshimin e certifikatës së sigurisë për qasje deri në nivelin përkatës të informacioneve të klasifikuara, personi i interesuar fizik ose juridik paraqet kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë.

Kërkesa për lëshimin e certifikatës së sigurisë nga paragrafi 3 të këtij neni paraqitet përmes oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara tek personi juridik.

Procedura e lëshimit të certifikatës së sigurisë për personat e punësuar në Drejtori zbatohet përmes oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara në Drejtori.

Certifikatë sigurie nga paragrafi 2 të këtij neni lëshon drejtori i Drejtorisë në bazë të kontrollit paraprakisht të kryer të sigurisë dhe vlerësimit për ekzistimin ose mosekzistimin e rrezikut të sigurisë nga trajtimi i informacioneve të klasifikuara.

Neni 39 fokusohet mbi një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me certifikatën e sigurisë si para kusht i nevojshëm për qasje në informacionet e klasifikuara të përdoruesve të informacioneve të klasifikuara.

Së këtejmi, në paragrafin e parë, ligjvënësi përcakton se certifikata e sigurisë u lëshohet personave të cilët i trajtojnë informacionet e klasifikuara për kryerjen e detyrave të punëve të tyre në përputhje me parimin "duhet të dini" ndërsa në paragrafin e dytë përcakton se certifikata e sigurisë lëshohet për qasje deri në nivelin përkatës të informacioneve të klasifikuara. Kjo nënkupton se niveli i klasifikimit të certifikatës së sigurisë duhet të korrespondoj, përkatësisht të jetë më së paku i njëjtë me nivelin e klasifikimit të informacioneve deri te të cilat përdoruesi ka nevojë akses. Kjo gjë nuk e kufizon përdoruesin të ketë qasje në informacionin të nivelit më të ulët të klasifikimit nga niveli i klasifikimit të certifikatës së sigurisë të cilën e posedon, por nuk lejon qasje në informacionin me nivel më të lartë të klasifikimit nga niveli i certifikatës së sigurisë. Me fjalë të tjera, certifikata e sigurisë së nivelit më të lartë të klasifikimit i përfshinë edhe nivelet më të ulëta, por jo edhe ato më të larta.

Veç tjerash, ligjvënësi e përcakton se personi i interesuar fizik ose juridik duhet të paraqes kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë që të fillojë procedura e lëshimit të certifikatës së sigurisë, me ç'rast përcakton se kërkesa paraqitet përmes oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara tek personi juridik. Përcaktimin e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, si njëri nga elementët kryesorë të sistemit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara i cili është inkorporuar me qëllim që të

mundësohet kryerje efikase dhe e koordinuar e të drejtave dhe detyrimeve që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara, ligjvënësi e rregullon në detaje në nenin 65 deri në nenin 68 të këtij ligji.

Për të punësuarit në Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, në paragrafin e pestë të këtij neni përcaktohet se procedura e lëshimit të certifikatës së sigurisë zbatohet përmes oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara pranë Drejtorisë.

Kjo nënkupton se "komunikimi" sa i përket kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë një personi të caktuar zhvillohet përmes oficerëve të sigurisë, përkatësisht oficerit të sigurisë të personit juridik aty ku punon personi i interesuar dhe e ridërgon kërkesën deri te Drejtoria për procedim të mëtutjeshëm.

Dispozita nga paragrafi i fundit të këtij neni përcakton se certifikatën e sigurisë e lëshon drejtori i Drejtorisë në bazë të kontrollit paraprakisht të kryer të sigurisë dhe vlerësimit për ekzistimin ose mos ekzistimin e rrezikut të sigurisë gjatë trajtimit të informacioneve të klasifikuara.

Lëshimi i certifikatës së sigurisë personave përdorues të informacioneve të klasifikuara rregullohet në detaje në aktin nënligjor.²³

Neni 40

Certifikatë sigurie për qasje dhe përdorim të informacioneve të klasifikuara të të gjitha niveleve, pa kontroll paraprak të sigurisë, për shkak të ushtrimit pa pengesë të funksionit nga dita e zgjedhjes deri në fund të mandatit, fitojnë: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, zëvendësit e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 40 përcaktohet përjashtimi nga dispozita e nenit paraprak, përkatësisht në mënyrë taksative janë theksuar personat të cilët për shkak të ushtrimit papengësë të funksionit nga dita e zgjedhjes deri në fund të mandatit pranojnë certifikatë sigurie për qasje dhe përdorim të informacioneve të klasifikuara të të gjitha niveleve pa kontroll paraprak të sigurisë. Ligjvënësi, siç thamë, në mënyrë taksative i specifikon titullarët e funksioneve më të larta publike në shtet, si vijon: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, zëvendësit e Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo listë e përjashtimeve u hartua në përputhje me standardet e përcaktuara ekzistuese ndërkombëtare që kanë të bëjnë me procedurën e lëshimit të certifikatave të sigurisë për qasje në informacionet e klasifikuara të titullarëve të funksioneve të larta shtetërore. Në lidhje me këtë çështje Ligji është mjaft restriktiv në krahasim me legjislacionin e shteteve të tjera, megjithatë, përvojat flasin se faktorët ndërkombëtarë pozitivisht e perceptojnë listën e shkurtër të përjashtimeve meqë numri i madh i

²³ Urdhëresë për sigurinë e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/04). Në rrjedhë e sipër është procedura e miratimit të Urdhëresës së re për sigurinë e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara.

përrjashtimeve mund të paraqes edhe një rrezik të madh sigurie sa u përket informacioneve të klasifikuara.

Neni 41

Certifikatë sigurie i lëshohet personit fizik i cili i plotëson kushtet si vijon:

- ▶ të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ▶ për certifikatë sigurie të nivelit "SEKRET SHTETËROR" të mos ketë shtetësi të shtetit tjetër,
- ▶ për certifikatë sigurie të nivelit "TEPËR SEKRET" të mos ketë shtetësi të shtetit i cili nuk është anëtar i NATO-s,
- ▶ të ekzistojë nevojë e arsyeshme për përdorimin e informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini",
- ▶ të ekzistojnë pengesa sigurie për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara gjë e cila konfirmohet me kontroll operativ,
- ▶ personi fizik të ketë zotësi për të vepruar,
- ▶ personi të ketë mbushur 18 vjet, ndërsa për përdorimin e informacioneve të klasifikuara të shënuara me nivelin "SEKRET SHTETËROR" të ketë mbushur 21 vjet,
- ▶ të mos i jetë shqiptuar sanksion ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ▶ të posedojë vërtetim se nuk është i dënuar, jo më i vjetër se gjashtë muaj,
- ▶ nga kontrolli operativ i personave të theksuar në pyetësorin e sigurisë të mos rezultojë ekzistimi i pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara.

Paralëshimittë certifikatës, personi duhet të trajnohet për trajtimin e informacioneve të klasifikuara.

Në nenin 41 ligjvënësi i definon kushtet e lëshimit të certifikatës së sigurisë për personin fizik.

Së këtëjmi, në alinenë e parë përcakton se personi fizik duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, por në alinenë e dytë përcakton se për certifikatën e sigurisë të nivelit "SEKRET SHTETËROR" personi nuk duhet të ketë shtetësi të dyfishtë, përkatësisht të mos jetë shtetas edhe i shtetit tjetër, ndërsa në alinenë e tretë e precizon se për certifikatën e sigurisë të nivelit "TEPËR SEKRET" personi fizik nuk duhet të jetë shtetas i shtetit i cili nuk është anëtar i NATO-s. Në këto dy aline ligjvënësi e definon qëndrimin rreth posedimit të shtetësisë së dyfishtë gjatë trajtimit me informacione të nivelit më të lartë të klasifikimit. Me fjalë të tjera, personave me shtetësi të dyfishtë, nuk do t'iu lëshohet certifikatë sigurie për nivelin më të lartë të klasifikimit pa përjashtim, ndërsa për nivelin më të ulët – "TEPËR SEKRET" me përjashtim, mund të lëshohet certifikatë sigurie për këtë nivel të personave me shtetësi të dyfishtë, por vetëm atyre personave shtetësia tjetër e të cilëve është e shtetit anëtarë në NATO-s.

Pastaj, pasojnë kushtet e tjera të cilat duhet t'i plotësojë personi fizik që të fitojë certifikatë sigurie, përkatësisht të ekzistoj nevojë e arsyeshme për përdorimin e

informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini", të mos ekzistojnë pengesa sigurie për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara gjë e cila konfirmohet me kontrollin operativ, personi fizik të ketë zotësi për të vepruar, të ketë mbushur 18 vjet, ndërsa për përdorimin e informacioneve të klasifikuara të shënuara me nivelin "SEKRET SHITETËROR" t'i ketë mbushur 21 vjet, të mos i jetë shqiptuar sanksion ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të posedojë vërtetim se nuk është dënuar i cili nuk është më i vjetër se gjashtë muaj dhe nga kontrolli operativ i personave të cekur në pyetësorin e sigurisë të mos rezultojë ekzistim i pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara (persona të familjes së tij dhe ngjashëm).

Në paragrafin e dytë të këtij neni ligjvënësi ka parashikuar se para lëshimit të certifikatës, personi duhet të trajnohet për trajtimin e informacioneve të klasifikuara, por së këtejmi nuk i ka rregulluar kushtet, përkatësisht nuk e ka parashikuar se për çfarë trajnimi bëhet fjalë dhe kush e realizon. Për këtë shkak, neni duhet të plotësohet me dispozita me të cilat do ta rregullojnë edhe lëshimin e certifikatës ose ndonjë lloj të dokumentit tjetër si vërtetim për trajnimin e kryer, si dhe të rregullohet kohëzgjatja, përkatësisht koha e vlefshmërisë së këtij dokumenti.

Neni 42

Certifikatë sigurie i lëshohet personit juridik i cili i plotëson kushtet si vijon:

- ▶ të jetë regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- ▶ të ekzistojë nevoja e arsyeshme për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini",
- ▶ të mos i jetë shqiptuar sanksion-ndalim për ushtrimin e veprimtarisë,
- ▶ t'i ketë siguruar kushtet e sigurisë fizike, sigurisë administrative dhe/ose sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit, nëse një gjë të këtillë e kërkojnë kushtet e marrëveshjes së klasifikuar,
- ▶ të ketë siguruar certifikatë sigurie për oficerin e sigurisë të informacioneve të klasifikuara në personin juridik,
- ▶ financiarisht dhe ekonomisht të jetë stabil dhe
- ▶ të mos ekzistojnë pengesa të sigurisë për trajtimin e informacioneve të klasifikuara gjë e cila konfirmohet me kontroll operativ.
- ▶ Stabiliteti financiar dhe ekonomik nga paragrafi 1 alineja 6 të këtij neni konfirmohet me dokumentet në vijim të cilat nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj:
 - ▶ certifikatë për regjistrimin e veprimtarisë,
 - ▶ dokument për bonitet nga organi kompetent,
 - ▶ provë nga autoriteti kompetent se nuk është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi,
 - ▶ provë nga autoriteti kompetent se me aktgjykim nuk i është shqiptuar masa e sigurisë-ndalim për ushtrimin e veprimtarive,
 - ▶ vërtetim nga autoriteti kompetent për tatime, kontribute dhe detyrime të tjera të paguara publike.

Në nenin 42 ligjvënësi i rregullon kushtet e lëshimit të certifikatës së sigurisë personit juridik. Së këtejmi në mënyrë taksative e specifikon se: personi juridik duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të ekzistoj nevojë e arsyeshme për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini", të mos i jetë shqiptuar sanksion-ndalim për ushtrimin e veprimtarisë, t'i ketë siguruar kushtet e sigurisë fizike, sigurisë administrative dhe/ose sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit nëse një gjë të këtillë e kërkojnë kushtet nga marrëveshja e klasifikuar, të ketë siguruar certifikatë sigurie për oficerin e sigurisë së informacioneve të klasifikuara në personin juridik, financiarisht dhe ekonomikisht të jetë stabil dhe të mos ekzistojnë pengesa sigurie për trajtimin e informacioneve të klasifikuara gjë e cila konfirmohet me kontrollin operativ. Këtu duhet të theksohet se përmbushjen e kushteve të përcaktuara nga ana e personit juridik, Drejtoria e kontrollon me ekipe të veta të ekspertëve, ndërsa kontrollin operativ e realizon autoriteti kompetent, përkatësisht Agjencia e Sigurisë Kombëtare.

Pastaj, ligjvënësi i rregullon në detaje provat me të cilat konstatohet stabiliteti financiar dhe ekonomik i personit juridik, përkatësisht dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për certifikatë sigurie si provë për stabilitetin financiar dhe ekonomik të personit juridik, dokumente këto të cilat nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj. Për më tepër, ligjvënësi ka parashikuar se personi juridik duhet të dorëzojë certifikatë nga regjistrimi i veprimtarisë, dokument për bonitet nga autoriteti kompetent, dëshmi nga autoriteti kompetent se nuk është hapur procedurë falimentimi ose likuidimi, provë nga autoriteti kompetent se me aktgjykim nuk i është shqiptuar masa e sigurisë-ndalim për kryerjen e veprimtarisë, si dhe vërtetim nga autoriteti kompetent për tatime, kontribute dhe detyrime të paguara publike.

Neni 43

Personi juridik konsiderohet se është i aftë ta sigurojë mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara nëse siguron kushte për zbatimin e masave dhe aktivitetëve për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të përcaktuara me këtë ligj.

Me dispozitën e nenit 43, e cila është e përgjithshme dhe referuese për nga karakteri i vet, ligjvënësi përcakton se personi juridik konsiderohet se është i aftë të sigurojë mbrojtje të informacioneve të klasifikuara nëse i siguron kushtet e zbatimit të masave dhe aktivitetëve për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të specifikuar me këtë ligj. Kjo e nënkupton përmbushjen e masave dhe aktivitetëve nga domeni i sigurisë administrative, nga domeni i sigurisë së personave përdorues të informacioneve të klasifikuara nga domeni i sigurisë fizike, sigurisë industriale dhe sigurisë së sistemeve të komunikimit-informacionit, varësisht nga fushëveprimi i punës, nevojës dhe vëllimit të qasjes deri te informacionet e klasifikuara. Domenet e specifikuar të sigurisë rregullohen me dispozita të tjera të këtij ligji.

PROCEDURAT E LËSHIMIT TË CERTIFIKATAVE TË SIGURISË

Neni 44

Plotësimi i kushteve për lëshimin e certifikatës së sigurisë konfirmohet përmes kontrollit të sigurisë.

Kontrolli i sigurisë nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në bazë të pëlqimit paraprak me shkrim nga personi fizik ose juridik i cili ka paraqitur kërkesë për lëshimin e certifikatës së sigurisë, e cila është pjesë përbërëse e kërkesës nga neni 39 paragrafi 3 të këtij ligji.

Nëse personi fizik ose juridik gjatë procedurës me shkrim e revokon pëlqimin e tij për kontroll, procedurë e serishme për kontrollin e sigurisë nuk mund të zbatohet para skadimit të një viti nga dita e revokimit të pëlqimit.

Ne nenin 44 është rregulluar se plotësimi i kushteve për lëshimin e certifikatës së sigurisë konfirmohet përmes kontrollit të sigurisë për të cilën gjë personi fizik ose juridik i cili ka paraqitur kërkesë për lëshimin e certifikatës së sigurisë paraprakisht jep pëlqim me shkrim për zbatim. Pëlqimi i këtillë është kusht logjik meqë kontrolli i sigurisë përfshinë veprime të cilat futen thellë në sferën e privatësisë madje përfshinë edhe të dhëna sensitive personale. Së këtejmi, personi ka të drejtë gjatë procedurës, ta revokoj pëlqimin. Megjithatë, kjo bart me vete edhe konsekuencë të caktuar, përkatësisht, nëse personi fizik ose juridik gjatë procedurës e revokon me shkrim pëlqimin e tij për kontroll, ligjvënësi ka parashikuar se procedurë e serishme të kontrollit të sigurisë nuk mund të zbatohet para skadimit të një viti nga dita e revokimit të pëlqimit.

Neni 45

Kontrolli i sigurisë zbatohet para lëshimi të certifikatës së sigurisë personave juridikë dhe fizikë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara, me qëllim të përcaktimit të ekzistimit ose mosekzistimit të rrezikut të sigurisë.

Kontrolli i sigurisë fillon pas paraqitjes së kërkesës nga neni 39 paragrafi 3 të këtij ligji, pranë Drejtorisë.

Të dhënat e plotësuara nga pyetësi i sigurisë janë pjesë e përmbajtjes së kontrollit të sigurisë.

Formën dhe përmbajtjen e formularëve të pyetësorit të sigurisë nga paragrafi 1 të këtij neni i përcakton drejtori i Drejtorisë, sipas koordinimit paraprak me shërbimet kompetente të ngarkuara për realizimin e kontrolleve operative të sigurisë.

Ligjvënësi detajisht rregullon kontrollin e sigurisë në nenin 45, me ç'rast parashikon se i njëjti zbatohet para lëshimit të certifikatës së sigurisë personave juridikë dhe fizikë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara, me qëllim të përcaktimit të ekzistimit ose mosekzistimit të rrezikut të sigurisë, dhe fillon me paraqitjen e kërkesës pranë Drejtorisë. Pastaj, ligjvënësi e përcakton se një pjesë të procedurës për lëshimin e certifikatës së sigurisë paraqesin të dhënat e plotësuara nga pyetësi i sigurisë, formën

dhe përmbajtjen e të cilit i përcakton drejtori i Drejtorisë. Ligjvënësi ka parashikuar që të përcaktohet përmbajtja dhe forma e formularëve të pyetësorit të sigorisë, por nuk e precizon për sa dhe për çfarë formularësh bëhet fjalë. Në bazë të dispozitave të tjera të ligjit dhe praktikës së deritanishme, mund të konkludohet se përcaktohen formularë të caktuar për nivelet e ndryshme të klasifikimit (varësisht nga kërkesa) dhe varësisht nga ajo se a bëhet fjalë për person fizik ose juridik.

Neni 46

Pyetësori i plotësuar për kontrollin e sigorisë shënohet me shënimin "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR".

Të dhënat nga pyetësori i plotësuar i sigorisë nga paragrafi 1 të këtij neni përdoren për qëllimet e kontrollit dhe me të njëjtat veprohet në përputhje me ligjin.

Në nenin 46 ligjvënësi ka parashikuar se pyetësori i plotësuar i kontrollit të sigorisë shënohet me shënimin "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" që nënkupton se pyetësori nuk mund të jetë i aksesshëm për publikun dhe përdoret vetëm për nevoja zyrtare, përmes respektimit të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.²⁴ Me shënimin "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" kufizohet shpërndarja e pyetësorit të sigorisë si dhe vihet në dukje se i njëjti do të përdoret vetëm për qëllimet e dedikimit, përkatësisht për nevojat e kontrollit të sigorisë. Në këtë drejtim është edhe dispozita e paragrafit të dytë të këtij neni me të cilën përcaktohet se të dhënat nga pyetësori i plotësuar i sigorisë përdoren për qëllimet e kontrollit dhe me të njëjtat veprohet në përputhje me ligjin. Kjo nënkupton se, për shembull, të dhënat personale mbrohen në përputhje me aktet normative për mbrojtjen e të dhënave personale etj.

Neni 47

Për përdorimin e informacioneve të klasifikuara të shënuara me nivelin "INTERN" nuk bëhet kontrolli i sigorisë dhe nuk lëshohet certifikatë sigurie.

Personi fizik ose personi përgjegjës në personin juridik njoftohet për detyrimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara nga paragrafi 1 të këtij neni që i janë dhënë për këqyrje, përkatësisht për trajtim.

Në nenin 47 ligjvënësi ka parashikuar se për përdorimin e informacioneve të klasifikuara të shënuara me nivelin "INTERN" nuk realizohet kontrolli i sigorisë dhe nuk lëshohet certifikatë sigurie, por personi fizik ose personi përgjegjës në personin juridik informohet për detyrimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara që u janë dhënë për këqyrje përkatësisht për trajtim. Kjo e nënkupton të ashtuquajturin brifing sigurie të cilin e zbaton personi i autorizuar i autoritetit, përkatësisht oficeri i sigorisë së informacioneve të klasifikuara me të cilin personi informohet për masat dhe procedurat e sigorisë dhe me obligimet e tij gjatë trajtimit dhe ruajtjes së informacioneve të klasifikuara. Më së paku në herë në vit, ndërsa sipas nevojës edhe më shpesh, nga oficeri i sigorisë së informacioneve të klasifikuara, përdoruesit e informacioneve të klasifikuara informohen përsëri për obligimet e tyre të cilat rezultojnë nga Ligji për informacione të klasifikuara(*). Pas njoftimit fillestar dhe njoftimit të serishëm me obligimet e tyre, përdoruesit e informacioneve të klasifikuara nënshkruajnë deklaratë me të cilën

konfirmojnë se plotësisht i kanë kuptuar dispozitat e Ligjit.

Nëse shkelen rregullat e trajtimit dhe mbrojtjes së këtyre informacioneve, personi duhet të jetë subjekt i përgjegjësisë dhe sanksionimit përkatës, varësisht se a bëhet fjalë për shkelje më të lehtë, kundërvajtje ose për ndonjë veprim apo abuzim të kundërligjshëm të kryer me dashje e që mund të trajtohet si vepër penale. Edhe pse bëhet fjalë për nivelin më të ulët të klasifikimit, duhet të theksohet se edhe informacionet kështu të klasifikuara duhet të jenë objekt i mbrojtjes dhe të njëjtat duhet të trajtohen me seriozitet dhe përgjegjësi.

Neni 48

Varësisht nga niveli i informacionit të klasifikuar për të cilin është paraqitur kërkesë për lëshimin e certifikatës së sigurisë për personin fizik, bëhet kontrolli i sigurisë në mënyrë përkatëse me nivelin e klasifikimit të informacionit edhe atë:

- a) të shkallës së parë për informacionin e klasifikuar "SEKRET";
- b) të shkallës së dytë për informacionin e klasifikuar "TEPËR SEKRET" dhe
- c) të shkallës së tretë për informacionin e klasifikuar "SEKRET SHTETËROR".

Në nenin 48 ligjvënësi përcakton tre shkallë të kontrollit të sigurisë të personit fizik të cilat korrespondojnë me nivelin e informacionit të klasifikuar për të cilin është paraqitur kërkesë për lëshimin e certifikatës së sigurisë. Si rezultat i kësaj ligjvënësi parashikon: kontroll sigurie të shkallës së parë për informacionin e klasifikuar në nivelin "SEKRET" kontroll sigurie të shkallës së dytë për informacionin e klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" dhe kontroll sigurie të shkallës së tretë për informacionin e klasifikuar në nivelin "SEKRET SHTETËROR".

Shkallët e ndryshme të kontrollit të sigurisë në detaje janë rregulluar në nenet në vijim të ligjit.

Neni 49

Përmes kontrollit të sigurisë së shkallës së parë kontrollohet:

- ▶ identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim) dhe kontrolli operativ i të dhënave për personin nga autoriteti kompetent,
- ▶ mosha prej më së paku 18 vjet,
- ▶ shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ▶ zotësia për të vepruar e personit (në bazë të vërtetimit nga organi kompetent) dhe
- ▶ ekzistimi i pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara tek personi (të konstatuara përmes zbatimit të kontrollit operativ nga ana e autoritetit kompetent).

Në lidhje me kontrollin e sigurisë të shkallës së parë,²⁵ në nenin 49 ligjvënësi ka parashikuar se kontrollohen: identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim) dhe kontrolli operativ i të dhënave për personin nga autoriteti kompetent,

²⁵ Kjo është rregulluar në detaje në aktin nënligjor, përkatësisht në Urdhëresën për sigurinë e personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/04). Në rrjedhë e sipër është procedura e miratimit të Urdhëresës së re për sigurinë e personave përdorues të informacioneve të klasifikuara.

mosha prej më së paku 18 vjet, shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zotësia për të vepruar e personit (në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent) dhe ekzistimi i pengesave të sigurisë tek personi për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara (të konstatuara përmes zbatimit të kontrollit operativ nga autoriteti kompetent).

Në mënyrë analoge me kontrollin e zotësisë së veprimit të personit në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent, ligjvënësi këtu nuk e ka parashikuar kontrollin e mos dënimit të personit në bazë të vërtetimit se nuk është dënuar, jo më i vjetër se gjashtë muaj, posedimi i të cilit si kusht për fitimin e certifikatës së sigurisë është përcaktuar në nenin 41 paragrafi 1 alineja 9. Megjithatë, duhet të merret parasysh se mos dënimi i personit kontrollohet edhe gjatë kontrollit operativ.

Neni 50

Përmes kontrollit të sigurisë të shkallës së dytë kontrollohet:

- ▶ identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim dhe kontrollit operativ të të dhënave të personit nga ana e autoritetit kompetent),
- ▶ mosha prej më së paku 18 vjet,
- ▶ shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ▶ zotësia e veprimit të personit (në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent) dhe
- ▶ ekzistimi i rrezikut ose pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara tek personi-aplikant për certifikatë sigurie dhe tek personat e theksuar në pyetësonin e sigurisë (me zbatimin e kontrollit operativ nga ana e autoritetit kompetent),
- ▶ personi të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër i cili nuk është anëtar i NATO-s.

Në nenin 50 ligjvënësi, duke e pasur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga data 20 prill të vitit 2011, ka parashikuar shtrirje më të gjerë të kontrollit të sigurisë të shkallës së dytë me ç'rast përveç kontrollit të personit aplikues për certifikatë sigurie, kontrolli operativ e përfshinë edhe kontrollin e personave të theksuar në pyetësonin e sigurisë.²⁶ Së këtejmi, me kontrollin e sigurisë të shkallës së dytë kontrollohet: identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim) dhe kontrolli operativ i të dhënave të personit nga autoriteti kompetent, mosha prej më së paku 18 vjet, shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zotësia për të vepruar e personit (në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent), ekzistimi i pengesave të sigurisë tek personi për qasje dhe trajtim të informacioneve

²⁶ Sipas iniciativave të paraqitura, në mbledhjen e mbajtur më datë 20.04.2012, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë nxori Vendim (U.nr.209/2010) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 61/11) për shfuqizimin e nenit 7 paragrafi 2 alinesë 2 dhe 3 të Urdhëresës për sigurinë e personave përdorues të informacioneve të klasifikuara **Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/04) e cila përmban dispozita se ekzistimi i rrezikut të sigurisë për personin për të cilin kërkohet lëshimi i certifikatës përkatëse të sigurisë, përcaktohet në bazë të kontrollit të sigurisë të zbatuar operativ për kandidatin, fëmijët e tij dhe bashkëshorten/in për kontrolle të shkallës së dytë, ndërsa për kontrollet e shkallës së tretë, në bazë të kontrollit të sigurisë të zbatuar operativ për kandidatin, fëmijët e tij, bashkëshorten/in, prindërit dhe për personat e tjerë me të cilët ai jeton në bashkësi të njëjtë familjare. Në Arsyetimin e Gjykatës kushtetuese të Vendimit të këtillë qëndron se në mungesë të dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë se kontrollit operativ i sigurisë duhet t'i përfshijë edhe personat e theksuar, e njëjta nuk mund të rregullohet me akt nënligjor të cilin e miraton Qeveria. Duke e pasur parasysh këtë që u tha paraprakisht gjatë hartimit të tekstit të ri të Ligjit për informacione të klasifikuara, ligjvënësi ka parashikuar me kontrollin operativ të shkallës së dytë të përfshihen edhe personat të cilët kandidati i certifikatës së sigurisë i ka cekur në pyetësonin e sigurisë, si nocion i përgjithshëm i cili i përfshinë prindërit, bashkëshorten/in dhe anëtarët e familjes më të ngushtë, si edhe personat mbi moshën 18 vjeçare të cilët jetojnë në familjen e njëjtë dhe prindërit e bashkëshortes/it për të cilët ekzistojnë rubrika të veçanta në pyetësonin e sigurisë.

të klasifikuara (të konstatuara përmes zbatimit të kontrollit operativ nga autoriteti kompetent) dhe personi të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër i cili nuk është anëtar i NATO-s, e që po ashtu verifikohet me kontrollin operativ.

Edhe në këtë nen ligjvënësi nuk ka parashikuar që kontrolli i sigurisë ta përfshijë kontrollin edhe të mos dënimit të personave në bazë të vërtetimit për mos dënim, jo më të vjetër se gjashtë muaj, posedimi i të cilit si kusht për fitimin e certifikatës së sigurisë është përcaktuar në nenin 41 paragrafi 1 alineja 9, siç e ka parashikuar kontrollin e zotësisë për të vepruar të personit në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent. Megjithatë, siç e theksuam edhe në komentin e nenit 49, mos dënimi i personit kontrollohet gjatë kontrollit operativ.

Neni 51

Përmes kontrollit të sigurisë të shkallës së tretë kontrollohet:

- ▶ identiteti i personit (në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim dhe kontrollit operativ të të dhënave të personit nga ana e autoritetit kompetent),
- ▶ mosha prej më së paku 21 vjet,
- ▶ shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ▶ zotësia e veprimit të personit në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent (në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent) dhe
- ▶ ekzistimi i rrezikut të sigurisë ose pengesave për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara tek personi aplikues për certifikatë sigurie dhe tek personat e theksuar në pyetësorin e sigurisë (përmes zbatimit të kontrollit operativ nga ana e autoritetit kompetent),
- ▶ përcaktimi i aftësisë së personit për trajtimin e informacioneve të klasifikuara përmes realizimit të intervistës nga ana e personit të autorizuar nga shërbimet kompetente të cilat i kryejnë kontrollet operative të sigurisë,
- ▶ personi të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër.

Shtirirjen e kontrollit të sigurisë të shkallës së tretë ligjvënësi e ka parashikuar në nenin 51, me ç'rast ka përcaktuar se kontrollohet: identiteti i personit – në bazë të dokumentacionit të dorëzuar me shkrim dhe kontrollit operativ të të dhënave të personit nga autoriteti kompetent, mosha prej më së paku 21 vjet, shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zotësia për të vepruar e personit që ka aplikuar për certifikatë sigurie dhe tek personat e theksuar në pyetësorin e sigurisë²⁷ (në bazë të vërtetimit nga autoriteti kompetent), ekzistimi i pengesave të sigurisë tek personi për qasje dhe trajtim me informacionet e klasifikuara (të konstatuara përmes zbatimit të kontrollit operativ nga autoriteti kompetent), përcaktimi i aftësisë së personit për trajtimin e informacioneve të klasifikuara përmes realizimit të intervistës nga ana e personit të autorizuar të shërbimeve kompetente të cilat i kryejnë kontrollet operative të sigurisë dhe personi të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër.

Përcaktimi i aftësisë së personit për trajtimin e informacioneve të klasifikuara përmes realizimit të intervistës nga ana e shërbimeve kompetente është risi e inkomporuar në këtë ligj. Praktika paraprake përfshinte bisedë/intervistë me personin-aplikues për

²⁷ Në kontekst të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese – U. nr. 209/2010 (shih. fusnotën paraprake), ligjvënësi ka parashikuar me kontrollin operativ të shkallës së tretë të përfshihen edhe personat të cilët kandidati për certifikatën e sigurisë i ka cekur në pyetësorin e sigurisë.

certifikatë sigurie të nivelit "SEKRET SHTETËROR" nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara sipas nevojës së vlerësuar nëse duhet të sqarohen informata të caktuara të fituara përmes kontrollit operativ për personin.

Sa i përket mos dënimit, kjo gjë kontrollohet gjatë kontrollit operativ, ndërsa ligjvënësi këtu nuk ka parashikuar kontroll të mos dënimit të personit në bazë të vërtetimit për mos dënim, jo më të vjetër se gjashtë muaj, të cilin vet personi e dorëzon dhe posedimi i tij është kusht për fitimin e certifikatës së sigurisë në përputhje me nenin 41 paragrafi 1 alineja 9.

Neni 52

Me kërkesë të Drejtorisë, kontrollet operative për ekzistimin e pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara i kryejnë:

- ▶ Agjencia e Sigurisë Kombëtare për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, përveç për personat e përcaktuar në alinenë 2 të këtij paragrafi dhe
- ▶ shërbimet kompetente të Ministrisë së Mbrojtjes për të gjithë të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 52 janë identifikuar shërbimet e sigurisë të cilat me kërkesë të Drejtorisë i kryejnë kontrollet operative për ekzistimin e pengesave të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara.

Për më tepër, është përcaktuar se Agjencia e Sigurisë Kombëtare i kryen kontrollet operative për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, përveç për personat e punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të cilët kontrollet operative i kryejnë shërbimet kompetente të Ministrisë së Mbrojtjes për të gjithë të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rast të kontrollit të personave të punësuar në Agjencinë e Zbulimit ose të diplomatëve, përkatësisht të personave të cilët kanë qëndruar dhe kanë punuar jashtë vendit, Agjencia e Zbulimit mund të dërgojë informacione për personat në fjalë deri te shërbimet kompetente, me ç'rast këto informacione do të merren parasysht në kuadër të kontrollit të përgjithshëm të sigurisë.²⁸

Neni 53

Procedura e zbatimit të kontrollit të sigurisë më së shumti zgjatë deri në:

- ▶ katër muaj për kontrollin e sigurisë të shkallës së parë për persona fizikë,
- ▶ gjashtë muaj për kontrollin e sigurisë të shkallës së dytë për persona fizikë,
- ▶ gjashtë muaj për kontrollin e sigurisë të shkallës së tretë për persona fizikë dhe
- ▶ gjashtë muaj për kontrollin e sigurisë për persona juridikë.

Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, procedura e kontrollit të sigurisë të shkallës së tretë për personat e caktuar në organet mbikëqyrëse të cilat bëjnë mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve, si dhe për ekspertët e angazhuar dhe të akredituar teknik kombëtarë dhe ndërkombëtarë nga organet e këtilla,

²⁸ Ligji për Agjencinë e Zbulimit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 21/21, neni 83.

në përputhje me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve, zgjatë një muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, procedura e kontrollit të sigurisë të shkallës së dytë për personat para themelimit të marrëdhënies së punës në Agjencinë Teknike-Operative, në përputhje me ligjin për Agjencinë Teknike-Operative, zgjatë një muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Në nenin 53 ligjvënësi i ka parashikuar afatet e procedurës së kontrollit të sigurisë me ç'rast ka përcaktuar se procedura e kontrollit të sigurisë të shkallës së parë për persona fizikë zgjatë më së shumti deri në katër muaj, ndërsa e njëjta zgjatë më së shumti deri në gjashtë muaj për kontrollin e sigurisë të shkallës së dytë për persona fizikë, për kontrollin e sigurisë të shkallës së tretë për persona fizikë dhe për kontrollin e sigurisë të personit juridik.

Ligjvënësi ka parashikuar edhe përjashtime, kështu që ka përcaktuar se afati i procedurës së kontrollit të sigurisë të shkallës së tretë për personat e caktuar në organet mbikëqyrëse të cilët kryejnë mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve, si dhe për ekspertët teknik të angazhuar dhe akredituar kombëtar dhe ndërkombëtarë nga këto organe, në përputhje me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve, zgjatë një muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës. Përjashtimi i dytë ka të bëjë me procedurën e kontrollit të sigurisë të shkallës së dytë për personat para lidhjes së marrëdhënies së punës me Agjencinë Teknike-Operative, në përputhje me Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative,²⁹ për të cilën ligjvënësi ka përcaktuar të zgjas një muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës. Në këto përjashtime, ligjvënësi nuk e ka parashikuar procedurën e kontrollit të sigurisë të shkallës së tretë për të punësuarit në Agjencinë Teknike-Operative.

Bëhet fjalë për parashikimin e procedurave më të shpejta (të zbatuara në afate më të shkurtra) për kategori të caktuara të personave ku nevojitet që procedura të kryhet më shpejtë, përkatësisht mungesa e zgjidhjes së këtillë mund të çojë në bllokimin e punës në këto fusha jashtëzakonisht të rëndësishme.

KOHËZGJATJA E CERTIFIKATAVE TË SIGURISË

Neni 54

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informacionin e klasifikuar në nivelin "SEKRET SHTETËROR" vlen pesë vjet.

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informacionin e klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" vlen dhjetë vjet.

Certifikata e sigurisë e lëshuar për informacionin e klasifikuar në nivelin "SEKRET" vlen dhjetë vjet.

²⁹ Ligji për Agjencinë teknike-operative, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19, neni 17, paragrafët 4 dhe 6.

Përmbajtjen dhe format e formularëve të certifikatave të sigurisë nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Në nenin 54 ligjvënësi e ka parashikuar rëndësinë e certifikatave të sigurisë. Së këtijmi ka përcaktuar kohëzgjatje të ndryshme të certifikatave të sigurisë të lëshuara për nivele të ndryshme të klasifikimit. Kështu që, certifikata e sigurisë e lëshuar për informacionin e klasifikuar në nivelin "SEKRET SHITETËROR" vlen pesë vjet, ndërsa për informacionin e klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" dhe në nivelin "SEKRET" vlen dhjetë vjet. Me dispozitë në paragrafin e katërt të këtij neni, ligjvënësi ka parashikuar që përmbajtjen dhe formën e formularit të certifikatës së sigurisë t'i përcaktojë drejtori i Drejtorisë.

Ligjvënësi nuk e ka parashikuar vlefshmërinë e certifikatës së sigurisë gjatë kohëzgjatjes së ndonjë aktiviteti ose kryerjes së shërbimit, për shembull, shkuarja në mision dhe ngjashëm. Kjo për shkak se në këtë rast respektohet parimi "duhet të dini", kështu që edhe pse personi posedon certifikatë sigurie me vlefshmëri deri në 10 vjet, pas ndërprerjes së nevojës për të njëjtën, përkatësisht pas përfundimit të aktivitetit ose të misionit për qëllimin e të cilit i është lëshuar, vlefshmëria e certifikatës së sigurisë do të skadojë në përputhje me nenin 60 paragrafi 1 alineja 2 të këtij ligji.

Neni 55

Përdoruesi i informacioneve të klasifikuara e ka për detyrë të paraqesë kërkesë të re për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë më së voni gjashtë muaj para ditës së skadimit të vlefshmërisë së saj.

Për personin fizik dhe juridik i cili paraqet kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë, bëhet kontroll i serishëm i sigurisë në përputhje me këtë ligj në mënyrë përkatëse me nivelin e informacioneve të klasifikuara që i kalohen në përdorim.

Në nenin 55 ligjvënësi e ka rregulluar detyrimin e përdoruesit të informacioneve të klasifikuara të paraqesë kërkesë të re për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë edhe atë më së voni gjashtë muaj para ditës së skadimit të vlefshmërisë së saj. Qëllimi i detyrimit të këtillë është të pengohet vakumi i llojit të vet i cili mund të shkaktohet nëse personi pret që të skadojë vlefshmëria e certifikatës së sigurisë para se ta kërkojë vazhdimin e saj, para së gjithash, duke e pasur parasysh se Ligji nuk parashikon mundësi për lëshimin e certifikatës së përkohshme të sigurisë. Duke e pasur parasysh faktin se vazhdimi nënkupton zbatim të kontrollit të ri përkatës të sigurisë, është e qartë se ky proces duhet të fillojë më herët. Së këtijmi, ky afat prej gjashtë muajsh është harmonizuar me afatet e kohëzgjatjes së procedurës së kontrollit të sigurisë të specifikuar në nenin 53.

Në paragrafin e dytë të këtij neni ligjvënësi e vë në dukje atë se me kërkesën për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë, për personin fizik dhe juridik i cili e paraqet kërkesën bëhet kontroll i serishëm i sigurisë në mënyrë përkatëse me nivelin e informacioneve të klasifikuara që i kalohen në përdorim. Kontrolli i sigurisë njëherë i kryer nuk do të thotë se janë fituar të dhëna të cilat nuk ndryshojnë, kështu që, çdo person i cili ka qasje në informacione të klasifikuara, do të duhej periodikisht të jetë objekt i kontrollit përkatës (ndërsa sipas indicieve përkatëse edhe më shpesh), kështu që ligjvënësi e ka parashikuar detyrimin për kontroll të serishëm të sigurisë me rastin e

çdo kërkesë për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës.

Neni 56

Nëse konstatohet se personi fizik ose juridik nuk i trajton informacionet e klasifikuara në përputhje me këtë ligj ose nëse tanimë nuk përmbushet ndonjëri nga kushtet në bazë të të cilëve është lëshuar certifikata e sigurisë, drejtori i Drejtorisë miraton aktvendim për heqjen e certifikatës së sigurisë edhe para skadimit të vlefshmërisë së saj.

Në aktvendimin nga paragrafi 1 të këtij neni nuk jepet arsyetim për shkaqet e heqjes së certifikatës së sigurisë.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni për heqjen e certifikatës së sigurisë edhe para skadimit të vlefshmërisë së saj, personi ka të drejtë ankimi deri te Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën e heqjes së certifikatës së sigurisë.

Në nenin 56 është rregulluar procedura e heqjes së certifikatës së sigurisë edhe para skadimit të vlefshmërisë së saj nga ana e drejtorit të Drejtorisë nëse konstatohet se personi fizik ose juridik nuk vepron me informacionet e klasifikuara në përputhje me Ligjin apo tanimë nuk përmbushet ndonjëri nga kushtet në bazë të të cilëve është lëshuar certifikata e sigurisë. Këtë e përcakton oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara në autoritetin në të cilin është i punësuar personi fizik ose eksperti i sigurisë së informacioneve të klasifikuara, i cili mund të bëjë këqyrje mbi punën e personit fizik, përkatësisht personit juridik me informacione të klasifikuara. Ligjvënësi e ka parashikuar që për një gjë të këtillë drejtori i Drejtorisë të miratojë aktvendim për heqjen e certifikatës së sigurisë në të cilin nuk jepet arsyetim për shkaqet e heqjes së certifikatës së sigurisë.³⁰ Shkaqet se pse nuk jepet arsyetim, ligjvënësi, me sa duket, i sheh në mundësinë që me vet arsyetimin të zbulohen informacione të cilat në atë moment duhet të mbesin të fshehta.

Megjithatë, në paragrafin e tretë të nenit ligjvënësi e ka rregulluar të drejtën e personit që të ankimojë aktvendimin e këtillë para Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën e heqjes së certifikatës së sigurisë. Kjo nënkupton se Komisioni Shtetëror fillimisht e shqyrton mënyrën e zbatimit të procedurës për heqjen e saj, dhe sipas rregullit, nuk futet në shkaqet e heqjes së certifikatës. Megjithatë, nëse anëtarët e Komisionit kanë informatë për përmbajtjen e ndonjë informacioni të klasifikuar gjatë vetë procedurës, janë të detyruar ta ruajnë fshehtësinë e informacionit të këtillë në përputhje me nenin 104 të këtij ligji.

³⁰ Sipas iniciativës së paraqitur, në mbledhjen e mbajtur më datë 21.09.2005, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë miratoi Aktvendim (U.nr. 213/2004) se nuk hapet procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 54 paragrafit 2 dhe nenit 55 paragrafi 2 të Ligjit për informacionet e klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/04) të cilët përmbajnë dispozita se nuk jepet arsyetim për shkaqet e ndërprerjes së vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë. Në arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë zgjidhje qëndron se "meqë certifikata e sigurisë nuk është akt klasik administrativ me të cilin zgjidhen të drejtat individuale të qytetarëve, por e drejta e qasjes dhe përdorimit të informacioneve të klasifikuara për qasje në një materie-fushë specifike siç është siguria e mbrojtjes së shtetit, Gjykata konstatoi se nuk mund parashtrahet pyetja e harmonizimit të dispozitave të kontestuara ligjore me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë".

Neni 57

Drejtori i Drejtorisë mund të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë për persona fizikë dhe juridikë nëse nuk janë përmbushur kushtet e këtij ligji.

Në aktvendimin nga paragrafi 1 të këtij neni nuk jepet arsyetim për shkaqet e refuzimit të kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 të këtij neni personi, kërkesa e të cilit është refuzuar, mund të paraqesë ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën e lëshimit të certifikatës së sigurisë.

Në nenin 57 ligjvënësi e ka rregulluar edhe mundësinë që drejtori i Drejtorisë të ketë mundësi të miratojë aktvendim për refuzimin e kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë për persona fizikë dhe juridikë nëse nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara me këtë ligj. Edhe në këtë aktvendim nuk është parashikuar të jepet arsyetim për refuzimin e kërkesës, ndërsa personi ka të drejtë të njëjtin ta ankimojë para Komisionit Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në lidhje me procedurën e lëshimit të certifikatës së sigurisë.

Refuzimi i kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë, siç mund të konkludohet edhe pse nuk është arsyetuar, nuk është vendim diskrecioni pa bazë, përkatësisht ky është rezultat i mos përmbushjes së kushteve ligjore, por më së shpeshti shkaqet e refuzimit të rastit konkret duhet të jenë të fshehta sepse, për shembull, janë objekt i hetimit ose paraqesin rreziqe ose kërcënime të detektuara të cilat duhet të shqyrtohen në mënyrë përkatëse, dhe së këtejmi edhe nevoja të mos ketë arsyetim.

Neni 58

Ankesa nga neni 56 paragrafi 3 dhe nenit 57 paragrafi 3 të këtij ligji paraqitet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, deri te Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Aktvendimi sipas ankesës nga paragrafi 1 të këtij neni, i miratuar nga Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, është përfundimtar.

Në paragrafin e parë të nenit 58 ligjvënësi e përcakton afatin prej 15 ditësh për paraqitjen e ankesës deri te Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, ndërsa në paragrafin e dytë e përcakton se aktvendimin të cilin e miraton Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë është përfundimtar.

Komisioni i lartpërmendur është themeluar me Ligjin për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të

Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.³¹ Kundër aktvendimit të Komisionit, konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, mund të ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente

Neni 59

Kërkesë për lëshimin e serishëm të certifikatës së sigurisë të nivelit të njëjtë ose më të lartë mund të paraqitet:

- pas skadimit të një viti nga plotfuqishmëria ose nga aktvendimi përfundimtar për refuzimin e kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë dhe pas skadimit të tre viteve nga plotfuqishmëria ose nga aktvendimi përfundimtar për heqjen e certifikatës së sigurisë para skadimit të vlefshmërisë.

Gjatë lëshimit të serishëm të certifikatës së sigurisë për personat nga paragrafi 1 të këtij neni, certifikata e sigurisë vlen një vit.

Në nenin 59 ligjvënësi i definon afatet kur mund të paraqitet kërkesë për lëshimin e serishëm të certifikatës së sigurisë në nivelin e njëjtë ose në nivel më të lartë kur një personi i është refuzuar kërkesa që t'i lëshohet certifikatë e sigurisë ose kur ka pranuar certifikatë, por e njëjta është hequr. Për më tepër, varësisht nga shkaku se pse është miratuar aktvendim "negativ" ligjvënësi ka parashikuar afate të ndryshme, kështu që përcakton i njëjti të mund të paraqitet pas skadimit të një viti nga plotfuqishmëria e aktvendimit ose nga aktvendimi përfundimtar për refuzimin e kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë dhe pas skadimit të tre viteve nga plotfuqishmëria e aktvendimit ose nga aktvendimi përfundimtar për heqjen e certifikatës së sigurisë para skadimit të vlefshmërisë. Shkaku i përcaktimit të afatit të ndryshëm kohor kur personi mund të paraqes kërkesë për lëshimin e serishëm të certifikatës së sigurisë me nivel të njëjtë ose më të lartë ka të bëjë me seriozitetin më të madh të shkaqeve për shkak të të cilave miratohet aktvendim për heqjen e certifikatës së sigurisë.

Në rast të përgjigjes pozitive, parashikohet certifikata e lëshuar të vlej një vit. Kjo meqë edhe pse për momentin është përcaktuar se janë plotësuar kushtet e lëshimit të certifikatës së sigurisë, shkaqet për shkak të të cilave personi paraprakisht është refuzuar ose i është hequr certifikata vazhdojnë të qëndrojnë "pezull" në ajër si indicie se ai person mund të jetë një rrezik potencial i llojit të vet, kështu që vlefshmëria e certifikatës është më e shkurtër nga ajo e zgjidhjes themelore, që nënkupton kontroll të serishëm të sigurisë nëse pas skadimit të vlefshmërisë së asaj certifikate prej një viti, personi kërkon vazhdimin e saj. Duke e pasur parasysh faktin se personi duhet të kërkojë vazhdim së paku 6 muaj para skadimit të vlefshmërisë, kjo do të thotë se kontrolli i ardhshëm i sigurisë mund të fillojë pas gjashtë muajsh nga lëshimi i certifikatës të nenit 59, paragrafi 2.

³¹ Ligji për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/11, 148/13, 41/14, 130/14, 53/16 dhe 11/18.

Neni 60

Certifikata e sigurisë pushon të vlejë me skadimin e afatit të vlefshmërisë së saj si edhe në rast të:

- ▶ pushimit të funksionit të personave nga neni 40 të këtij ligji,
- ▶ ndërprerjes së nevojës për qasje në informacione të klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini",
- ▶ aftësisë së zvogëluar mendore për veprim me informacione të klasifikuara të përcaktuar nga institucioni kompetent mjekësor,
- ▶ vdekjes së personit fizik ose ndërprerjes së funksionimit të personit juridik.

Në rastet nga paragrafi 1 alinetë 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, oficeri i sigurisë të informacioneve të klasifikuara ua kthen certifikatat e sigurisë personave fizikë dhe/ose juridikë në Drejtori në afat prej 15 ditësh nga konstatimi i të njëjtave.

Në nenin 60 është përcaktuar se kur pushon të vlejë certifikata e sigurisë. Së këtejmi, krahas bazës kryesore për pushimin e vlefshmërisë, ndërsa kjo është pas skadimit të afatit të parashikuar, ligjvënësi ka parashikuar edhe disa raste.

Rasti i parë ka të bëjë me personat të cilët në përputhje me Ligjin pranojnë certifikatë sigurie për qasje dhe përdorim të informacioneve të klasifikuara të të gjitha niveleve, pa kontroll paraprak të sigurisë, për shkak të ushtrimit papengesa të funksionit nga dita e zgjedhjes deri në fund të mandatit (neni 40). Kështu që, pas përfundimit të funksionit të tyre, përkatësisht në fund të mandatit pushon të vlejë edhe certifikata e sigurisë e cila u është lëshuar për kryerjen e detyrave.

Rasti i dytë ka të bëjë me ndërprerjen e nevojës për qasje në informacionet e klasifikuara në përputhje me parimin "duhet të dini". Kjo nënkupton se personi i cili në një moment të caktuar ka pasur nevojë për qasje në informacionet e klasifikuara për shkak të kryerjes së detyrave të punës për të cilat ka pasur nevojë të ketë qasje në informacionet e klasifikuara, në rast të risistemimit të tij në vend pune për të cilin nuk është e nevojshme qasja deri te informacionet e klasifikuara tanimë nuk ka nevojë për certifikatë sigurie dhe me këtë pushon të vlejë certifikata e sigurisë kur për personin në fjalë është përmbyllur parimi "duhet të dini". E njëjta vlen edhe kur personi kalon në pozitë pune nga një institucion në një institucion tjetër meqë edhe në këtë rast mund të pushojë të vlejë parimi "duhet të dini" në bazë të të cilit është lëshuar certifikata e sigurisë.

Ligjvënësi e ka parashikuar që vlefshmëria e certifikatës së sigurisë të pushojë edhe në rast të aftësisë së zvogëluar mendore për veprim me informacione të klasifikuara të konstatuar nga institucioni kompetent mjekësor. Ky rast nuk është rregulluar në detaje me Ligjin, i cili nuk përmban dispozita me të cilat do të rregullohej mënyra e përcaktimit të aftësisë së zvogëluar të personit i cili posedon certifikatë të vlefshme sigurie ose procedura e pranimit të mendimit nga institucioni kompetent mjekësor. Dispozita e përcaktuar e Ligjit presupozon se në rast të informatës për ekzistimin e rrezikut të sigurisë mbi informacionet e klasifikuara për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore të personit i cili i trajton të njëjtat të konfirmuar nga institucioni kompetent mjekësorë, certifikata e lëshuar e sigurisë do të pushojë të vlejë.

Rasti i fundit për të cilin është parashikuar të pushojë vlefshmëria e certifikatës së sigurisë është vdekja e personit fizik ose ndërprerja e funksionimit të personit juridik.

Në paragrafin e fundit të këtij neni është rregulluar detyrimi i oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara t'ia kthejë certifikatat e sigurisë personave fizikë dhe/ose juridikë Drejtorisë në afat prej 15 ditësh nga konstatimi i pushimit të vlefshmërisë së të njëjtave.

Neni 61

Leja për qasje në informacione të klasifikuara pushon të vlejë:

- ▶ me skadimin e afatit të vlefshmërisë të shënuar në leje,
- ▶ me kryerjen e detyrës për të cilën është lëshuar,
- ▶ nëse nevoja e lëshimit të lejes ka pushuar së ekzistuari ose është ndryshuar dhe
- ▶ nëse konstatohet se personi juridik dhe fizik nuk vepron me informacionet e klasifikuara në përputhje me ligjin.

Në nenin 61 është rregulluar pushimi i vlefshmërisë së lejes për qasje në informacionet e klasifikuara, me ç'rast ligjvënësi ka parashikuar që e njëjta të pushojë të vlejë me skadimin e afatit të vlefshmërisë të shënuar në leje, me kryerjen e detyrës për të cilën është lëshuar, nëse nevoja e lëshimit të lejes ka pushuar së ekzistuari ose është ndryshuar dhe nëse konstatohet se personi juridik dhe fizik nuk vepron me informacionet e klasifikuara në përputhje me Ligjin. Në të vërtetë, përmes mbikëqyrjes inspektuese nga inspektori i sigurisë së informacioneve të klasifikuara, konstatohet se personi juridik dhe fizik nuk vepron me informacionet e klasifikuara në përputhje me Ligjin.

Leja për qasje në informacione të klasifikuara, në të vërtetë, në përputhje me nenin 6, paragrafi 1, alineja 10, është dokument me të cilin konfirmohet se personi i huaj fizik ose juridik posedon certifikatë sigurie të lëshuar në shtetin amë dhe ka të drejtë të qasjes dhe përdorimit të informacioneve të klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut kështu që në bazë të këtij neni (61), në mënyrë të tërthortë vijmë deri te informatat se ajo u lëshohet personave të huaj të cilëve ajo u nevojitet, përkatësisht ka nevojë ata të kenë qasje në informacionet e klasifikuara në shtetin tonë, përkatësisht kjo ndërlidhet me ndonjë detyrë dhe ngjashëm. Së këtijmi, pushimi i ekzistimit të bazave të këtilla, si dhe mos trajtimi i informacioneve të klasifikuara në përputhje me Ligjin është bazë për pushimin e vlefshmërisë së lejes për qasje.

Me pushimin e vlefshmërisë së lejes për qasje nuk pushon vlefshmëria e certifikatës së sigurisë të lëshuar në shtetin amë, por ajo vetvetiu nuk mjafton që personi të huaj fizik dhe juridik të ketë qasje në informacionet e klasifikuara, kështu që leja për qasje është *conditio sine qua non* ("kusht pa të cilin nuk mundet").

Neni 62

Detyrimi për mbrojtjen e fshehtësisë së informacioneve të klasifikuara vazhdon edhe pas skadimit të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë.

Në nenin 62 është rregulluar detyrimi për mbrojtjen e fshehtësisë së informacioneve të klasifikuara edhe pas skadimit të vlefshmërisë së certifikatës së sigurisë. Kjo dispozitë nënkupton se përdoruesi i informacioneve të klasifikuara ka detyrim të njëjtat t'i mbrojë edhe pas ndërprerjes së nevojës së tij për qasje në informacionet e klasifikuara.

ra në përputhje me parimin "duhet të dini", përkatësisht të gjitha informatat në lidhje me të njëjtat t'i ruaj si fshehtësi.

Shkelja e këtij detyrimi varësisht nga rrethanat mund të paraqesë edhe vepër të caktuar penale.

Neni 63

Për nevojat e procedurës gjyqësore ose të procedurës para ndonjë autoriteti tjetër kompetent në të cilin përdoren informacione të klasifikuara, nevojitet që subjektet gjatë procedurës të posedojnë certifikatë sigurie.

Procedura e paragrafit 1 të këtij neni zhvillohet me prezencën e personit për të drejtat, detyrimet ose përgjegjësitë e të cilit vendoset në kuadër të të njëjtave edhe atëherë kur personi nuk ka certifikatë sigurie

Personi nga paragrafi 2 i këtij neni është përgjegjës për përmbushjen e detyrimit për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me këtë ligj.

Në procedurën e paragrafit 1 të këtij neni, publiku është përjashtuar.

Në rastin kur krijuesi i informacionit të klasifikuar nuk e ka paraqitur informacionin e klasifikuar në procedurën nga paragrafi 1 të këtij neni, gjykata, përkatësisht autoriteti kompetent, e ka për detyrë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i informacionit të klasifikuar ta njoftojë krijuesin dhe Drejtorinë për përdorimin e saj në procedurën.

Në nenin 63 është rregulluar nevoja e posedimit të certifikatës së sigurisë nga subjektet/personat që marrin pjesë në procedurë gjyqësore ose në procedurë para autoritetit tjetër kompetent në të cilën përdoren informacione të klasifikuara.

Me qëllim të respektimit të së drejtës së mbrojtjes, e cila është njëra nga të drejtat themelore të të akuzuarit dhe ky është një parim i garantuar me Kushtetutë (neni 12 i Kushtetutës) ligjvënësi ka parashikuar që procedura të zhvillohet para personit për përgjegjësinë e të cilit vendoset në kuadër të tij edhe kur personi nuk posedon certifikatë sigurie. Megjithatë, në pjesën e procedurave gjyqësore një gjë e këtillë nuk është e kufizuar vetëm me procedurën penale, por ka të bëjë me cilëndo qoftë procedurë gjyqësore në të cilën vendoset edhe për të drejta dhe detyrime të një personi (për shembull, kontest civil, kontest nga marrëdhënia e punës), dhe jo vetëm për përgjegjësi. Për më tepër, janë përfshirë edhe procedura të tjera të cilat zhvillohen para autoriteteve kompetente. Përdorimi i informacioneve të klasifikuara në cilëndo qoftë procedurë nuk duhet **per se** të jetë bazë për deklasifikimin e saj, por mbrojtjen e saj ligjvënësi edhe më tutje e siguron përmes parashikimit të përgjegjësisë për personin sa i përket përmbushjes së detyrimit për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me këtë ligj. Kjo nënkupton se të gjithë subjektet dhe personat që posedojnë certifikatë sigurie, si edhe personat që janë pjesë e procedurës, ndërsa nuk posedojnë certifikatë të këtillë, në bazë të dispozitave të këtij ligji janë të obliguar t'i mbrojnë informacionet e klasifikuara, përkatësisht ta ruajnë fshehtësinë e tyre.

Për shkak të realizimit të mbrojtjes paraprakisht të stipuluar të informacioneve të klasifikuara të cilat përdoren në procedura të ndryshme gjyqësore ose në procedura të

tjera para autoriteteve kompetente shtetërore, në paragrafin 4 ligjvënësi ka përcaktuar se publiku përjashtohet në procedurat në të cilat përdoren informacione të klasifikuara, me qëllim që të kufizohet qasja deri te informacionet e klasifikuara nga ana e personave të paautorizuar, përkatësisht nga një rreth më i gjerë i personave.

Me qëllim të rregullimit të situatës kur krijuesi i informacionit të klasifikuar nuk e ka paraqitur informacionin e klasifikuar në procedurën, ligjvënësi ka parashikuar që gjykata, përkatësisht autoriteti kompetent ta ketë detyrimin në afat prej 15 ditësh nga pranimi i informacionit të klasifikuar ta informojë krijuesin dhe Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara për përdorimin e saj gjatë procedurës.

Çështja e përdorimit të informacioneve të klasifikuara në procedurë gjyqësore ose në procedurë para autoritetit tjetër kompetent për herë të parë rregullohet me këtë ligj edhe pse edhe neni 354 i Ligjit për procedurë penale parashikon mundësi për përjashtimin e publikut, mes tjerash, edhe për shkak të ruajtjes së "sekretit shtetëror, ushtarak, zyrtar ose të sekretit të rëndësishëm afarist".³² Siç mund të shohim, në Ligjin për procedurë penale akoma përdoret terminologjia e vjetër, edhe pse qysh në vitin 2004 me Ligjin për informacione të klasifikuara janë parashikuar katër nivelet e klasifikimit "sekret shtetëror", "tepër sekret", "sekret" dhe "intern". Gjithsesi se nevojitet këto zgjidhje të harmonizohen dhe të sigurohet konsistencë të legjislacionit relevant.

Siç theksuam edhe më lartë, është e shpeshtë dukuria e përcaktimit të nivelit të klasifikimit të provave të siguruara përmes përdorimit të masave të posaçme hetuese (MPH). Pastaj të njëjtat më së shpeshti deklasifikohen dhe shënohen me shenjën "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR" (procedurë gjyqësore).

Edhe një herë theksojmë se nëse ka nevojë për mbrojtje të mëtutjeshme të informacionit, ai nuk ka nevojë të deklasifikohet, por si i këtillë mundet (i klasifikuar) të jetë pjesë e procedurës me përjashtimin e publikut.

Nëse krijuesi i informacionit është i mendimit se duhet ta deklasifikojë, kjo fillimisht nënkupton se ai do të përdoret në procedurë në të cilën publiku nuk është përjashtuar. Së këtejmi, është e qartë se për këto çështje nevojiten diskutime dhe trajnime në të cilat do të përfshihen të gjitha subjektet relevante. Nuk duhet të harrojmë se klasifikimi i masave MPH (veçanërisht të niveleve më të larta "SEKRET SHTETËROR" ose "TEPËR SEKRET") e nënkupton edhe përmbushjen e kushteve të rrepta për mbrojtje nga çdo lloj, duke e përfshirë edhe mbrojtjen kriptografike, nëse informacioni transferohet në mënyrë elektronike, rregulla të rrepta për kopje, riprodhime etj. Krijuesit e informacioneve të klasifikuara duhet t'i kenë parasysh të gjitha kushtet ligjore ndërsa rekomandohet të merren parasysh edhe udhëzimet dhe shembujt më konkret të prezantuar në Udhëzuesin për përcaktimin e nivelit të klasifikimit të informacioneve të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, veçanërisht nëse krijuesi ka dyshime rreth nivelit të klasifikimit i cili duhet t'i përcaktojë edhe konsekuencat të cilat rezultojnë nga e njëjta.

Neni 64

Drejtoria mban evidencë për certifikatat e lëshuara të sigorisë dhe për pyetësorët e plotësuar të sigorisë.

Drejtoria mban evidencë të posaçme për lejet e lëshuara për qasje në informacionet e klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

³² Ligji për procedurë penale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18.

Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Në nenin 64 është rregulluar detyrimi i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara të mbajë evidencë për certifikatat e lëshuara të sigurisë dhe për pyetësorët e plotësuar të sigurisë, si dhe evidencë të posaçme për lejet e lëshuara për qasje në informacionet e klasifikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Lejet për qasje në informacionet e klasifikuara janë objekt i evidencës së veçantë meqë ato u lëshohen personave të huaj fizikë ose juridikë të cilët tanimë posedojnë certifikatë sigurie nga shteti amë.

Ligjvënësi e ka parashikuar që përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave të këtilla t'i përcaktoj drejtori i Drejtorisë me akt nënligjor.

KREU I KATËRT

AUTORITETET PËR MBROJTJEN E INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

OFICER I SIGURISË SË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Neni 65

Autoritetet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe persona të tjerë juridikë, e kanë për detyrë të krijojnë kushte të nevojshme për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të ndërmarrin masa për eliminimin e pasojave negative nëse vjen deri në zbulimin e informacioneve të klasifikuara.

Për realizimin efikas dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara, në subjektet e paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara.

Në nenin 65 ligjvënësi e rregullon detyrimin e autoriteteve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit ose komunat në Qytetin e Shkupit si dhe personave të tjerë juridikë, të krijojnë kushte të nevojshme për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të ndërmarrin masa për eliminimin e pasojave negative nëse vinë deri në zbulimin e informacioneve të klasifikuara. Në kuadër të këtij detyrimi të tyre, ligjvënësi ka parashikuar se subjektet e theksuara duhet të caktojnë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara i cili do të mundësojë realizim efikas dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve që kanë të bëjnë me informacionet e klasifikuara.

Rrejt i oficerëve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara është një segment i rëndësishëm i sistemit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara meqë oficerët e sigurisë së informacioneve të klasifikuara konsiderohen si personeli kryesor për qëndrueshmëri, zbatim dhe mbikëqyrje mbi politikat e sigurisë për punë me informacione të klasifikuara në secilin nga subjektet relevante në të cilat trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara.

Neni 66

Personi përgjegjës në subjektet e nenit 65 paragrafi 1 të këtij ligji përcakton një ose më shumë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, varësisht nga numri dhe vëllimi i informacioneve të klasifikuara të cilat i trajton subjekti.

Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, varësisht nga numri dhe vëllimi i informacioneve të klasifikuara, personi përgjegjës në subjektin mund t'i kryej punët e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara.

Oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara e ka për detyrë të hartojë dhe paraqes raporte tremujore për punën e vet dhe për gjendjen me informacionet e klasifikuara drejtpërdrejt deri te personi përgjegjës, përveç rastit nga paragrafi 2 të këtij neni.

Nëse brenda subjektit përcaktohen më shumë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, personi përgjegjës e cakton njërin prej tyre për koordinim me Drejtorinë.

Në nenin 66 ligjvënësi ka parashikuar se personi përgjegjës në subjektet në të cilat trajtohen dhe ruhen informacionet e klasifikuara, përkatësisht në subjektet e theksuara në nenin paraprak, do të caktojë një ose më shumë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, varësisht nga numri dhe vëllimi i informacioneve të klasifikuara të cilat i trajtohen në subjektin.

Një bazë plotësuese për përcaktimin e më shumë oficerëve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara brenda një subjekti, të cilin ligjvënësi nuk e ka identifikuar mund të konsistojë me numrin e madh të personave të punësuar të cilët kanë nevojë për qasje deri te informacionet e klasifikuara meqë kjo paraqet edhe vëllim më të madh të detyrave dhe aktiviteteve për oficerin e sigurisë. Pikërisht përvojat tregojnë se përdoruesit e mëdhenj të informacioneve të klasifikuara, përkatësisht subjektet me numër të madh të të punësuarve në të cilat trajtohen dhe ruhen një numër i madh i informacioneve të klasifikuara, ka nevojë për më shumë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara.

Për më tepër, ligjvënësi ka parashikuar edhe përjashtim në të cilin, varësisht nga numri dhe vëllimi i informacioneve të klasifikuara, personi përgjegjës i subjektit mund t'i kryej punët e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara.

Pastaj në nenin e njëjtë, ligjvënësi e ka rregulluar detyrimin e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara të hartojë dhe paraqes raporte tremujore për punën e vet dhe për gjendjen me informacionet e klasifikuara drejtpërdrejt deri te personi përgjegjës.

Së këtejmi, është përcaktuar se ky detyrim nuk ka të bëjë me oficerin e sigurisë së informacioneve të klasifikuara i cili njëkohësisht është edhe personi përgjegjës i subjektit.

Për koordinimin më të mirë të punës së subjektit në pjesën e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, ligjvënësi ka përcaktuar se nëse brenda subjektit janë caktuar më shumë oficerë të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, personi përgjegjës duhet ta caktojë njërin prej tyre për koordinim me Drejtorinë.

Neni 67

Oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara mund të caktohet nëse i përmbush kushtet si vijojnë:

- ▶ të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- ▶ të mos jetë shtetas i shtetit tjetër,
- ▶ të ketë leje për qasje në nivelin përkatës të informacioneve të klasifikuara sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj,
- ▶ ta ketë kaluar trajnimin për oficer të sigurisë së informacioneve të klasifikuara,
- ▶ të posedojë certifikatë përkatëse të sigurisë.

Në nenin 67 janë përcaktuar kushtet të cilat duhet t'i plotësoj një person që të caktohet për oficer të sigurisë së informacioneve të klasifikuara. Për më tepër, nevojitet personi të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mos jetë shtetas i shtetit tjetër, të ketë leje për qasje deri në nivelin përkatës të informacioneve të klasifikuara sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj, ta ketë kaluar trajnimin për oficerë të sigurisë të informacioneve të klasifikuara dhe të posedojë certifikatë përkatëse të sigurisë. Ligjvënësi këtu nuk e precizon shkallën e certifikatës së sigurisë që duhet ta posedojë oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara, megjithatë, supozohet se bëhet fjalë për shkallën e cila korrespondon me nivelin e informacioneve të klasifikuara të cilat trajtohen në kuadër të subjektit.

Trajnimin për oficer të sigurisë së informacioneve të klasifikuara ligjvënësi nuk e rregullon në detaje, përkatësisht nuk e cakton se kush e zbaton të njëjtin dhe cilën provë oficeri i sigurisë do të duhej ta prezantoj për ta konfirmuar trajnimin e kaluar. Mbetet obligim i ligjvënësit që në të ardhmen ta plotësojë këtë boshllëk juridik, përkatësisht ta rishikoj materien që ka të bëjë me këtë çështje.

Neni 68

Oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara e ka për detyrë:

- ▶ të kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në lidhje me sigurinë e informacioneve të klasifikuara të subjektit,
- ▶ në nivel tremujor t'i kontrolloj evidencat dhe rrjedhën e materialeve dhe dokumenteve,
- ▶ të kujdeset për zbatimin e drejtë dhe në kohë të duhur të arkivimit dhe shkatërrimit të informacioneve të klasifikuara,
- ▶ ta zbatojë procedurën e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë në kuadër të subjektit dhe ta mbajë evidencën e personave për të cilët është zbatuar procedurë,
- ▶ ta njoftojë Drejtorinë për skadimin e certifikatave të sigurisë, ndërprerjen e punës ose rishpërndarjen e përdoruesve të informacioneve të klasifikuara,
- ▶ ta njoftojë Drejtorinë për nevojën e ndryshimit të shkallës së certifikatës së sigurisë,

- ▶ ta njoftojë Drejtorinë në formë të shkruar për çdo ndryshim të të dhënave në pyetësonin e sigurisë ose ndryshime të kushteve për pranimin e certifikatës së sigurisë për të cilat e ka ditur ose është dashur ta dijë se janë shfaqur,
- ▶ t'i evidentoj rastet e qasjes së paautorizuar në informacionet e klasifikuara ose komprometimin e tyre edhe sa u përket veprimeve të ndërmarra dhe menjëherë ta njoftojë Drejtorinë për rastin dhe veprimin e këtillë,
- ▶ t'i informojë përdoruesit e informacioneve të klasifikuara më së paku një herë në vit për të drejtat dhe detyrimet gjatë trajtimit të informacioneve të klasifikuara,
- ▶ të siguroj ndihmë profesionale gjatë klasifikimit të informacionit brenda subjektit,
- ▶ të organizojë trajnim për përdoruesit e informacioneve të klasifikuara në subjektin për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Për punët nga paragrafi 1 të këtij neni, oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara harton plan vjetor të punës, të cilin ia paraqet personit përgjegjës për miratim. Në rastin kur personi përgjegjës i kryen punët e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, ai e harton planin vjetor të punës.

Në nenin 68 ligjvënësi i ka rregulluar detyrimet e oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara me ç'rast në mënyrë taksative i ka numëruar. Ka parashikuar se oficeri i sigurisë duhet të kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare në lidhje me sigurinë e informacioneve të klasifikuara brenda subjektit. Kjo nënkupton se oficeri i sigurisë së informacioneve të klasifikuara është në komunikim të drejtpërdrejtë me Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara sa u përket masave dhe aktiviteteteve të cilat subjekti i ndërmerr për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Përveç detyrimit të përgjithshëm të oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara për zbatimin e dispozitave të Ligjit, pastaj ligjvënësi parashikon detyrime dhe obligime të caktuara më konkrete. Për më tepër, ai përcakton se oficeri duhet në nivel tremujor t'i kontrollojë evidencat dhe rrjedhën e materialeve dhe dokumenteve, të kujdeset për zbatimin e drejt dhe në kohë të duhur të arkivimit dhe shkatërrimit të informacioneve të klasifikuara, ta zbatoj procedurën e paraqitjes së kërkesës për lëshimin e certifikatës së sigurisë në kuadër të subjektit dhe ta mbajë evidencën e personave për të cilët është zbatuar procedurë, ta njoftojë Drejtorinë për skadimin e certifikatave të sigurisë, për ndërprerjen e punës ose rishpërndarjen e përdoruesve të informacioneve të klasifikuara, ta njoftojë Drejtorinë për nevojën e ndryshimit të shkallës së certifikatës së sigurisë, ta njoftojë Drejtorinë në formë të shkruar për çdo ndryshim të të dhënave në pyetësonin e sigurisë ose për ndryshimin e kushteve të pranimit të certifikatës së sigurisë për të cilat e ka ditur ose është dashur ta dijë se janë shfaqur, t'i evidentojë rastet e qasjes së paautorizuar deri te informacionet e klasifikuara ose komprometimin e tyre dhe për veprimet e ndërmarra dhe menjëherë ta njoftojë Drejtorinë për rastin dhe veprimin e këtillë, t'i njoftojë përdoruesit e informacioneve të klasifikuara më së paku një herë në vit për të drejtat dhe detyrimet gjatë trajtimit të informacioneve të klasifikuara, të sigurojë ndihmë profesionale gjatë klasifikimit të informacionit brenda subjektit, të organizojë trajnim për përdoruesit e informacioneve të klasifikuara brenda subjektit për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Në paragrafin e dytë të nenit ligjvënësi ka parashikuar oficeri i sigurisë të infor-

macioneve të klasifikuara të hartojë plan vjetor të punës në të cilin do të përfshihen aktivitetet që duhet t'i përmbushë në përputhje me detyrimet të cilin e miraton personi përgjegjës. Ligjvënësi e ka rregulluar edhe rastin kur personi përgjegjës i kryen punët e oficerit të sigurisë të informacioneve të klasifikuara, me ç'rast ka përcaktuar se ai vet e harton planin vjetor të punës.

Mos përmbushja e detyrimeve nga ana e oficerit të sigurisë të stipuluara me këtë nen mund të jetë shkelje, ndërsa mos kryerja me dashje dhe me qëllim të detyrave të tij me qëllim që të shkaktohet ndonjë pasojë e dëmshme madje edhe mund të nënkuptohet si vepër penale, varësisht nga rrethanat e rastit nga pasojat e dëmshme etj.

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Neni 69

Drejtoria është autoritet i pavarur i administratës shtetërore me cilësi të personit juridik.

- ▶ Drejtoria:
- ▶ siguron zbatim të vazhdueshëm të standardeve dhe normave ndërkombëtare në ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara,
- ▶ e ushtron koordinimin e aktiviteteve në sigurimin e mbrojtjes të informacioneve të klasifikuara me autoritetet dhe institucionet shtetërore të cilat ushtrojnë shkëmbim të informacioneve të klasifikuara me shtete të huaja dhe organizata ndërkombëtare,
- ▶ i përgatit, organizon dhe zbaton dhe e ndjek zbatimin e masave dhe aktiviteteve për sigurimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të cilat Republikës së Maqedonisë së Veriut i janë kaluar për përdorim nga shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare,
- ▶ ndërmerr aktivitete për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ua ka kaluar shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare,
- ▶ merr pjesë në hartimin e planeve dhe programeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në organizata ndërkombëtare nga fusha e sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara,
- ▶ e planifikon dhe realizon bashkëpunimin ndërkombëtar për mbrojtjen dhe shkëmbimin e informacioneve të klasifikuara,
- ▶ propozon masa për avancimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara,
- ▶ ngre iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare nga fusha e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara,

- ▶ e bën akreditimin e sistemeve dhe proceseve të komunikimit-informacionit,
- ▶ organizon dhe realizon trajnime për sigurinë e informacioneve të klasifikuara,
- ▶ kryen mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe
- ▶ ushtron punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Për punën e vet Drejtoria miraton plan vjetor, ndërsa harton edhe raport të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në nenin 69 është rregulluar statusi i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara si autoritet i pavarur i administratës shtetërore me cilësi të personit juridik. Ajo si autoritet i pavarur u formua në vitin 2004 pas miratimit të Ligjit për informacione të klasifikuara dhe është vazhdimësi e ish-autoritetit kombëtar të sigurisë në kontekstin e NATO-s si shërbim profesional i Qeverisë.³³

Në vazhdim, në mënyrë taksative janë specifikuar kompetencat e Drejtorisë, me ç'rast ajo: siguron zbatim të vazhdueshëm të standardeve dhe normave ndërkombëtare gjatë ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara; e bën koordinimin e aktiviteteve në sigurimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me autoritetet dhe institucionet shtetërore të cilat bëjnë shkëmbim të informacioneve të klasifikuara me shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare; i përgatitë, organizon, zbaton dhe e ndjekë zbatimin e masave dhe aktiviteteve për sigurimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara të cilat ia kanë kaluar Republikës së Maqedonisë së Veriut për përdorim shtetëror të tjera dhe organizatat ndërkombëtare; ndërmerr aktivitete për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ua ka kaluar shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare; merr pjesë në hartimin e planeve dhe programeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në organizata ndërkombëtare nga fusha e sigurimit të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara; planifikon dhe realizon bashkëpunim ndërkombëtar për mbrojtjen dhe shkëmbimin e informacioneve të klasifikuara; propozon masa për avancimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara; ngre iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare me shtete të tjera dhe organizata ndërkombëtare nga fusha e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara; bën akreditimin e sistemeve dhe proceseve të komunikimit-informacionit; organizon dhe realizon trajnime për sigurinë e informacioneve të klasifikuara; bën mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe ushtron punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Ligjvënësi ka parashikuar që Drejtoria për punën e vet të miratojë plan vjetor dhe të hartojë raport të cilin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Rrjedhimisht me këtë, pas miratimit të planit vjetor i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Drejtorisë, ndërsa raporti i dërgohet Qeverisë për shqyrtim dhe miratim.

Neni 70

Gjatë shkëmbimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me NATO-n dhe Bashkimin Evropian, Drejtoria i kryen detyrat në lidhje me:

- ▶ koordinimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë të NATO-s dhe të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të sigurimit të

³³ Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, Historiku, i aksesshëm në: <https://www.dbki.gov.mk/?q=node/129>

- nivelit përkatës të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare,
- ▶ sigurinë e komunikimeve për zgjedhjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes kriptografike për transferimin, përpunimin dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara,
 - ▶ zbatimin e akreditimit të sigurisë të sistemeve dhe proceseve të komunikimit-informacionit në të cilat përdoren informacionet e klasifikuara,
 - ▶ ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e sistemeve të komunikimit-informacionit nga rrezatimi komprometues elektromagnetik.

Në nenin 70 në detaje janë rregulluar detyrat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në lidhje me shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara me NATO-n dhe Bashkimin Evropian në të cilat identifikohet roli i Drejtorisë sa i përket bashkëpunimit me këto organizata ndërkombëtare.

Për më tepër, si autoriteti më i lartë në shtet në pjesën e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara, përmes ushtrimit të koordinimit dhe zbatimit të politikave të sigurisë të NATO-s dhe Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të sigurimit të nivelit përkatës të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, Drejtoria identifikohet si Autoriteti Kombëtar i Sigurisë për zbatimin e politikës në pjesën e shkëmbimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me organizatat ndërkombëtare. Përmes kryerjes së detyrave të sigurisë së komunikimeve për zgjedhjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes kriptografike për transferimin, përpunimin dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara, Drejtoria identifikohet si autoriteti kombëtar i sigurimit të sistemeve të komunikimit-informacionit. Duke i kryer detyrat për zbatimin e akreditimit të sigurisë të sistemeve dhe proceseve të komunikimit-informacionit në të cilat përdoren informacione të klasifikuara, Drejtoria e ka rolin e Autoritetit Kombëtar për akreditimin e sistemeve të komunikimit-informacionit, ndërkaq përmes ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e sistemeve të komunikimit-informacionit nga rrezatimi komprometues elektromagnetik, Drejtoria identifikohet si Autoriteti Kombëtar për mbrojtje nga rrezatimi komprometues elektromagnetik.³⁴

Neni 71

Gjatë shkëmbimit dhe mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara me NATO Ministria e Mbrojtjes dhe Armata e Republikës së Maqedonisë së Veriut administron me materialet për mbrojtje kriptografike të informacioneve të klasifikuara dhe me trajtimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe evidentimin e sigurt të kriptomaterialeve.

Në pjesën e administrimit të materialeve për siguri kriptografike të informacioneve të klasifikuara dhe trajtimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe evidentimin e sigurt të kriptomaterialeve, Drejtoria e bën mbikëqyrjen mbi implementimin e masave të cilat i zbaton autoriteti kompetent.

Në nenin 71 është rregulluar kompetenca e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara me NATO për administrimin e materialeve për mbrojtje kriptografike të informacioneve të klasifikuara dhe trajtimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe evidentimin e

sigurt të kriptomaterialeve.

Në paragrafin e dytë të nenit ligjvënës e ka parashikuar kompetencën e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara të bëjë mbikëqyrje mbi implementimin e masave të cilat i zbaton autoriteti kompetent në pjesën e administrimit me materialet për siguri kriptografike të informacioneve të klasifikuara dhe trajnimin, ruajtjen, shpërndarjen dhe evidentimin e sigurt të kriptomaterialeve. Roli mbikëqyrës i Drejtorisë është në drejtim të kompetencës së saj për monitorimin e zbatimit të akteve ligjore në fuqi dhe për zbatimin e vazhdueshëm të standardeve dhe normave ndërkombëtare në ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, ndërsa subjektet kompetente e kanë kompetencën e kryerjes së punëve operative.

REGJISTRAT DHE PIKAT E KONTROLLIT

Neni 72

Për kryerjen e punëve në kompetencë të Drejtorisë me informacionet e klasifikuara të NATO-s, informacionet e klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe me informacione të tjera të klasifikuara të huaja vendoset regjistër, pararegjistra dhe pika të kontrollit.

Regjistri vendoset në Drejtori, ndërsa nënregjistrat dhe pikat e kontrollit vendosen në autoritetet e pushtetit shtetëror të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, në personat juridikë të themeluar nga Republika dhe në persona të tjerë juridikë, në të cilët trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara të NATO-s, informacione të klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe informacione të tjera të klasifikuara të huaja.

Nga nënregjistrat dhe pikat e kontrollit nga paragrafi 1 të këtij neni dërgohen informacione të nevojshme për kryerjen e punëve të Drejtorisë si dhe bëhet shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve të klasifikuara.

Me kërkesë të përdoruesve të informacioneve të klasifikuara Drejtoria jep pëlqim për përmbushjen e kushteve për vendosjen e nënregjistrave dhe pikave të kontrollit.

Shkëmbimi i informacioneve të klasifikuara midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare bëhet përmes Drejtorisë, nëse me ligj, me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare ose me ndonjë aranzhman tjetër ndryshe nuk është rregulluar.

Në nenin 72 është përcaktuar vendosja e sistemit të regjistrat për kryerjen e punëve në kompetencë të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara me Informacionet e Klasifikuara të NATO-s, me informacionet e klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe me informacione të tjera të klasifikuara të huaja. I njëjti përbëhet nga regjistri i cili është vendosur në Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe nga nënregjistrat dhe pikat e kontrollit të cilët janë vendosur në subjektet në të cilat trajtohen dhe ruhen informacionet e klasifikuara të NATO-s, informacione të klasifikuara të Bashkimit Evropian dhe informacione të tjera të klasifikuara të huaja.

Në paragrafin e tretë të këtij neni ligjvënësi ka parashikuar se nga nënregjistrat dhe pikat e kontrollit dërgohen informacione të nevojshme për kryerjen e punëve të Drejtorisë si dhe bëhet shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve të klasifikuara. Ligjvënësi e ka rregulluar edhe procedurën e vendosjes së nënregjistrave dhe pikave të kontrollit, me ç'rast ka parashikuar se të njëjtët vendosen sipas pëlqimit të dhënë nga Drejtoria për përmbushjen e kushteve të nevojshme për vendosjen e nënregjistrave dhe pikave të kontrollit sipas kërkesës së pranuar nga përdoruesit e informacioneve të klasifikuara. Nga na tjetër, në këtë nen nuk është parashikuar në detaje cilat janë kushtet që duhet të plotësohen për vendosjen e nënregjistrave dhe pikave të kontrollit. Në drejtim të rregullimit në detaje të kësaj çështje, ligjvënësi të njëjtat duhet t'i përcaktojë ose të ofrojë bazë ligjore që një gjë e këtillë të bëhet me akt nënligjor.

Në paragrafin e fundit të këtij neni është rregulluar se shkëmbimi i informacioneve të klasifikuara midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare bëhet përmes Drejtorisë, nëse me ligj, me marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare ose me aranzhman tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.

Rrjeti i nënregjistrave mundëson shpërndarje përkatëse të informacioneve të klasifikuara të huaja deri te përdoruesit dhe mbajtje të kontrollit për lëvizjen e tyre në subjektet në të cilat janë vendosur të njëjtat. Në përputhje me standardet e ratifikuara ndërkombëtare, regjistri, nënregjistrat dhe pikat e kontrollit janë objekt monitorimi nga ana e shërbimeve kompetente të NATO-s dhe BE-së (neni 37 paragrafi 1 të këtij ligji).

Neni 73

Drejtoria i njofton autoritetet kompetente të shteteve të tjera dhe organizatat ndërkombëtare për sigurinë e shkëmbimit të informacioneve të klasifikuara dhe nga të njëjtit pranon njoftime në lidhje me sigurinë e informacioneve të klasifikuara të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut ua ka kaluar, në përputhje me marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Në nenin 73 ligjvënësi e ka rregulluar bashkëpunimin midis Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare, e cila mbështetet në marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare për njoftim të ndërsjellë në lidhje me sigurinë e informacioneve të klasifikuara të shkëmbyera.

Neni 74

Me kërkesë të Drejtorisë autoritetet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë Veriut dhe me ligj, personat juridik të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë i japin informacione të nevojshme për kryerjen e punëve në kompetencë të saj.

Në nenin 74 ligjvënësi e ka rregulluar detyrimin e autoriteteve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personave juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit dhe personave të tjerë juridikë dhe fizikë me kërkesë Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara t'i japin informacione të nevojshme për kryerjen e punëve në kompetencë të saj. Ky bashkëpunim

i Drejtorisë me subjektet veçanërisht vjen në shprehje në kuadër të kontrollit të sigurisë së personave fizikë dhe juridikë të cilët kërkojnë t'iu lëshohet certifikata e sigurisë.

Neni 75

Me Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Drejtori emërohet me mandat katërvjeçar.

Drejtori ka zëvendës, të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për një periudhë kohore katërvjeçare. Zëvendës-drejtori e zëvendëson drejtorin në rastin kur ai mungon ose për shkak të sëmundjes dhe shkaqeve të tjera nuk ka mundësi ta ushtrojë funksionin e tij me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij gjatë udhëheqjes.

Për emërimin e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit publikohet shpallje publike në tre gazeta ditore të cilat botohen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej të cilave njëra gazetë botohet në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Për drejtor dhe zëvendës-drejtor të Drejtorisë mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet si vijon:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër;
- 3) me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 4) të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose shkallë VII/1 të arsimit;
- 5) të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune;
- 6) të posedojë një nga certifikatat ose vërtetimet e njohura ndërkombëtarisht për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet, si vijon:
 - ▶ TOEFEL IBT më së paku 74 pikë,
 - ▶ IELTS – më së paku 6 pikë,
 - ▶ ILEC (Cambridge English: Legal) – më së paku niveli B2,
 - ▶ FCE (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - ▶ BULATS – më së paku 60 pikë ose
 - ▶ APTIS – më së paku niveli B2 dhe
- 7) të posedojë certifikatë sigurie të nivelit “SEKRET SHTETËROR”.

Drejtorit dhe zëvendës-drejtorit të Drejtorisë funksioni i pushon para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar:

- ▶ nëse jep dorëheqje,

- ▶ me kërkesë personale,
- ▶ për shkak të përmbushjes së kushteve për pension pleqërie të përcaktuara me ligj, me të drejtë vazhdimi në përputhje me aktet normative për marrëdhënie pune,
- ▶ për shkak të vdekjes,
- ▶ nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me burgim mbi gjashtë vjet.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Drejtorisë nëse është përmbushur njëri nga kushtet si vijon:

- ▶ nëse konstatohet se nuk e përmbush njërin nga kushtet të përcaktuara në nenin 74 paragrafin 5 të këtij ligji,
- ▶ nëse refuzon të parashtojë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në përputhje me ligjin dhe nëse të dhënat që i përmban deklarata janë të pavërteta dhe
- ▶ në mënyrë evidente i shkel rregullat e konfliktit të interesave, përkatësisht përjashtim në situata në të cilat drejtori e ka ditur ose është dashur ta dijë për ekzistimin për njërin nga bazat e konfliktit të interesave, përkatësisht përjashtimin e parashikuar me ligj.

Në nenin 75 ligjvënësi ka përcaktuar se me Drejtorinë udhëheq drejtori. Atë e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar. Për herë të parë me këtë ligj ligjvënësi e ka parashikuar zëvendësdrejtorin i cili e ka për detyrë ta zëvendësoj drejtorin në rastin kur ai mungon ose kur për shkak të sëmundjes dhe shkaqeve të tjera nuk ka mundësi ta ushtroj funksionin e tij me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij gjatë udhëheqjes. Edhe zëvendësdrejtorin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat katërvjeçar.

Me këtë nen është përcaktuar edhe procedura e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit e cila fillon me publikimin e shpalljes publike në tri gazeta ditore të cilat botohen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej të cilave njëra gazetë botohet në gjuhën të cilën e flasin më së paku 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

Janë përcaktuar edhe kushtet të cilat të dy funksionarët duhet t'i plotësojnë që të zgjidhen në pozitat drejtor dhe zëvendësdrejtor, edhe atë personi: të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut; të mos posedojë shtetësi të shtetit tjetër; me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës; të ketë fituar 240 kredi sipas SETK ose nivelin VII/1 të arsimit; të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune; të posedojë një nga certifikatat ose vërtetimet e njohur ndërkombtarisht për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më e vjetër se pesë vjet, si vijon: *TOEFEL IBT më së paku 74 pikë, IELTS – më së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – më së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – më së paku 60 pikë ose APTIS – më së paku niveli B2 dhe të posedojë certifikatë sigurie të nivelit "SEKRET SHTETËROR".*

Në këtë nen ligjvënësi i ka parashikuar edhe kushtet kur drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Drejtorisë i pushon funksioni para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, përkatësisht: nëse paraqet dorëheqje sipas kërkesës personale, për shkak të plotësimit të kushteve për pension pleqërie të përcaktuara me ligj, me të drejtë

vazhdimi në përputhje me aktet normative për marrëdhënie pune, për shkak të vdekjes dhe nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me burgim mbi gjashtë muaj. Janë rregulluar edhe kushtet, sipas të cilave nëse është plotësuar njëri prej tyre, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e shkarkon drejtorin dhe zëvendës-drejtorin e Drejtorisë. Për më tepër, drejtori dhe zëvendës-drejtori i Drejtorisë mund të shkarkohen nëse konstatohet se nuk e përmbushin njërin nga kushtet të përcaktuara në nenin 75 paragrafin 4 të këtij ligji (*këtu në Ligjin është bërë gabim teknik - paragrafi 5*), nëse refuzon të parashtrojë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në përputhje me ligjin ose nëse të dhënat që i përmban deklarata janë të pavërteta dhe nëse në mënyrë evidente i ka shkelur rregullat e konfliktit të interesave, përkatësisht përjashtimin në situata në të cilat drejtori e ka ditur ose është dashur ta dijë për ekzistimin të ndonjëres nga bazat e konfliktit të interesave, përkatësisht përjashtimin e parashikuar me ligj. Dy bazat e fundit në të vërtetë janë indicie për veprim korruptiv të cilat vetvetiu bëjnë që funksionari të mos jetë dinjitoz për ushtrimin e këtij funksioni shumë të rëndësishëm.

Neni 76

Të punësuarit në Drejtori janë nëpunës administrativ shtetërorë. Sa u përket të drejtave dhe përgjegjësi të tyre nga marrëdhënia e punës zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativ.

Të punësuarit në Drejtori referohen me punë në misionet e përhershme të Republikës së Maqedonisë së Veriut pranë NATO dhe BE, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar për bashkëpunim të ndërsjellë me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Gjatë kohës së referimit, të punësuarit fitojnë titull në përputhje me dispozitat e Ligjit për punë të jashtme.

Të punësuarit në Drejtori duhet të posedojnë certifikatë përkatëse të siguri të siguri në informacionet e klasifikuara. Niveli i certifikatës së siguri të siguri përcaktohet me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori.

I punësuari në Drejtori të cilit gjatë kohës së marrëdhënies së punës nuk do t'i vazhdohet vlefshmëria e certifikatës së siguri të siguri ose gjatë kontrollit do të konstatohet se nuk mund t'i lëshohet certifikata e siguri të siguri për shkak të ekzistimit të rrezikut të siguri të siguri për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara, për gjithmonë transferohet në ndonjë organ ose institucion tjetër shtetëror, në vend pune në nivel të njëjtë për të cilin i përmbush kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara me aktin e sistematizimit të institucionit tjetër.

Transferimi bëhet në bazë të marrëveshjes të cilën e nënshkruajnë personat udhëheqës të të dy institucioneve.

Punonjësit i cili transferohet i pushon marrëdhënia e punës nëse nuk e nënshkruan marrëveshjen e re për punë në afat prej 15 ditësh nga data e dërgesës.

Të punësuarit në Drejtori kanë legjitimacion zyrtar të cilin e lëshon drejtori i Drejtorisë.

Formularin e legjitimacionit zyrtar dhe mënyrën e lëshimit të tij i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Dispozitat e nenit 76 kanë të bëjnë me të punësuarit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara. Ligjvënësi ka përcaktuar se të punësuarit e Drejtorisë kanë status të nëpunësve administrativ shtetëror, dhe konform statusit të këtillë, ka përcaktuar se për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre nga marrëdhënia e punës zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativ.³⁵ Me statusin e këtillë, të punësuarit e Drejtorisë janë të vetmit në kuadër të autoriteteve shtetërore që kanë kompetenca në sektorin e sigurimit të cilët nuk kanë status të personave me detyra dhe autorizime të veçanta.³⁶ Statusi i këtillë i të punësuarve në Drejtori, për fat të keq, është shkak për largimin e madh të personelit në institucione të tjera dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt mbi kapacitetet kadrovike të saj për zbatimin e kompetencave ligjore.

Në paragrafin e dytë të këtij neni ligjvënësi ka parashikuar se të punësuarit e Drejtorisë referohen me punë në misionet e përhershme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO dhe BE, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar për bashkëpunim të ndërsjellë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me ç'rast, gjatë kohës së referimit, e fitojnë titullin në përputhje me dispozitat e Ligjit për punë të jashtme.

Me këtë nen rregullohet edhe kushti të punësuarit e Drejtorisë të posedojnë certifikatë përkatëse të sigurisë për qasje në informacionet e klasifikuara, e cila përcaktohet me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtori. Kjo çështje është rregulluar në këtë mënyrë me që të gjithë të punësuarit e Drejtorisë nuk kanë nevojë për qasje në informacionet e klasifikuara me nivel të njëjtë të klasifikimit, ashti siç nuk kanë nevojë të njëjtë për qasje në informacionet e klasifikuara të NATO-s ose BE-së.

Ligjvënësi në paragrafin e pestë të këtij neni e ka parashikuar edhe procedurën në rast se të punësuarit e Drejtorisë gjatë kohës së marrëdhënies së punës nuk do t'i vazhdohet vlefshmëria e certifikatës së sigurisë ose gjatë kontrollit do të konstatohet se nuk mund t'i lëshohet certifikatë sigurie për shkak të ekzistimit të rrezikut të sigurisë për qasje dhe trajtim të informacioneve të klasifikuara. Në këtë rast, ligjvënësi ka parashikuar se i punësuari transferohet përgjithmonë në ndonjë organ ose institucion tjetër shtetëror, në vend pune në nivel të njëjtë për të cilin i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në aktin e sistematizimit të institucionit tjetër. Transferimi i të punësuarit në institucion tjetër është rregulluar që të bëhet në bazë të marrëveshjes të cilën e nënshkruajnë personat udhëheqës të të dy institucioneve. Nëse i punësuari i cili transferohet nuk e nënshkruan marrëveshjen e re të punës në afat prej 15 ditësh nga data e dërgesës atëherë i pushon marrëdhënia e punës. Kjo zgjidhje është harmonizuar me dispozitat e vlefshme ligjore për mobilitetin e nëpunësve administrativ.³⁷

Për të punësuarit e Drejtorisë ligjvënësi ka parashikuar të kenë legjitimacion zyrtar të cilin e lëshon drejtori i Drejtorisë ndërsa formularin dhe mënyrën e lëshimit të tij i

³⁵ Ligji për nëpunësit administrativ, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër " 275/19 dhe 14/20.

³⁶ Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 108/19) neni 65; Ligji për Agjencinë Teknike-Operative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 98/19) neni 11, paragrafi (1) dhe neni 20 paragrafi (1); Ligji për Agjencinë e Zbulimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 21/2021), neni 25.

³⁷ Ligji për nëpunësit administrativ ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/19 dhe 14/20), neni 30; dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 27/16, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 14/20), nenet 42,43 dhe 44.

përcakton me akt nënligjor. Rregullorja e formularit të legjitimacionit zyrtar të personave të punësuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe e mënyrës së lëshimit të tij është miratuar dhe publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 53/2021.

KREU I PESTË

PLANE DHE PROGRAME PËR PUNËN E DREJTORISË DHE FINANCIMI I DREJTORISË

Neni 77

Puna e Drejtorisë udhëhiqet dhe realizohet sipas parimeve, normave dhe procedurave të cilat vlejnë në sistemin e planifikimit, programimit dhe punës buxhetore.

Për realizimin më efikas të punës së Drejtorisë, me dispozitat e këtij neni ligjvënësi përcakton se ajo duhet të udhëhiqet dhe realizohet sipas parimeve, normave dhe procedurave të cilat vlejnë në sistemin e planifikimit, programimit dhe punës buxhetore. Siç mund të shihet, në komentin e nenit të radhës, kjo përpilohet në përputhje me udhëzimet dhe objektivat për përgatitjen e kërkesave buxhetore nga cirkulari buxhetor të cilin e harton Ministria e Financave.

Neni 78

Mjetet financiare për nevojat e Drejtorisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet financiare për nevojat e Drejtorisë mund të sigurohen edhe nga burime të tjera në përputhje me ligjin.

Mjetet financiare të autoriteteve shtetërore për nevojat e mbrojtjes, përdorimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve të klasifikuara sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të mjeteve financiare të atyre autoriteteve.

Autoritetet e pushtetit lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit për nevojat e mbrojtjes, përdorimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve të klasifikuara sigurojnë mjete financiare nga burimet vetjake dhe nga mjetet financiare dhe materiale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 78 i Ligjit juridikisht e rregullon çështjen e financimit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe financimin e mbrojtjes, përdorimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve të klasifikuara i cili ndërmerret nga autoritetet e tjera shtetërore, nga autoritetet e pushtetit lokal, nga persona juridikë etj.

Sipas paragrafit 1 të këtij neni Drejtoria financohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ajo është autoritet i pavarur i pushtetit shtetëror dhe së këtejmi, financimi dhe puna e saj nuk koordinohen, për shembull, përmes ndonjë ministrie, por drejtpërdrejt nga Buxheti shtetërorë.³⁸

Lartësia e mjeteve të cilat akordohen për Drejtorinë është çështje për të cilën mund të diskutohet gjerë e gjatë edhe pse buron nga kornizat e ngushta pragmatike të një komenti të ligjit. Kjo varet nga shumë elementë të rëndësishëm. Si e para, natyra dhe amplituda e ndryshueshme e sfidave me të cilat ballafaqohet Drejtoria gjatë punës së saj rrjedhëse, si dhe aspekti sensitiv i veprimit në një fare mënyre e diktojnë vëllimin e mjeteve të nevojshme për funksionimin efikas të këtij autoriteti. Së dyti, thuaja se të gjitha vendet evropiane, madje edhe ato me zhvillim më të lartë, ballafaqohen me sfidën e shpenzimeve të larta për institucionet e sigurisë. Në përputhje me botëkuptimin kontemporan të komponentit mbrojtës të subjekteve të ngarkuara për këtë, siç është edhe rasti me Drejtorinë, është më se e nevojshme të ndërtohet një sistem i cili do të sigurojë që informacioni i nevojshëm të arrijë deri te përdoruesi i fundit dhe së këtejmi i njëjti të jetë i mbrojtur. Qëndrimi i përcaktuar në mënyrë të qartë të nevojës së ekzistimit, ndërtimit dhe zhvillimit të sistemit përkatës për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, vetvetiu e imponon çështjen e shpenzimeve, përkatësisht sa mjete financiare janë të nevojshme për sigurimin e këtij segmenti.

Së këtejmi, njëri nga argumentet shpesh të apostrofuar në lidhje me sigurimin e funksionalitetit të nevojshëm të sistemit të shpenzimeve, përkatësisht kostoja, e kuptuar në mënyrë konsekuente si vëllim i mjeteve financiare të cilat duhet të sigurohen për realizimin e objektivit të dëshiruar, duke i përfshirë këtu edhe mjetet që duhet të sigurohen për organizimin dhe punën më të mirë.

Drejtorja, konform Ligjit, mund të financohet edhe nga burime të tjera të financimit, me ç'rast këto nuk janë cekur në mënyrë konkrete në nenin, megjithatë një mundësi të këtillë ligji e parashikon në mënyrë eksplicite.

Sa u përket mjeteve financiare të autoriteteve shtetërore për nevojat e mbrojtjes, përdorimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve të klasifikuara, dispozita nga paragrafi 3 të këtij neni përcakton se sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, por në kuadër të mjeteve financiare të atyre autoriteteve, që do të thotë nga Buxheti Shtetëror për atë dedikim atyre u akordohen mjete, dhe jo se një gjë e këtillë bëhet përmes Drejtorisë dhe nga mjetet e dedikuara për atë.

Autoritetet e pushtetit lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit për nevojat e mbrojtjes, përdorimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të informacioneve të klasifikuara sigurojnë mjete financiare nga burimet vetjake dhe nga mjetet financiare dhe materiale të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.

KREU I GJASHTË

MBIKËQYRJA

Neni 79

Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi aktet normative të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Drejtoria përmes inspektorëve për sigurinë e informacioneve të klasifikuara (në tekstin në vijim: inspektorët).

Punët e mbikëqyrjes inspektuese në kuadër të Drejtorisë kryhen në njësinë e veçantë organizative.

Sipas këtij neni të Ligjit, është parashikuar të kryhet mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e legjislacionit të përgjithshëm për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Kjo nënkupton se inspektorët gjatë kryerjes së mbikëqyrjes i kontrollojnë subjektet nga aspekti i zbatimit të dispozitave të Ligjit, por edhe dispozitat e akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit, përkatësisht urdhëresat dhe rregulloret.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese roli primar u është besuar inspektorëve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara pranë Drejtorisë. Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes detyra e tyre konsiston me përcaktimin e zbatimit të Ligjit dhe akteve normative që janë miratuar në bazë të këtij ligji, përkatësisht me detektimin e gjendjeve dhe vlerësimin e punës së përgjithshme të subjekteve relevante. Mbikëqyrja inspektuese në shkencën juridike emërtohet edhe si mbikëqyrje represive meqë këtu vinë në shprehje autorizime të caktuara të natyrës së detyrueshme të cilat implementohen në mënyrë që të sigurohet respektim konsekuent i ligjshmërisë gjatë punës dhe rendit juridik në përgjithësi.³⁹

Bëhet fjalë për një aktivitetet sistematik që ka të bëjë me detektimin e respektimit të standardeve dhe normave ligjore për sigurimin e përdorimit ligjor të informacioneve të klasifikuara, trajtimi i informacioneve të klasifikuara gjatë kohëzgjatjes së ekzistimit të tyre, kushtet në të cilat trajtohen dhe në të cilat ruhen informacionet e klasifikuara si dhe siguria e hapësirës mbrojtëse, dhe marrëveshjes së klasifikuar etj. Inspektorët e sigurisë së informacioneve të klasifikuara duhet të ndërmarrin aktivitete me të cilat do të bëjnë këqyrje mbi gjendjen reale dhe vlerësimin e punës së përgjithshme. Kjo lidhje kthyes e nënkupton edhe krahasimin e rezultateve të vërteta me standardet paraprakisht të përcaktuara të punës. Së këtejmi, mbikëqyrja është në funksion të perceptimit të vlerësuar dhe objektiv të gjendjeve në lidhje me atë se a ekzistojnë lëshime gjatë zbatimit dhe implementimit të normave ligjore të cilat bazohen mbi standarde të caktuara me të cilat realizohet kryerja e mirëfilltë.

Me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni parashikohet që punët e mbikëqyrjes inspektuese të kryhen në njësi të veçantë organizatave në kuadër të Drejtorisë. Në

të vërtetë, aty është vendi dhe elementi real i analizës paraprakisht të sintetizuar e cila flet se natyrshëm është parapërcaktuar njësia organizative të zbatojë mbikëqyrje inspektuese në këtë fushë, meqë ky është subjekti i ngarkuar dhe mirëfilli e njeh anën e implementimit të ligjit dhe vet esencën e mbikëqyrjes. Nga aspekti i lidhjes sistematike të njerëzve të cilët punojnë me objektivat në ndonjë subjekt juridik, çdo njësi organizative përbëhet nga njerëz të grupuar sipas kriterëve të caktuar. Në kuadër të Drejtorisë këto çështje janë specifikuar në nenin 81. Njësia organizative për mbikëqyrje inspektuese përbëhet nga profesionistë të cilët në përgjithësi e njohin materien e mbikëqyrjes inspektuese, por edhe fushën sensitive të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara.

Neni 80

Në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e këtij ligji, ndërsa për çështjet të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese më për së afërmi rregullohet me Rregulloren të cilën e miraton drejtori i Drejtorisë.

Mbikëqyrja inspektuese, siç e theksuam paraprakisht ka rëndësi të madhe në procesin e mbrojtjes së informacioneve për më së paku dy shkaqe, si vijon: njëri ka të bëjë me perceptimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) dhe akteve përkatëse normative të cilët janë miratuar dhe të cilët burojnë nga Ligji *in concreto* dhe shkak i dytë, të zbulohen dobësitë dhe lëshimet gjatë punës në mënyrë që të ndërmerren aktivitete të caktuara në drejtim të përmirësimit të tij.

Në nenin 80 paragrafi 1 janë përcaktuar bazat ligjore për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në këtë fushë, përkatësisht në mënyrë të qartë është specifikuar se në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese fillimisht zbatohen dispozitat e këtij ligji, e që është një dispozitë jashtëzakonisht e rëndësishme, meqë zgjidhja e kësaj nuk ishte përfshirë në ligjin paraprak për informacione të klasifikuara ndërsa kryekëput zbatoheshin dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese. Kjo nënkupton se për çështjet e rregulluara me këtë ligj, ai është *lex specialis* dhe i njëjti zbatohet në mënyrë preliminare, ndërsa Ligji për mbikëqyrje inspektuese (si edhe Ligji për procedurë të përgjithshme administrative) është *lex generalis* dhe dispozitat e tij zbatohen për çështjet të cilat nuk janë rregulluar me Ligjin për informacione të klasifikuara(*) si *lex specialis*.

Është evidente se gjendja është mjaftë e ndryshme dhe e arsyeshme për shkak të aspektit specifik të kësaj fushe, kështu që dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, në përputhje me nenin 2, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit⁴⁰ që kanë të bëjnë me procedurën, detyrimet dhe kushtet e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, zbatohen mbi shërbimet inspektuese të organizuara si organe në kuadër të ministrive ose si njësi organizative, në kuadër të autoriteteve të pushtetit shtetëror, komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe në kuadër të Qytetit të Shkupit, por jo edhe për Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara, dhe gjithashtu nuk zbatohen në Ministrinë e Financave, duke e përfshirë këtu Drejtorinë e të Ardhurave Publike dhe Drejtorinë e Doganave, në

⁴⁰ Ligji për mbikëqyrje inspektuese, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 102/19, neni 2.

Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.⁴¹ Kjo do të thotë se Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara ka të drejtë autentike të zbatoj mbikëqyrje inspektuese përmes inspektorëve të vet. Me këtë arrihet qëllimi i dyfishtë edhe atë, nga njëra anë, sigurohet pavarësia e nevojshme për shkak të natyrës së materies, ndërsa nga ana tjetër, gjithsesi se, sigurohet ligjshmëria e procedimit në drejtim të orientimit të punës në përputhje me dispozitat ligjore.

Ligjvënësi ka parashikuar se mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese më për së afërmi do të rregullohet me rregullore, megjithatë ka lënë hapësirë për çështjet që nuk janë rregulluar me këtë ligj të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Zbatimi i dispozitave nga ligjet e cekur është vetëm një plotësim gjatë zbatimit të mbikëqyrjes së nevojshme për shkak të aspektit komplementar të materies. Për më tepër, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative i rregullon çështjet me të cilat rregullohet procedura e realizimit të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të personave fizikë, të personave juridikë dhe të palëve të tjera, si dhe mbrojtja e interesit publik sipas të cilës e kanë për detyrë të veprojnë ministritë, autoritetet e pushtetit shtetërorë, organizatat e përcaktuara me ligj, autoritetet e tjera shtetërore, personat juridikë dhe fizikë të cilëve me ligj u është besuar të ushtrojnë autorizime publike, si dhe organet e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit, kur gjatë kryerjes së kompetencave të veta ligjore, veprojnë, zgjidhin dhe ndërmarrin veprimet e tjera administrative në punë administrative⁴² dhe akoma më e rëndësishme ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet administrative të autoriteteve publike dhe të ofertuesve të shërbimeve.⁴³

Rregullorja e lartpërmendur ka për qëllim plotësisht ta përpunojë mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese në këtë fushë dhe gjithsesi duhet të korrespondoj me Ligjin për informacione të klasifikuara(*) dhe me aktet e tjera juridike *inter alia* të cilët janë në korrelacion me Ligjin për informacione të klasifikuara(*). Me fjalë të tjera, dispozitat e kësaj rregullore e pasqyrojnë përcaktimin e paluhatshëm dhe të qartë të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) dhe dispozitat e përcaktuara që në praktikë duhet të mundësojnë praktikim të lehtë të mbikëqyrjes, përkatësisht të mos ketë interpretime të ndryshme për çështje të njëjta ose të ngjashme gjatë procedimit ose që është jashtëzakonisht e rëndësishme të mos krijohet hapësirë për interpretime subjektive. Kjo nënkupton se dispozitat duhet të jenë të qarta, precize dhe të zbatueshme. Normat të cilat në të drejtën mund të interpretohen në mënyra të ndryshme konsiderohet se nuk e përmbushin kërkesën për dispozita të qarta dhe precize: *lex certa et stricta* që është konsekuencë e parimit të ligjshmërisë.

Rregullorja për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese u miratua në bazë të nenit 80, paragrafit 2 të këtij ligji dhe është publikuar në "Gazetën Zyrtare" numër 246/20.

Neni 81

Inspektori, i cili e kryen mbikëqyrjen inspektuese përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunësit administrativë duhet t'i përmbushë kushtet e posaçme si vijon:

- të ketë fituar 240 kredi sipas SETK, ose nivelin e kryer VII/1,

⁴¹ Po aty, neni 2, paragrafi 4.

⁴² Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, "Gazeta Zyrtare" numër 124/15, neni 1.

⁴³ Po aty, neni 2.

- të ketë tre vjet përvojë pune në fushën e sigurisë së informacioneve të klasifikuara, – ta ketë dhënë provimin profesional për inspektor të informacioneve të klasifikuara,

Mënyrën e nënshtrimit në provimin profesional për inspektorët e informacioneve të klasifikuara me Rregullore e përcakton drejtori i Drejtorisë.

Shtojca në pagë për inspektorët rregullohet me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese.

Personi i cili do të kryej mbikëqyrje inspektuese, përkatësisht personi inspektor, duhet të përmbush kushte të caktuara të cilat në mënyrë të qartë dhe eksplicite përcaktohen me Ligj. Me fjalë të tjera, inspektori i cili kryen mbikëqyrje inspektuese nga fusha e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara fillimisht duhet t'i përmbush kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për nëpunësit administrativë dhe kushtet e veçanta të përcaktuara në Ligjin për informacione të klasifikuara(*).

Të gjitha kushtet janë parakusht për një person kompetitiv i cili pritët se me veprimin e tij efektiv dhe sjelljen individuale do të bëjë që detyrat të jenë të dukshme dhe të kontribuojë në konkretizimin dhe realizimin e tyre.

Nuk ka dyshime se për inspektorin i cili e bën mbikëqyrjen inspektuese në fushën e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara, nga aspekti i kualifikimeve, kompetencave, aftësive etj., përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunësit administrativë, ligjvënësi konsideron se duhet të përmbushë edhe kushte të posaçme për shkak të aspektit specifik të problematikës. Sa u përket kushteve të përgjithshme, në përputhje me Ligjin për nëpunësit administrativë ku është përcaktuar klasifikimi i vendeve të punës të nëpunësve administrativë, kompetencat e përgjithshme përcaktohen në Kornizën e kompetencave të përgjithshme për nëpunësit administrativë,⁴⁴ ndërsa ligjvënësi ka parashikuar që kushtet e veçanta siç janë kualifikimet profesionale, përvoja e punës në profesion, si dhe provimi i dhënë profesional për inspektor të informacioneve të klasifikuara të përcaktohen si kushte të veçanta të vendit të punës. Kategoria e vendeve të punës të nëpunësve administrativë sipas përgjegjësisë, qëllimeve, llojit dhe kompleksitetit të punëve dhe të detyrave të punës të vendit të punës korrespondon me nenin 22 të Ligjit për nëpunësit administrativë. Vendet e punës të nëpunësve administrativë klasifikohen në katër kategori, si vijon: kategoria A – sekretarë, kategoria – nëpunës udhëheqës administrativë, kategoria V – nëpunës profesional administrativë dhe kategoria G – nëpunës administrativë ndihmës-profesional.⁴⁵ Plotësimi i vendeve të punës të nëpunësve administrativë dhe punësimi i nëpunësve administrativë janë përcaktuar në Kreun VI dhe VII të Ligjit për nëpunësit administrativë.⁴⁶

Duhet të theksohet se arsimit është elementi kryesor për fitimin e kompetencave dhe aftësive të nevojshme dhe se lënia e hapësirës në Ligjin për informacione të klasifikuara(*) siç është përcaktuar në paragrafin 1 alineja 1, potencialisht çdo profil i arsimit të jetë konkurrent, e relativizon angazhimin e përgjithshëm për plotësimin e njësisë organizative për mbikëqyrje inspektuese me kuadro profesionale dhe, para së gjithash, kompetente të cilët i posedojnë njohurinë dhe aftësitë e nevojshme të fituara në procesin e arsimit.

Përveç arsimit përkatës, një parakusht i rëndësishëm për kryerjen me sukses të kësaj

⁴⁴ Ligji për nëpunësit administrativ, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/1019, dhe 14/20, neni 21, paragrafi 2.

⁴⁵ Po aty, neni 22.

⁴⁶ Po aty, neni 30–47.

pune është edhe përvoja e punës dhe përvoja profesionale. Përvoja e punës prej tre vjet që është theksuar në alinenë 2 lë hapësirë për diskutim serioz. Ekzistojnë mendime se inspektorët duhet të kenë përvojë pune dhe përvojë profesionale shumë më të madhe që të futen në thelbin e problemeve në mënyrë që ta kuptojnë amplitudën e ndryshueshme të punëve në këtë fushë, me ç'rast do ta përmbushnin qëllimin kryesor që të jenë katalizatorë të gjendjeve të përgjithshme gjatë zbulimit të parregullsive në punën e personave juridikë dhe fizikë të cilët kanë kontakt me informacione të klasifikuara dhe ndërmarrje të veprimeve për shmangien dhe/ose sanksionimin e tyre.

Paragrafi 2 i këtij neni e rregullon detyrimin e Drejtorisë të miratojë Rregullore për mënyrën e nënshtrimit në provimin profesional për inspektorët e informacioneve të klasifikuara (kushti i veçantë i tretë) e cila për së afërmi i përcakton kushtet dhe mënyrën e nënshtrimit në provim me çka do të kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve të cilët janë paraqitur për inspektorë, si dhe kontrollimi i kompetitivitetit dhe aftësive të kandidatëve.

Rregullorja për mënyrën e nënshtrimit në provimin profesional të inspektorëve për sigurinë e informacioneve të klasifikuara është miratuar dhe publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 219/20 dhe me të njëjtën parashikohet se provimi përbëhet nga pjesa e përgjithshme (pyetje nga fusha e procedurës së përgjithshme administrative, nga fusha e procedurës inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse) dhe nga pjesa e veçantë (pyetje nga fusha e akteve normative për sigurinë e informacioneve të klasifikuara).⁴⁷ Kandidati i cili do të përgjigjet saktë në më së paku 70% të pyetjeve për çdo pjesë veç e veç, konsiderohet se e ka dhënë provimin dhe për këtë i lëshohet vërtetim përkatës.

Paragrafi 3 i cili ka të bëjë me shtojcën në pagë të inspektorëve, përcakton se një gjë e këtillë është rregulluar me Ligjin për mbikëqyrje inspektuese.

Neni 82

Inspektori kryen mbikëqyrje inspektuese në autoritetet e pushtetit shtetëror dhe pushtetit lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, në personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe në persona të tjerë juridikë dhe fizikë.

Gjatë kryerjes së punës inspektori është i pavarur në punën e tij. Sipas nevojës, me propozim të udhëheqësit të njësies organizative për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, drejtori mund të përcaktojë ekip për mbikëqyrje inspektuese i përbërë nga nëpunësit administrativë të Drejtorisë.

Inspektorët e kanë për detyrë të veprojnë në përputhje me ligjin dhe aktet normative. Inspektorët duhet të sigurojnë zbatim objektiv të ligjit.

Në këtë nen precizohet, siç është theksuar, çka do të jetë objekt i mbikëqyrjes inspektuese, përkatësisht se mbikëqyrja inspektuese do të zbatohet në autoritetet e shtetit dhe të pushtetit lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, në personat juridikë të themeluar nga Republika ose

⁴⁷ Për më shumë, shih: neni 4 nga Rregullorja për mënyrën e nënshtrimit në provimin profesional të inspektorëve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 219/20.

nga komunitat, Qyteti i Shkupit dhe nga komunitat në Qytetin e Shkupit si dhe në persona të tjerë juridikë dhe fizikë. Nënkuptohej se nuk bëhet fjalë për të gjitha subjektet e këtilla, por për ato subjekte puna e të cilave ka pika të përbashkëta me fushën e informacioneve të klasifikuara.

Është më se e evidente se mbikëqyrja inspektuese është e nevojshme, megjithatë për efektimin e plotë të saj nevojitet shumë njohuri dhe përvojë të inspektorëve, ndërsa efektiviteti i mbikëqyrjes varet nga qasja anticipative e të gjitha subjekteve të përfshira në këtë proces, siç janë autoritetet e shtetit dhe të pushtetit lokal, personat juridikë të themeluar nga Republika ose komunitat, Qyteti i Shkupit dhe komunitat në Qytetin e Shkupit, si dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë.

Paragrafi 2 i nenit 82 ka të bëjë me pavarësinë e inspektorit gjatë kryerjes së punës. Pavarësia është një komponentë i rëndësishëm dhe kyç që të sigurohet se gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori në mënyrë të drejtë do ta kryej detyrën e tij. Kjo nënkupton se askush nuk duhet të ndikojë mbi punën e tij, ndërsa pavarësia do t'i mundësojë zgjidhje më të shpejtë, më të plotë dhe më objektive të problemit, ndërkajsh e njëjta krijon kushte objektive për paanshmëri dhe nënkupton mungesë të presioneve për të vepruar sipas kërkesës ose dëshirës së dikujt. E gjithë kjo është një bazë solide që inspektori të mund ta objektivizojë perceptimin e tij dhe çdoherë të përpiket që situata të shqyrtohet në mënyrë neutrale.

Megjithatë, përveç vlerësimit të pavarësisë në kuptimin e vlerave etike, siç është elaboruar më lartë, duhet të merret parasysh edhe botëkuptimi për pavarësinë në kontekstin e kësaj dispozite nga aspekti i veprimit të pavarur kundrejt veprimit në ekip.

Me fjalë të tjera, për shkak të nevojave reale apo si rezultat i vëllimit të punës, ligjvënësi ka parashikuar, me propozim të udhëheqësit të njësisë organizative për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara të ketë mundësi të formojë ekip për mbikëqyrje inspektuese të përbërë nga nëpunësit administrativë të Drejtorisë. Në situata të caktuara specifike imponohet nevoja për përcaktimin e ekipit që do të mundësojë një analizë të thukhtë dhe komplekse të problemit, ndërsa kjo nënkupton që në mënyrë racionale të sigurohet thellësia dhe gjerësia e nevojshme të njohurive dhe përvojës, e që nga ana tjetër do të thotë zgjidhje më të shpejtë dhe më efektive të karakterit të problemit, por kjo mund ta nënkuptojë edhe nevojën për harmonizimin e mendimeve të numrit më të madh të personave të angazhuar për një problem të caktuar. Mundësinë që e ka parashikuar ligjvënësi – drejtori të formojë ekip për mbikëqyrje inspektuese me propozim të udhëheqësit të njësisë organizative për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese mund të konsiderohet si zgjidhje pozitive meqë nënkupton më shumë njerëz ta bashkojnë mendimin për një ose më shumë çështje e që mundëson elementi i problemit të "ndriçohet" nga aspekte, mendime dhe njohuri të ndryshme ose për shkak të vëllimit të madh. Pikërisht prandaj ka gjasa më të mëdha që të miratohet një konkluzion ose opinion relevant. Megjithatë, duhet të theksohet se në punën e ekipit mund të ndodhë që përgjegjësi të shpërfillet sa i përket analizës eventuale të gabuar të gjendjeve. Nga kjo që u tha më lartë, duhet të konkludohet se mundësinë e këtillë drejtori duhet ta praktikojë me përjashtim, madje ashtu siç e ka përcaktuar në mënyrë të tërthortë edhe vet ligjvënësi, duke e parashikuar zgjidhjen e këtillë si bazë fakultative.

Në paragrafin 3 të nenit të njëjtë theksohet se inspektorët e kanë për detyrë të veprojnë në përputhje me ligjin dhe aktet normative. Inspektorët duhet të sigurojnë zbatim objektiv të ligjit dhe në përgjithësi ti përmbahen ligjit. Kjo nënkupton se

inspektorët gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese duhet të kenë qasje objektive, gjithëpërfshirëse, josedektive dhe jodiskriminuese ndaj dispozitave ligjore, që do të thotë se duhet të pozicionohet mirë dhe t'i përshtatet karakterit dhe esencës së çështjeve në subjektin e kontrolluar, ndërsa theksin duhet ta vë mbi lidhjen e ndërsjellë e cila pasqyrohet nga marrëdhëniet e përgjithshme të të gjitha subjekteve të përfshira në mbikëqyrjen inspektuese (inspektorët dhe subjekti i kontrollit). Vet mbikëqyrja inspektuese nënkupton mbikëqyrje për përcaktimin e asaj se puna e dikujt a është në përputhje me ligjin, ndërkaq gjithnjë e më shumë (a fortiori) pritët dhe theksohet nevoja që edhe vet inspektorët detyrat e tyre profesionale t'i kryejnë konform Ligjit.

Veprimi i kundërligjshëm i inspektorëve duke e pasur parasysh karakterin e mbikëqyrjes si dhe karakterin jashtëzakonisht specifik të punës së tyre më së shpeshti duhet të trajtohet si abuzim serioz dhe të kualifikohet ligjërisht, varësisht nga rrethanat e rastit, si një nga veprat penale të parashikuara në kreun XX të Kodit Penal: Vepra penale kundër detyrës zyrtare?.

Neni 83

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga neni 79 të këtij ligji, inspektorët janë të autorizuar:

- ▶ të bëjnë mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe të akteve të tjera normative nga fusha e sigurisë së informacioneve të klasifikuara,
- ▶ të propozojnë masa për shmangien e parregullsive dhe mangësive të përcaktuara brenda afatit të caktuar dhe
- ▶ të ndërmarrin veprime të tjera konform ligjit.

Në këtë nen ligjvënësi në mënyrë tejet të përgjithësuar i ka përcaktuar autorizimet themelore të cilat i posedojnë inspektorët e sigurimit të informacioneve të klasifikuara, ndërsa të njëjtat, para së gjithash, janë sistematizuar në tri fusha: së pari, inspektorët kryejnë mbikëqyrje mbi zbatimin e legjislacionit për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, së dyti, ata në bazë të mbikëqyrjes së realizuar in concreto, janë të autorizuar të propozojnë masa në mënyrë që të shmangen mangësitë dhe parregullsitë e përcaktuara gjatë zbatimit të Ligjit brenda periudhës së caktuar kohore dhe së treti të ndërmarrin veprime të tjera në përputhje me ligjin, me ç'rast ato më së shpeshti janë parashikuar në dispozita të tjera më konkrete. Autorizimet e theksuara edhe natyrisht ndërlidhen me njëra tjetrën. Së këtejmi, që të propozohen, për shembull, masa për shmangien e parregullsive, fillimisht duhet të zbatohet mbikëqyrje inspektuese në kuadër të së cilës janë përcaktuar këto parregullsi etj.

Neni 84

Cilësia zyrtare e inspektorit dëshmohet me legjitimacionin dhe distinktivin zyrtar. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e kanë për detyrë të legjitimohen. Legjitimacionin dhe distinktivin zyrtar nga paragrafi 1 të këtij neni e lëshon dhe heq drejtori i Drejtorisë.

Formularin, formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar, si edhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tyre, i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Dispozitat ligjore të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni e obligojnë inspektorin gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese detyrimisht të legjitimohet me çka do ta dëshmojë cilësinë e tij zyrtare. Kjo do të thotë se inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes duhet ta ketë legjitimacionin dhe distinktivin zyrtarë dhe kur thirret në punët e tij dhe detyrat e punës po ashtu e ka për detyrë ta tregojë legjitimacionin dhe distinktivin. Nëse në mënyrë konsekuente interpretohet kjo dispozitë, kjo nënkupton se inspektori kur do të kryej mbikëqyrje inspektuese, përkatësisht gjatë zbatimit të cilësdo qoftë detyrë të tij që i posedon si autorizim kur është në kontakt me personin tek i cili zbatohet mbikëqyrja, pa përjashtim duhet të legjitimohet. Në situatë kur nuk ka uniformë pune, e cila do ta identifikojë me vendin e punës, atëherë nevoja e legjitimitetit të rregullt është e arsyeshme.

Megjithatë, kjo dispozitë do të duhej të interpretohet në mënyrë restriktive, e që korrespondon me obligimin e inspektorit që të legjitimohet ndaj çdo kërkesë të palës e cila ka dyshime sa i përket veprimit të tij zyrtar. Ligji legjitimacionin e trajton si provë për aftësimin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese si leje e llojit të vet për trajtim profesional të punëve dhe detyrave të punës nga fusha e mbikëqyrjes inspektuese. Legjitimacioni i cili i lëshohet inspektorit me përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të Ligjit për nëpunësit administrativë dhe Ligjit për informacione të klasifikuara(*) është dëshmi për provimin e dhënë profesional sipas Rregullores të cilën e përcakton drejtori i Drejtorisë, përkatësisht kjo është një lloj "diplome" e cila fitohet për ta poseduar legjitimitetin për kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se inspektori e ka për detyrë ta kthejë legjitimacionin dhe distinktivin me kërkesë të drejtorit të Drejtorisë kur do të krijohen kushtet për heqjen e legjitimacionit dhe distinktitit për shkak të sjelljes së pandërgjegjshme dhe për shkak të rrethanave të tjera të cilat janë bazë për heqjen.

Rrethanat e këtilla inspektorin e bëjnë jodinjitoz për kryerjen e mëtutjeshme të shërbimit, kështu që ato janë bazë për heqjen e legjitimacionit dhe distinktitit. Gjithsesi, se autoriteti i cili e lëshon njëkohësisht është i thirrur ta heq legjitimacionin dhe distinktivin. Është evidente dhe më se logjike se inspektori nuk guxon gjatë punës së tij të sillet jashtë standardeve të përcaktuara të punës profesionale dhe normave etike të veprimit.

Në përputhje me paragrafin 3, formularin, formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit dhe distinktitit zyrtar, si dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tyre, i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Nëse e përgjithësojmë paragrafin e analizuar do të vijmë në konkluzionin se specializimi më i madh i pranishëm gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese kushtëzon të lëshohen legjitimacione dhe distinktivë të veçantë, ndërsa rrjedhimisht me këtë ato duhet të përcaktohen me formularë, formë dhe përmbajtje të veçantë, me Rregullore të miratuar nga drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara.

Rregullorja e parashikuar për modelin, formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit dhe distinktitit zyrtarë të inspektorit për sigurinë e informacioneve të klasifikuara dhe për mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tyre është miratuar dhe publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 240/20.

Neni 85

Për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, autoritetet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika dhe nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë e kanë për detyrë të mundësojnë kryerje papengesë të mbikëqyrjes në fushën e sigurisë së informacioneve të klasifikuara.

Mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme ose kontrolluese.

Mbikëqyrja e rregullt inspektuese e përfshinë mbikëqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji dhe bëhet sipas Planit vjetor dhe planit mujor të punës të çdo inspektori të cilët drejtori i Drejtorisë i miraton në përputhje me ligjin.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës të paraqitur nga autoritetet e pushtetit shtetërorë dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, nga personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, nga persona juridikë ose fizikë, si edhe në rast të dyshimit të inspektorit (sipas detyrës zyrtare).

Mbikëqyrja kontrolluese inspektuese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendimin për shmangien e mangësive të konstatuara.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e kanë të drejtën e qasjes dhe këqyrjes në çdo kohë dhe pa paralajmërim, në objekte, hapësira afariste, hapësira banimi dhe në hapësira në të cilat trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara.

Për kryerjen e punëve nga paragrafi 6 të këtij neni në hapësira banimi, inspektorët e kanë për detyrë të sigurojnë urdhër gjyqësor.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët mund të kërkojnë prezencë të personit të autorizuar nga autoriteti i pushtetit shtetërorë kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e punëve policore, për shkak të mbrojtjes së tyre.

Me nenin 85 paragrafin 1 përcaktohet detyrimi për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, autoritetet e pushtetit shtetërorë dhe lokal të themeluar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga komuna e Qytetit të Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë ta mundësojnë kryerjen papengesë të mbikëqyrjes nga fusha e sigurisë së informacioneve të klasifikuara. Përkatësisht, kjo nënkupton detyrim të gjitha subjektet e mbikëqyrjes të mundësojnë kryerje papengesë të të njëjtit. Nga ana tjetër, kjo ka të bëjë me atë se çdo gjë që duhet të vihet në dispozicion në mënyrë që të shihen gjendjet reale nga inspektorët të cilët e zbatojnë mbikëqyrjen inspektuese dhe nëse evidentohen parregullsi të caktuara atëherë duhet të ndërmerren aktivitete të caktuara korrektuese. Që të mundësohet kryerja papengesë e mbikëqyrjes duhet të ekzistojë një lloj i caktuar i bashkëpunimit.

Kur bëhet fjalë për mungesën e bashkëpunimit të personit juridik ose fizik të cilët janë objekt të mbikëqyrjes me kryerësin e mbikëqyrjes imponohen disa dyshime. Dyshimi i parë është në drejtim të të ashtuquajturës mungese e kamufluar e bashkëpunimit, përkatësisht çdoherë është më vështirë të matet sa është kuantumi i dokumentacionit që nevojitet për mbikëqyrje, ndërkaq nuk është dorëzuar gjatë kryerjes së saj (çdoherë ekziston mundësia që të dorëzohet në mënyrë plotësuese), ndërsa dyshimi akoma më problematik i cili e përfshinë subjektivitetin meqë qëndrimi i kryerësit të mbikëqyrjes dhe i personave (juridik dhe fizik) në të cilët kryhet mbikëqyrja objektivisht mund të jetë i ndryshëm. Kryerësi i mbikëqyrjes, përkatësisht inspektori duhet të jetë preciz dhe konkret me kërkesat e tij, konsistent, objektiv dhe i paanshëm dhe me mbikëqyrjen të kryej në momentin kur do ta realizojë gjendjen dhe do të vlerësojë se është mjaftueshëm që të nxjerr konkluzion përkatës, në vend që sërish të kërkojë informacione të reja e kështu me radhë, kur një gjë e këtillë është e panevojshme dhe e paarsyeshme.

Pengimi ose pamundësimi i kryerjes së mbikëqyrjes mbi personat juridikë dhe fizikë nga ana e inspektorëve nuk është përfshirë me dispozitat për kundërvajtje të këtij ligji. Ekzistimi i dispozitës së këtillë në mënyrë të drejtpërdrejtë duhet t'i adresohet personit përgjegjës në personin juridik, i cili e kryen esencën ligjore të kundërvajtjes që duhet të përcaktohet në mënyrë alternative edhe atë si: pengim i kryerjes së mbikëqyrjes, përkatësisht pamundësim i kryerjes së mbikëqyrjes; fshehje të dokumentacionit të kërkuar, përkatësisht mos dorëzimi i tij në dispozicion tek kryerësi i mbikëqyrjes, në këtë rast tek inspektori, ose pengim të mbikëqyrjes përmes mosdhënies së dokumenteve të nevojshme, të dhënave dhe informacioneve, për çka kundërvajtësit duhet t'i shqiptohet gjobë e lartë. Megjithatë, Ligji për mbikëqyrje inspektuese, i cili zbatohet për çdo gjë që nuk është përfshirë me dispozitat e Ligjit për informacione të klasifikuara(*)⁴⁸ parashikon kundërvajtje për veprime që e nënkuptojnë pengimin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese. Në nenin 98 paragrafi 1 të ligjit për mbikëqyrje inspektuese, si veprime kundërvajtëse, mes tjerash, është parashikuar pamundësimi i qasjes deri te hapësirat, produktet, pamundësimi i këqyrjes së dokumentacion etj.⁴⁸

Në paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni përcaktohet mënyra e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese, e cila mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme ose kontrolluese. Mbikëqyrja e rregullt inspektuese e përfshinë mbikëqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji dhe kryhet sipas Planit vjetor dhe planit mujor të punës të çdo inspektori të cilët i miraton drejtori i Drejtorisë në përputhje me ligjin. Atëherë, mbikëqyrje e rregullt zbatohet vazhdimisht dhe nënkuptohet si pjesë e një procesi në kontinuitet në të cilin mbikëqyrja është përcaktuar sipas dinamikës së rregullt. Prerogativët e këtillë janë pjesë përbërëse edhe të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese në të cilin në nenin 69 paragrafin 1 specifikohet se mbikëqyrja e rregullt inspektuese është mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e ligjeve dhe akteve përkatëse normative të miratuara në bazë të atyre ligjeve dhe kryhet sipas orarit paraprakisht të përcaktuar në Planin vjetor.⁴⁹ Kjo dispozitë ofron mundësi dhe kornizë më të gjerë nëse konstatohet se nevojitet edhe mbikëqyrje plotësuese dhe se mund të bëhet edhe mbikëqyrje e jashtëzakonshme dhe kontrolluese.

Sipas Rregullores për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese⁵⁰, mbikëqyrja e rregullt inspektuese tek subjekti i njëjtë bëhet një herë në vit.

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme më së shpeshti zbatohet në mënyrë plotësuese,

⁴⁸ Për më shumë, shih: Ligji për mbikëqyrje inspektuese, neni 98.

⁴⁹ Po aty, neni 69.

⁵⁰ Rregullore për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese "Gazeta Zyrtare" 246/20, neni 2, paragrafi 2.

pavarësisht dinamikës së planifikuar për zbatimin e mbikëqyrjes, apo siç është theksuar në paragrafin 4 të këtij neni, mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës së paraqitur nga autoritetet e pushtetit shtetërorë dhe lokal të themeluara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, nga personat juridikë të themeluar nga Republika ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, nga personat fizikë ose juridikë, si edhe në rastin e dyshimit të inspektorit (sipas detyrës zyrtare).

Mbikëqyrja e jashtëzakonshme inspektuese, sipas rregullit, është mbikëqyrje e pa paralajmëruar inspektuese dhe e njëjta zbatohet sa më shpejtë të jetë e mundur pas pranimit të iniciativës, përkatësisht siç e përcakton Rregullorja në nenin 2, paragrafin 3, më së voni në afat prej 15 ditëve të punës nga pranimi i iniciativës.

Mbikëqyrja kontrolluese inspektuese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar me aktin inspektues për shmangien e mangësive të konstatuara, përkatësisht mbikëqyrja kontrolluese përfshinë: këqyrje të drejtpërdrejtë në masat e përcaktuara, këqyrje në aktivitetet për shmangien e parregullsive, përkatësisht siç është përcaktuar në Ligjin për mbikëqyrje inspektuese, mbikëqyrja kontrolluese inspektuese është mbikëqyrje inspektuese e cila kryhet sipas detyrës zyrtare me qëllim që inspektori të konstatojë se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese, pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin inspektues gjatë mbikëqyrjes së kryer paraprake të rregullt ose të jashtëzakonshme inspektuese: a ka vepruar plotësisht sipas aktit inspektues; a ka vepruar pjesërisht sipas aktit inspektues ose nuk ka vepruar sipas aktit inspektues.⁵¹

Në përputhje me paragrafin 6, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e kanë të drejtën e qasjes dhe këqyrjes në çdo kohë dhe pa paralajmërim, në objektet, hapësirat afariste, hapësirat e banimit dhe në hapësirat në të cilat trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara dhe ashtu siç është theksuar në paragrafin 7 për kryerjen e punëve nga paragrafi 6 të këtij neni, në hapësirat e banimit inspektorët e kanë për detyrë të sigurojnë urdhër gjyqësor. Kjo sepse hapësirat e banimit e gëzojnë mbrojtjen kushtetuese dhe juridike penale të pacenueshmërisë së banesës.

Vendosja e sistemit të mbikëqyrjes, i cili njëkohësisht është edhe demokratik dhe efikas, është njëra nga sfidat më serioze. Një hap pozitiv në drejtim të mbikëqyrjes efikase është e drejta e inspektorëve të kenë qasje dhe këqyrje në çdo kohë pa paralajmërim në objekte, hapësira afariste, hapësira banimi (vetëm me urdhër) dhe në hapësira në të cilat trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara, përkatësisht është karakteristikë e mbikëqyrjes çdo gjë që punohet duhet të kontrollohet. Megjithatë, duhet të mbahet llogari që mbikëqyrja inspektuese dhe puna e inspektorëve të jetë transparente, e demistifikuar dhe në funksion të zbulimit të punës së paligjshme. Me këtë krijohet një raport pozitiv i personave të kontrolluar juridikë dhe fizikë për punën dhe detyrat e tyre që i ndërmarrin.

Në paragrafin 8 të këtij neni është përcaktuar se gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët mund të kërkojnë prezencë të personit të autorizuar nga autoriteti i pushtetit shtetëror kompetent për kryerjen e punëve nga fusha e punëve policore, për shkak të mbrojtjes së tyre. Në kuadër të veprimit mund të ketë situata të caktuara në të cilat inspektorët gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese mund të ballafaqohen me situata të pakëndshme, me rezistencë dhe ngjashëm veçanërisht kur kanë mundësi ligjore pa paralajmërim të qasen tek objekti, hapësirat afariste, hapësirat e banimit dhe në hapësirat në të cilat trajtohen dhe ruhen informacione të klasifikuara,

⁵¹ Ligji për mbikëqyrje inspektuese, neni 76 dhe Rregullorja për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, neni 2, paragrafi 4.

por edhe në situata të tjera gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese të rregullt, të jashtëzakonshme ose kontrolluese. Që të mos vijë deri në këtë, sipas vlerësimit paraprak të situatës, inspektorët mund të kërkojnë asistencë nga Ministria e Punëve të Brendshme në mënyrë që ta zbatojnë mbikëqyrjen e nevojshme inspektuese aty ku është planifikuar.

Neni 86

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori konstaton mangësi dhe parregullsi në lidhje me përmbushjen e kushteve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, miraton aktvendim me të cilin urdhëron shmangie të mangësive dhe parregullsive të konstatuara në afat të caktuar.

Kundër aktvendimit të inspektorit nga paragrafi 1 të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Për ankesën ndaj aktvendimit të inspektorit vendos Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë nga Fusha e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.

Domethënia e kryerjes së mbikëqyrjes mbipersonat juridikë dhe fizikë është potencuar me dispozitën e nenit 86 paragrafi 1 të këtij ligji. Kjo dispozitë në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara lidhur me përmbushjen e kushteve të sigurisë së informacioneve të klasifikuara gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese. Në rastin kur inspektori do të konstatojë se ekzistojnë parregullsi dhe mangësi, përkatësisht se subjektet e kontrolluara që janë objekt të mbikëqyrjes inspektuese nuk i përmbahen ligjit dhe akteve të tjera normative të cilat e rregullojnë këtë materie, inspektori do të miratojë aktvendim me të cilin urdhërohet shmangia e mangësive dhe parregullsive të konstatuara në afat të caktuar. Ky është një konfirmim i aspekteve teorike se mbikëqyrja inspektuese, edhe pse në fund të fundit është represive, ajo fillimisht është preventive. Personi juridik dhe personi fizik të cilët punojnë me informacione të klasifikuara duhet të ndër marrin hapa konkret për shmangien e mangësive eventuale.

Ligjvënësi edhe këtu nuk e ka "harruar" dyshkallësinë, kështu që subjektet e prekura me mbikëqyrjen kanë të drejtë të paraqesin ankesë, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit të njëjtë, nëse konsiderojnë se aktvendimi i inspektorit nuk e pasqyron situatën reale të punës me informacione të klasifikuara dhe se janë të dëmtuar në procedurën me të cilën është konstatuar se nuk janë respektuar standardet e parashikuara të përcaktuara me aktet normative që do të thotë se është bërë shpërfillje e caktuar në punën e tyre.

Afati i paraqitjes së ankesës është 15 ditë nga dita e pranimi të aktvendimit, ndërsa autoriteti kompetent për vendimmarrje sipas ankesës është Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë nga Fusha e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse.⁵²

Në përputhje me Ligjin për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë nga Fusha e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse, Komisioni në procedurën e vendimmarrjes sipas ankesave i zbaton dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për kundërvajtje, nëse me këtë ose me ndonjë ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe. Në

⁵² Ligji për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të dytë në Fushën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 130/14, 53/16 dhe 11/18.

përputhje me nenin 11 të ligjit të njëjtë, kundër aktvendimit të Komisionit Shtetëror për Vendimarrje në Shkallë të Dytë nga Fusha e Mbiqëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse mund të hapet kontest administrativ para gjykatës kompetente, ndërsa padia kundër aktvendimit të këtillë të Komisionit Shtetëror nuk e shtyn ekzekutimin e tij.

Neni 87

Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, inspektori harton procesverbal me gjetje të gjendjes të cilin e paraqet në mënyrë dhe në afat të parashikuar me ligj.

Për masat e propozuara për shmangien e mangësive dhe parregullsive inspektori miraton aktvendim me afate për kryerjen e tyre. Personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes e ka për detyrë të veprojë sipas aktvendimit dhe ta njoftojë inspektorin për aktivitetet e ndërmarra.

Neni 87 duhet të lexohet edhe në kontekst të nenit 86 meqë e rregullon situatën nga paragrafi 1 të këtij neni. Dispozitat e nenit 87 në mënyrë të drejtpërdrejt kanë të bëjnë me personin juridik dhe fizik në të cilin kryhet mbikëqyrja inspektuese dhe u referohen mangësive dhe parregullsive të konstatuara të cilat e pamundësojnë kryerjen e qenies ligjore. Për lëshimet e lartpërmendura dhe përgjithësisht për cilindo qoftë gjendje të konstatuar inspektori e ka për detyrë të hartojë procesverbal me gjetje për gjendjen dhe të njëjtin e paraqet në mënyrë dhe në afat të parashikuar me ligj. Në këtë kontekst merren parasysh dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese të cilat parashikojnë për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, për gjendjen e konstatuar faktike, për parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara dhe të përcaktuara, për vërejtjet, deklaratat dhe për fakte dhe rrethana të tjera relevante, inspektori të hartojë procesverbal me shkrim në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.⁵³ Procesverbalin e nënshkruan inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes inspektuese të cilit i dorëzohet një kopje. Nëse subjekti i mbikëqyrjes inspektuese refuzon ta nënshkruaj procesverbalin, inspektori do t'i theksojë shkaqet e refuzimit. Me përjashtim në rastet kur për shkak të vëllimit dhe kompleksitetit të mbikëqyrjes inspektuese, për shkak të natyrës dhe rrethanave të punës, nuk ka mundësi të hartohet procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes, procesverbali hartohet në hapësirat zyrtare të shërbimit inspektues në afat prej tre ditësh nga dita e mbikëqyrjes inspektuese me arsyetim për shkaqet e të njëjtës.⁵⁴

Siç është e zakonshme, kur do të konstatohen mangësi dhe parregullsi të caktuara gjatë punës miratohet aktvendim për shmangien e tyre. Në nenin e njëjtë 87, në paragrafët në vijim në mënyrë implicite vihet në dukje se personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes e ka për detyrë të veprojë sipas aktvendimit dhe ta njoftojë inspektorin për aktivitetet e ndërmarra. Inspektori në aktvendimin do t'i përcaktojë afatet brenda të cilave duhet të shmangen mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara. Siç mund të konkludohet, afatet në njëfarë mënyre i obligojnë të dyja palët. Në të vërtetë, intenca e ligjvënësit është ta kufizojë kohëzgjatjen brenda të cilës duhet të ndërmerren masa konkrete për shmangien e parregullsive dhe mangësive. Subjekti sipas rregullit duhet ta njoftojë inspektorin për aktivitetet e ndërmarra. Aktvendimet e këtilla të inspektorit janë bazë për të ashtuquajturën mbikëqyrje kontrolluese inspektuese.

⁵³ Ligji për mbikëqyrje inspektuese, neni 82, paragrafi 1.

⁵⁴ Po aty, neni 82, paragrafët 2 dhe 3.

Neni 88

Nëse inspektori konstaton se në përdorim janë pajisje, mjete teknike, instalacione dhe sisteme të cilat nuk korrespondojnë me standardet dhe kriteret e përcaktuara të sigorisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, me aktvendim shqipton ndalim të përdorimit të tyre dhe shmangien e tyre.

Me dispozitat e këtij neni, është përcaktuar detyrimi i personave juridikë dhe fizikë të cilët punojnë me informacione të klasifikuara vazhdimisht të kujdesen për standardet e parashikuara të sigorisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara dhe të mos lejojnë në përdorim të kenë pajisje, mjete teknike, instalacione dhe sisteme të cilat nuk korrespondojnë me standardet e përcaktuara. Është logjike dispozita se nëse evidentohet situatë e kështillë do të miratohet aktvendim me të cilin do të ndalohej përdorimi i tyre dhe do të kërkohet shmangia e tyre. Mos përmbushja e cilitdo qoftë kusht konsiderohet si shkelje serioze e Ligjit.

Nevoja për mbikëqyrje më të madhe mbi punën e ligjshme në fushën e përdorimit të pajisjeve, mjeteve teknike, instalacioneve dhe sistemeve konsiston me rrezikun gjithnjë e më të madh i cili vjen nga zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë, veçanërisht të teknologjisë së informacionit.

Neni 89

Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë nga çrregullimi i sigorisë së objekteve ose hapësirave, dokumenteve, pajisjes, sistemeve dhe personave në brezin e sigorisë, zonës së sigorisë ose zonës administrative, me aktvendim do të shqiptojë ndalim për përdorimin e hapësirës, objektit ose të një pjese të objektit.

Kjo është një normë restriktive në lidhje me situata të rrezikut të drejtpërdrejtë të sigorisë që mund të ndodhë. Me fjalë të tjera, nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë nga çrregullimi i sigorisë së objekteve ose hapësirave, dokumenteve, pajisjes, sistemeve dhe personave në brezin e sigorisë, zonës së sigorisë ose zonës administrative, atëherë me aktvendim do të shqiptojë ndalim për përdorimin e hapësirës, objektit ose të një pjese të objektit.

Esenca e aktvendimit me të cilin shqiptohet ndalim i përdorimit të hapësirës, objektit ose të një pjese të objektit etj. është mbrojtja nga pasojat e dëmshme që mund të ndodhin dhe do të nënkuptojë cenim dhe shkatërrim i të mirave të rëndësishme juridike, ndërsa aspekti emergjent i situatës është bazë për nevojën e zgjidhjes së kështillë.

Neni 90

Për shkak të ekzekutimit të aktvendimit nga neni 86 paragrafi 1 dhe 88 të këtij ligji, inspektori e vulos objektin ose hapësirën në fjalë.

Vulosja nga paragrafi 1 të këtij neni bëhet me vulë dylli të Drejtorisë.

Përmbajtjen dhe formën e vulës së dyllit, si dhe mënyrën e vulosjes, me rregullore i përcakton drejtori i Drejtorisë.

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni, përcakton që inspektori ta bëjë vulosjen e objektit ose hapësirës në fjalë me qëllim të ekzekutimit të aktvendimit nga neni 86 paragrafi 1 dhe neni 88 të këtij ligji. Me këtë pamundësohet përdorimi i tyre i mëtutjeshëm deri në momentin e shmangies së mangësive. Vulosjen e bën inspektori dhe në përputhje me paragrafin 2 të nenit të njëjtë kjo bëhet me vulë dylli të Drejtorisë, e cila nga aspekti i formës dhe përmbajtjes rregullohet me Rregulloren të veçantë e cila e rregullon edhe mënyrën e vulosjes. Rregulloren e miraton drejtori i Drejtorisë dhe është publikuar në "Gazetën Zyrtare" numër 187/2020.

Në përputhje me dispozitat e tij vula e dyllit është në formë të rrethit me diametër prej 30 mm, e përpunuar nga metali për ta shtypur dyllin për vulosje, i cili është përforcuar në një dorezë druri, ndërsa vulosja me vulën e dyllit bëhet me dyllë të kuq me pe (shirit) të kuq të verdhë.

Neni 91

Pas shmangies së mangësive të konstatuara, për shkak të të cilave është shqiptuar masa e ndalimit, ndërsa sipas kërkesës me shkrim të subjektit të cilit i është shqiptuar masa, inspektori e bën zhvulosjen.

Kynen ndërlihet me nenet paraprak, përkatësisht përcakton se në rast të shmangies së parregullsive të konstatuara, për shkak të të cilave është shqiptuar masa e ndalimit, ndërsa sipas kërkesës paraprake me shkrim të subjektit të cilit i është shqiptuar masa, inspektori e bën zhvulosjen. Drejtorja, në të vërtetë inspektorët e saj kanë supremaci të plotë në pjesën e vulosjes dhe zhvulosjes, përkatësisht bëhet fjalë për të drejtë të etabluar e cila tanimë ekziston dhe kryhet sipas nevojës së krijuar reale kështu që kur nevoja e vulosjes nuk do të nevojitet më, inspektori duhet ta bëjë zhvulosjen.

Neni 92

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera normative nga fusha e sigurisë së informacioneve të klasifikuara, inspektorët mund të urdhërojnë të ndërmerren masat si vijojnë:

- ▶ demontim, zhvendosje ose shmangie të pajisjes, aparateve, instilacioneve dhe sistemeve me të cilët rrezikohet siguria e informacioneve të klasifikuara,
- ▶ përcaktim të brezit të sigurisë, zonave të sigurisë dhe zonave administrative rreth objektit, hapësirës ose hapësirës brenda objektit në të cilën trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara,
- ▶ vendosje të pajisjes së sigurisë të komunikimit-informacionit, sistemeve dhe instalacioneve për sigurinë e informacioneve të klasifikuara,
- ▶ zhvendosje ose largim të personave pa certifikatë përkatëse të sigurisë ose pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe nga zonat e sigurisë dhe administrative në objektin në të cilin trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara,
- ▶ zhvendosje ose largim të automjeteve pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe në zonën administrative të objektit në të cilin trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara,
- ▶ hartim të akteve interne për vlerësimin e rrezikut të sigurisë ndaj

informacioneve të klasifikuara dhe për mbrojtjen e tyre në rast të rrethanave të jashtëzakonshme,

- ▶ azhurnim dhe korrigjim të evidencave të informacioneve të klasifikuara dhe shmangien dhe shkatërrimin e tyre,
- ▶ sigurim të kushteve të përcaktuara për diseminim dhe transferim të informacioneve të klasifikuara,
- ▶ ndalim për pranimin, trajtimin, kalimin dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara dhe
- ▶ masa të tjera për të cilat inspektori do të konstatoj se janë në funksion të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në subjektin e mbikëqyrjes.

Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e punës së subjekteve të cilët ruajnë dhe trajtojnë informacione të klasifikuara kryejnë personat e autorizuar zyrtarë për mbikëqyrje, përkatësisht inspektorë të cilët mund të urdhërojnë ndërmarrje të më shumë masave. Në paragrafin 1 të këtij neni në mënyrë taksative janë përcaktuar masat kryerjen e të cilave mund ta urdhërojnë inspektorët në përputhje me dispozitat e Ligjit për informacione të klasifikuara(*). Bëhet fjalë për masat të cilat kanë pikë së pari karakter preventiv, si vijojnë: demontim, zhvendosje ose shmangie të pajisjes, aparateve, instalacioneve dhe sistemeve me të cilët rrezikohet siguria e informacioneve të klasifikuara; përcaktim të brezit të sigurisë, zonave të sigurisë dhe zonave administrative rreth objektit, hapësirës ose hapësirës brenda objektit në të cilën trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara; vendosje të pajisjes së sigurisë të komunikimit-informacionit, sistemeve dhe instalacioneve për sigurinë e informacioneve të klasifikuara; zhvendosje ose largim të personave pa certifikatë përkatëse të sigurisë ose pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe nga zonat e sigurisë dhe administrative në objektin në të cilin trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara; zhvendosje ose largim të automjeteve pa leje përkatëse për qasje në brezin e sigurisë rreth objektit dhe në zonën administrative të objektit në të cilin trajtohen ose ruhen informacione të klasifikuara; hartim të akteve interne për vlerësimin e rrezikut të sigurisë ndaj informacioneve të klasifikuara dhe për mbrojtjen e tyre në rast të rrethanave të jashtëzakonshme; azhurnim dhe korrigjim të evidencave të informacioneve të klasifikuara dhe shmangien dhe shkatërrimin e tyre; sigurim të kushteve të përcaktuara për diseminimin dhe transferimin e informacioneve të klasifikuara; ndalim për pranimin, trajtimin, kalimin dhe ruajtjen e informacioneve të klasifikuara dhe masa të tjera për të cilat inspektori do të konstatoj se janë në funksion të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në subjektin e mbikëqyrjes. Është e evidente, se këto masa janë në funksion të mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara në subjektin e mbikëqyrjes.

Neni 93

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori konstaton shkelje të ligjit dhe të akteve të tjera normative që nënkupton kundërvajtje, paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për kundërvajtje.

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori konsideron se shkelja është vepër penale, e ka për detyrë menjëherë ta njoftojë drejtorin e Drejtorisë për shkak të ngritjes së procedurës para autoritetit kompetent.

Me nenin 93 paragrafin 1 ligjvënësi e ka parashikuar detyrën për ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të ngritjes së procedurës përkatëse me të cilën do të sanksionohet shkelja e Ligjit dhe të akteve të tjera normative e që nënkupton kundërvajtje ose vepër penale.

Së këtejmi, inspektori e ka për detyrë të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës kundërvajtëse kundër personit i cili do ta shkel Ligjin dhe i cili vepron ose ka vepruar në kundërshtim me Ligjin dhe me aktet e tjera normative në fushën e informacioneve të klasifikuara. Është evidente se në këtë rast inspektori e ka të drejtën sovranë të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për ngritjen e procedurës kundërvajtëse me të cilën kërkohet që kundër personit të hapet procedurë kundërvajtëse në bazë të së cilës do t'i shqiptohet edhe sanksioni për kundërvajtje. Procedura zhvillohet në përputhje me dispozitat kundërvajtëse të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) dhe Ligjit për kundërvajtje.

Sipas dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektori konsideron se shkelja paraqet vepër penale atëherë ai e ka për detyrë menjëherë ta njoftoj drejtorin e Drejtorisë për shkak të ngritjes së procedurës para autoritetit kompetent. Kjo nënkupton se drejtori i Drejtorisë e ka për detyrë menjëherë të ndërmarrë masa dhe t'i njoftojë autoritetet kompetente për shkak të veprimit të mëtutjeshëm në përputhje me ligjin, përkatësisht të paraqes kallëzim penal, ta njoftojë Prokurorinë publike, e cila pastaj, në procedurë përkatëse do t'i shqyrtojë gjetjet, faktet dhe rrethanat dhe do të marrë vendim për ndërmarrjen ose mos ndërmarrjen e ndjekjes penale.

KREU I SHTATË

DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 94

Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik përdorues të informacioneve të klasifikuara, nëse:

- ▶ nuk i zbaton masat e sigurisë administrative, fizike të sistemeve të komunikimit – informacionit, sigurisë së personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara ose sigurisë industriale të informacioneve të klasifikuara në përputhje me dispozitat e neneve 26, 28, 29, 31, 32 dhe 33 të këtij ligji,
- ▶ nuk vepron me informacionet e klasifikuara, në përputhje me dispozitën e nenit 56 paragrafi 1 të këtij ligji (përveç nëse veprimi nuk paraqet vepër penale),
- ▶ nuk njofton për pushimin e plotësimit të ndonjërit nga kushtet në bazë të të cilëve është lëshuar certifikata e sigurisë, në përputhje me dispozitat e nenit 42 të këtij ligji,
- ▶ e pengon kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në përputhje me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë në denarë shqiptohet për kundërvajtje të personit përgjegjës në personin juridik-përdorues të informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë shqiptohet për kundërvajtje të personit fizik përdorues të informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni.

Në nenin 94, si dhe në gjashtë nenet e ardhshëm të këtij ligji, ligjvënësi ka parashikuar gjoba për kundërvajtje të kryera në lidhje me zbatimin jopërkates të këtij ligji për personin juridik përdorues të informacioneve të klasifikuara, për personin përgjegjës në personin juridik përdorues të informacioneve të klasifikuara dhe për personin fizik përdorues të informacioneve të klasifikuara. Duke u udhëhequr nga dispozitat e Ligjit për kundërvajtje, edhe atë veçanërisht në pjesën e identifikimit të fushave në të cilat mund të shqiptohen gjoba më të larta për kundërvajtjet nga ato që janë parashikuar në Ligjin (ligjin e përgjithshëm) për personin fizik dhe për personin përgjegjës në personin juridik,⁵⁵ ligjvënësi në këtë nen ka parashikuar gjoba më të larta për kundërvajtjet në fushën e informacioneve të klasifikuara për shkak të natyrës dhe seriozitetit të dëmeve

ndaj shtetit që mund të ndodhin nga trajtimi i paligjshëm i informacioneve të klasifikuara dhe nga kalimi i tyre për përdorim tek personat e paautorizuar. Zbulimi i paautorizuar i informacioneve të klasifikuara mund të ndikojë dëmshëm mbi mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, mbi mbrojtjen e pasurive natyrore, mjedisin jetësor, mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ndërsa informacionet e klasifikuara mund t'u zbulohen personave të paautorizuar për dobi personale ose të shkaktojnë dëm më të madh pronësorë.

Si rezultat i kësaj ligjvënësi ka parashikuar gjobë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë për personin juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara, nëse: nuk i zbaton masat e sigurisë administrative, fizike të sistemeve të komunikimit-informacionit, sigurisë së personave-përdorues të informacioneve të klasifikuara ose të sigurisë industriale të informacioneve të klasifikuara, në përputhje me dispozitat e neneve 26, 28, 29, 31, 32 dhe 33 të këtij ligji; nuk i trajton informacionet e klasifikuara, në përputhje me dispozitën e nenit 56 paragrafi 1 të këtij ligji (përveç nëse veprimi nuk paraqet vepër penale); nuk njofton për pushimin e përmbytjes të njërës nga kushtet në bazë të të cilit është lëshuar certifikata e sigurisë, në përputhje me dispozitën e nenit 42 të këtij ligji, dhe nëse e pengon kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në përputhje me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Në paragrafin 2 të këtij neni ligjvënësi ka parashikuar gjobë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të personit përgjegjës në personin juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjet e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni. Ndërsa në paragrafin 3, është parashikuar gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të personit fizik përdorues i informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni.

Neni 95

Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara, nëse nuk i ndërmerr aktivitetet e nevojshme për pranimin, përpunimin, përcaktimin e përdoruesve dhe nëse nuk e bën diseminacionin e informacioneve të klasifikuara deri te të njëjtit, në përputhje me dispozitat e nenit 26 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik përdorues i informacioneve të klasifikuara për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Në nenin 95 ligjvënësi i ka përcaktuar gjobat për kundërvajtje të personit juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara, të personit përgjegjës në personin juridik përdorues i informacioneve të klasifikuara dhe të personit fizik përdorues i informacioneve të klasifikuara nëse nuk i ndërmerr aktivitetet e nevojshme për pranimin, përpunimin, përcaktimin e përdoruesve dhe nëse nuk e bëjnë diseminacionin e informacioneve të klasifikuara deri te të njëjtit, në përputhje me dispozitat e nenit 26 të këtij ligji. Së këtejmi, shuma e gjobës së përcaktuar për kundërvajtje të personit juridik është prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë, për kundërvajtje të personit përgjegjës është 1.000

deri në 1.500 euro me kundërvlerë me denarë ndërsa për kundërvajtje të personit fizik nga 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Neni 96

Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit juridik i cili do të veprojë në kundërshtim me detyrimin për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të shënuara me nivelin "INTERN" nga neni 47 paragrafi 2 dhe në kuptimin e nenit 2 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Në nenin 96 janë përcaktuar gjobat në lidhje me veprimin e kundërligjshëm me informacionet e klasifikuara të shënuara me nivelin "INTERN", përkatësisht për veprimin në kundërshtim me detyrimin për mbrojtjen e tyre konform nenit 47 paragrafi 2 dhe konform nenit 2 të këtij ligji. Së këtejmi, është përcaktuar gjobë në shumë prej 1500 deri 2000 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të personit juridik, gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë është përcaktuar për kundërvajtje të personit përgjegjës në personin juridik, ndërsa për kundërvajtje të personit fizik është përcaktuar gjobë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Neni 97

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet personit juridik i cili në kundërshtim me nenin 12 do të zbulojë informacion të shënuar "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR".

Gjobë në shumë prej 450 deri 700 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Në nenin 97 janë përcaktuar gjoba për veprimin në kundërshtim me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji, përkatësisht për zbulimin e informacionit të shënuar me shenjë "PËR PËRDORIM TË KUFIZUAR". Së këtejmi shuma e gjobës së përcaktuar për kundërvajtjen e personit juridik është nga 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, për kundërvajtje të personit përgjegjës është nga 450 deri 700 euro në kundërvlerë në denarë, ndërsa për kundërvajtje të personit fizik nga 300 deri 500 euro në kundërvlerë në denarë.

Neni 98

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet për kundërvajtje oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara, nëse:

- nuk përmbush ndonjërin nga kompetencat e tij të specifikuar në nenin 68 të

këtij ligji,

- e pengon kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në përputhje me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Në nenin 98 ligjvënësi i ka përcaktuar gjobat për kundërvajtje të oficerit të sigurisë së informacioneve të klasifikuara në shumë prej 500 deri 1000 euro në kundërvlerë në denarë nëse nuk e plotëson ndonjërin nga detyrimet e tij të theksuara në nenin 68 të këtij ligji ose nëse e pengon kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në përputhje me dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

Duhet të merret parasysh se në çdo rast konkret duhet të shqyrtohen të gjitha rrethanat që të përcaktohet se ndonjë veprim i caktuar a mund të trajtohet edhe si veprë penale veçanërisht nëse kryerësi ka vepruar me dashje ose me qëllim të veçantë dhe ka shkaktuar pasojë të dëmshme përkatëse me esencën e veprës.

Neni 99

Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar i cili do të veprojë në kundërshtim me nenin 10 paragrafin 2 dhe i informacionit të klasifikuar për të cilin nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm për dëmin dhe pasojat e mundshme.

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë në denarë i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Ligjvënësi ka parashikuar gjoba për kundërvajtje të personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar, të personit përgjegjës në personin juridik dhe të personit fizik nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 10 paragrafin 2 të këtij ligji, përkatësisht nëse nuk përcaktojnë nivel përkatës të klasifikimit të informacionit në bazë të vlerësimit të dëmit dhe pasojave të mundshme që mund të shfaqen nga qasja e paautorizuar tek i njëjti. Së këtejmi, për kundërvajtje të personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar ligjvënësi ka parashikuar gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të personit përgjegjës në personin juridik ka parashikuar gjobë në lartësi prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, ndërsa për kundërvajtjen e personit fizik ka parashikuar gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë në denarë.

Mos përcaktimi i nivelit përkatës të klasifikimit të ndonjë informacioni të caktuar mund të ketë pasoja serioze meqë me këtë, në vend që të mbrohet në mënyrë përkatëse, informacioni bëhet plotësisht ose pjesërisht i aksesshëm për personat të cilët objektivisht nuk duhet të njoftohen me përmbajtjen e tij, kështu që mund të paraqes rrezikim konkret të interesave të shtetit dhe të rezultojë me pasoja të dëmshme dhe në këtë rast duhet të shqyrtohen mundësitë e abuzimit përkatësisht veprës penale.

Neni 100

Gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar i cili do të veprojë në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 2 dhe nëse nuk e njofton përdoruesin e informacionit të klasifikuar për ndryshimin e nivelit të klasifikimit ose për deklasifikimin e tij.

Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë, i shqiptohet personit fizik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 të këtij neni.

Në nenin 100 janë përcaktuar gjobat për kundërvajtje të personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar, të personit përgjegjës në personin juridik dhe të personit fizik nëse veprojnë në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 2 të këtij ligji dhe nëse nuk e njoftojnë përdoruesin e informacionit të klasifikuar për ndryshimin e nivelit të klasifikimit ose për deklasifikimin e tij.

Së këtejmi, për kundërvajtje të personit juridik krijues i informacionit të klasifikuar, ligjvënësi ka parashikuar gjobë në shumë prej 1.500 deri 2.000 euro në kundërvlerë në denarë për kundërvajtje të personit përgjegjës në personin juridik ka parashikuar gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë në denarë ndërsa për kundërvajtjen e personit fizik ka parashikuar gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë në denarë.

PROCEDURA E BARAZIMIT ME LËSHIMIN E URDHËRPAGESËS PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 101

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë Ligj, në përputhje me ligjin për kundërvajtje, inspektori e ka për detyrë kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje para se të paraqes kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje.

Inspektori e ka për detyrë të mbajë evidencë për urdhërpagesat e lëshuara për kundërvajtje dhe për epilogun e tyre.

Në evidencën nga paragrafi 2 të këtij neni sublimohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat si vijon: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje që i është lëshuar dhe epilogu i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 3 të këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e regjistrimit në evidencë.

Drejtori e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje.

Për çdo gjë që nuk është rregulluar me këtë ligj, në lidhje me urdhërpagesën për kundërvajtje, zbatohen dispozitat e ligjit për kundërvajtje.

Në nenin 101 ligjvënësi e trajton institutin "barazim" në procedurën për kundërvajtje. Në përputhje me Ligjin për kundërvajtje⁵⁶, ligjvënësi ka përcaktuar se inspektori i informacioneve të klasifikuara e ka për detyrë kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje, para se të paraqes kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje. Në paragrafin 2 është përcaktuar se inspektori mban evidencë për urdhërpagesat e lëshuara në të cilën sublimohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat si vijojnë: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës për kundërvajtje që i është lëshuar dhe epilogu i procedurës. Së këtejmi është rregulluar se të dhënat personale ruhen pesë vjet nga dita e regjistrimit në evidencë.

Ligjvënësi ka parashikuar që formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje me akt nënligjor t'i përcaktojë drejtori i Drejtorisë, ndërsa për çdo gjë tjetër që nuk është parashikuar me këtë ligj, në lidhje me urdhërpagesën për kundërvajtje të zbatohen dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

Për më tepër, Ligji për kundërvajtje si lex generalis zbatohet çdoherë kur në ligjin e posaçëm instituti ose procedura e caktuar nga e drejta kundërvajtëse nuk janë rregulluar ndryshe.

Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje është miratuar dhe publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 181/20 dhe 285/20.

Neni 102

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje zhvillon dhe sanskion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

Në nenin 102 ligjvënësi ka parashikuar se për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurë për kundërvajtje zhvillon dhe sanskion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

Kjo dispozitë është në përputhje me nenin 54 paragrafin 1 të Ligjit për kundërvajtje.

⁵⁶ Ligji për kundërvajtje, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 96/19, neni 51.

KREU I TETË

DISPOZITA NDËSHKUESE

ZBULIMI I INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA TË NIVELIT "TEPËR SEKRET" DHE "SEKRET"

Neni 103

Ai i cili publikut ose personit të pathirrur ia komunikon, dorëzon ose e bën të aksesshëm informacionin i cili është klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" deri te i cili ka qasje në përputhje me ligjin dhe me këtë i rrezikon ose cenon interesat vitale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të dënohet me burgim prej 1 deri 5 vjet.

Ai i cili publikut ose personit të pathirrur ia komunikon, dorëzon ose ia bën të aksesshëm informacionin që e di se është i klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET", deri te i cili ka ardhur në mënyrë të kundërligjshme, do të dënohet me burgim prej një deri tre vjet.

Ai i cili publikut ose personit të pathirrur do t'ia komunikojë, dorëzojë ose do t'ia bëjë të aksesshëm informacionin që është klasifikuar në nivelin "SEKRET" deri te i cili ka qasje në përputhje me ligjin dhe me këtë i rrezikon ose cenon interesat e rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të dënohet me burgim prej një deri tre vjet.

Ai i cili publikut ose personit të pathirrur do t'ia komunikojë, dorëzojë ose do t'ia bëjë të aksesshëm informacionin që e di se është i klasifikuar në nivelin "SEKRET", deri te i cili ka ardhur në mënyrë të kundërligjshme, do të dënohet me dënim në para ose me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, është kryer gjatë kohës së gjendjes së luftës, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Tentativa për veprën nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, është e dënueshme.

Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me dënim me para ose me burgim deri në një vit.

Në nenin 103 është inkriminuar zbulimi i informacioneve të klasifikuara të nivelit "TEPËR SEKRET" dhe "SEKRET".

Me inkorporimin e këtyre dispozitave në ligj u plotësua vakumi momental, përkatësisht zbrazëtira e dispozitës ndëshkuese në lidhje me veprimin e kundërligjshëm me informacionet e klasifikuara të nivelit "TEPËR SEKRET" dhe "SEKRET".

Për më tepër, Kodi Penal përmban dispozita vetëm për informacionet që konsiderohen si "SEKRET SHTETËROR" dhe përcakton masa dënuese për zbulimin e tyre në kuadër të kreut të njëzetetë: vepra penale kundër shtetit, në nenin 317.⁵⁷

Së këtijmi, në paragrafin e parë të këtij neni ligjvënësi ka parashikuar se personi i cili publikut apo personit të pathirrur ua komunikon, dorëzon ose e bën të aksesshëm informacionin i cili është klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" deri te i cili ka qasje në përputhje me ligjin dhe me këtë i ka rrezikuar ose cenuar interesat vital të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të dënohet me burgim prej një deri pesë vjet.

Në paragrafin e dytë është parashikuar përgjegjësi për personin i cili publikut ose personit të pathirrur ia komunikon, dorëzon ose e bën të aksesshëm informacionin që e di se është klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET", deri te i cili ka ardhur në mënyrë të kundërligjshme, me ç'rast veprimi i këtillë dënohet me burgim prej një deri tre vjet.

Forma nga paragrafi 1 sipas ligjvënësit është më e rëndë nga forma e veprës nga paragrafi 2, meqë në rastin e parë veprimin e kundërligjshëm e bën personi të cilit i është besuar informacioni i klasifikuar, që do të thotë se ai e abuzon detyrën e tij, në kushte kur pritet pikërisht ai ta ofrojë mbrojtjen e nevojshme nga qasja e pa autorizuar. Vepra nga paragrafi 2 nënkupton se kryerësi në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht në mënyrë të palejuar ka ardhur deri te informacioni i klasifikuar, me ç'rast të njëjtin do t'ia bëjë të aksesshëm personit të pathirrur ose publikut.

Në paragrafin e tretë ligjvënësi ka parashikuar se personi i cili publikut ose personit të pathirrur ia komunikon, dorëzon ose ia bënë të aksesshëm informacionin i cili është i klasifikuar në nivelin "SEKRET" deri te i cili ka qasje në përputhje me ligjin dhe me këtë i rrezikon ose cenon interesat e rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të dënohet me burgim prej një deri tre vjet. Në paragrafin 4 është përcaktuar se ai i cili publikut ose personit të pathirrur do t'ia komunikojë, dorëzojë ose do t'ia bëjë të aksesshëm informacionin që e di se është i klasifikuar në nivelin "SEKRET", deri te i cili ka ardhur në mënyrë të kundërligjshme, do të dënohet me dënim me para ose burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në paragrafin 5 ligjvënësi e ka parashikuar të ashtuquajturën formë e kualifikuar të veprës, më saktë nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 3 është kryer gjatë kohës së gjendjes së luftës, kryerësi do të dënohet me burgim prej 1 deri 10 vjet.

Nga ana tjetër, në mënyrë eksplicite është përcaktuar se tentativa për veprën nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni është e dënueshme, meqë në përputhje me dënimin e përcaktuar për veprat nga paragrafët e cekur nuk mund të zbatohet dispozita e nenit 19 të Kodit Penal për dënimin e tentativës. Në të vërtetë, tentativa për të gjitha veprat nga paragrafët 1-4 është e dënueshme, vetëm paragrafi 1 i referohet nenit 19 të Kodit Penal, ndërsa për paragrafët e tjerë një gjë e këtillë është parashikuar në mënyrë eksplicite.

Ligjvënësi e sanskionon edhe veprimin e kryer nga pakujdesia, kështu që në paragrafin e fundit të këtij neni ka parashikuar se nëse personi nga pakujdesia e publikut ose të personit të pathirrur e komunikon, dorëzon ose e bën të aksesshëm informacionin që është klasifikuar në nivelin "TEPËR SEKRET" ose "SEKRET" deri te i cili ka qasje në përputhje me ligjin dhe me këtë i ka rrezikuar ose cenuar interesat vital, përkatësisht

⁵⁷ Kodi Penal, neni 316 paragrafi 6 dhe neni 317.

interesat e rëndësishëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i njëjti do të dënohet me dënim në para ose me burgim deri në një vit.

ZBULIMI I PAAUTORIZUAR I INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR TË PËRDORUR NË PROCEDURË GJYQËSORE OSE NË PROCEDURË TJETËR

Neni 104

Ai i cili në kundërshtim me ligjin, në mënyrë të paautorizuar do të zbulojë informacion të klasifikuar me nivel të klasifikimit "SEKRET SHTETËROR" për të cilin ka kuptuar në procedurë gjyqësore ose në procedurë tjetër, do të dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Nëse informacioni i klasifikuar është i nivelit të klasifikimit "TEPËR SEKRET" ose "SEKRET", kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri tre vjet.

Tentativa e veprës nga paragrafi 2 të këtij neni, është e dënueshme.

Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me dënim me para ose me burgim deri në një vit.

Neni 104 e përmban inkriminin e zbulimit të paautorizuar të informacionit të klasifikuar për të cilin personi ka kuptuar në procedurë gjyqësore ose në procedurë tjetër, e që është risi sa i përket akteve të deritanishme normative për informacionet e klasifikuara në këtë kuptim.

Për më tepër, në vend që një informacion i klasifikuar të deklasifikohet me qëllim që të përdoret në procedurë gjyqësore (si provë ose ngjashëm), me ç'rast do të humbiste kuptimi i klasifikimit meqë ky do të ishte një "kapixhik" për të ardhur në informata të cilat është e rëndësishme të jenë të fshehta dhe të mbrojtura, ligjvënësi e parashikon detyrimin për çdo person që ta ruaj fshehtësinë e informacioneve të klasifikuara, ndërsa për të cilat ai i ka kuptuar në ndonjë procedurë. Së këtijmi këtë nuk e kufizon vetëm për procedura gjyqësore por edhe për procedura të tjera, për shembull, për procedurën administrative, në mënyrë që të mbulohen të gjitha rastet e mundshme, madje edhe ato të cilat në praktikë janë shumë të rralla.

Nga ana tjetër, gjyqtari i cili vepron ndaj lëndëve të këtilla (si edhe prokurori publik, nëse bëhet fjalë për lëndë në të cilën ai ka kompetencë) duhet të posedojë certifikatë sigurie, ndërsa kjo dispozitë duhet t'i mbulojë pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, varësisht nga ajo se për çfarë procedure bëhet fjalë etj.

Cenimi i normës ndëshkuese juridike të këtillë prohibitive sanksionohet në mënyrë përkatëse me nivelin e klasifikimit të informacionit për të cilin bëhet fjalë në rastin konkret, kështu që mbi këtë bazë, detektohen disa forma të veprës.

Së këtijmi, ligjvënësi ka parashikuar se personi i cili në kundërshtim me ligjin në mënyrë të paautorizuar zbulon informacion të klasifikuar me nivel të klasifikimit "SEKRET SHTETËROR" për të cilin ka kuptuar në procedurë gjyqësore ose në një procedurë tjetër, do të dënohet me burgim deri në 5 vjet që nga aspekti ndëshkues juridik nënkupton

kornizë prej 30 ditësh deri në 5 vjet burgim.⁵⁸ Nëse informacioni i klasifikuar është i nivelit të klasifikimit "TEPËR SEKRET" ose "SEKRET" ligjvënësi ka parashikuar që kryerësi të dënohet me burgim prej një deri në tre vjet.

Tentativa për veprat nga paragrafi 1 dhe 2 është e dënueshme, me ç'rast tentativa për veprën nga paragrafi 1 dënohet në përputhje me dispozitën e përgjithshme për tentativë nga neni 19 të Kodit Penal,⁵⁹ ndërsa tentativa vepra nga paragrafi 2 nuk përfshihet me dispozitën e lartpërmendur të nenit 19 të Kodit Penal, kështu që ligjvënësi në këtë nen këtë e parashikon në mënyrë eksplicite.

Nëse vepra kryhet nga pakujdesia, në paragrafin e fundit të këtij neni është përcaktuar se kryerësi do të dënohet me dënim me para ose me burgim deri në një vit, që është më se e arsyeshme, meqë bëhet fjalë për kryerjen e veprave me formën më të lehtë të fajit-pakujdesi, ndërsa paragrafët 1 dhe 2 i përfshijnë format me dashje të veprës.

KREU I NËNTË

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 105

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit për informacione të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2004, 113/2007, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18), do të zbatohen deri në ditën e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj.

Për zbatimin e suksesshëm të dispozitave të Ligjit për informacione të klasifikuara(*) duhet të miratohen akte nënligjore me të cilat në detaje rregullohen veprime të caktuara. Në dispozitat kalimtare të nenit 105 ligjvënësi parashikon se aktet e këtilla nënligjore do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa deri atëherë do të zbatohen aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit për informacione të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/04, 113/07, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18).

Në lidhje me këtë dispozitë deri më tani janë miratuar aktet nënligjore si vijon:

- ▶ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularëve të pyetësorit të sigurisë dhe të certifikatave të sigurisë;⁶⁰
- ▶ Rregullore për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës për certifikatat e lëshuara të sigurisë dhe për pyetësorët e plotësuar të sigurisë dhe të evidencës së veçantë për lejet e lëshuara për qasje në informacione të klasifikuara;⁶¹
- ▶ Rregullore për mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese;⁶²
- ▶ Rregullore për mënyrën e nënshtrimit në provimin profesional për inspektorët e sigurisë së informacioneve të klasifikuara;⁶³
- ▶ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje;⁶⁴
- ▶ Rregullore për legjitimacionin dhe distinktivin zyrtar të inspektorit për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, si dhe për mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tyre;⁶⁵

⁶⁰ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 123/20.

⁶¹ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 150/20.

⁶² "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 246/20.

⁶³ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 219/20.

⁶⁴ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 181/20 dhe 285/20.

⁶⁵ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 240/20.

- ▶ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e vulës me dyllë të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe të mënyrës së vulosjes;⁶⁶
- ▶ Rregullore për formularin e legjitimacionit zyrtar të personave të punësuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara dhe për mënyrën e lëshimit të tij.⁶⁷

Në fazë harmonizimi me Sekretariatën e Legjislacionit janë draft-tekstet e akteve nënligjore si vijon:

- ▶ Urdhëresë për mënyrën e ruajtjes dhe trajtimit me informacione për përdorim të kufizuar, mënyrën e ndryshimit të nivelit të klasifikimit të informacionit, mënyrën e deklasifikimit të informacionit, mënyrën e përcaktimit të përdoruesve dhe kryerjen e diseminacionit të informacioneve të klasifikuara dhe të pranuar të huaja dhe masat dhe aktivitetet e sigurisë administrative të informacioneve të klasifikuara;
- ▶ Urdhëresë për sigurinë fizike të informacioneve të klasifikuara;
- ▶ Urdhëresë për sigurinë e personave përdorues të informacioneve të klasifikuara;
- ▶ Urdhëresë për siguri industriale të informacioneve të klasifikuara;
- ▶ Urdhëresë për sigurinë e sistemeve të komunikimit-informacionit.

Është hartuar edhe draft-teksti i udhëzimit për procesin e menaxhimit të riskut të sigurisë fizike të informacioneve të klasifikuara i cili pas miratimit të Urdhëresës së re për siguri fizike do të jetë objekt i harmonizimit me Sekretariatën e Legjislacionit në formë të rregullores.

Neni 106

Aktet normative të cilat i rregullojnë çështjet nga fusha e informacioneve të klasifikuara do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji brenda një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në nenin 106 është parashikuar që aktet normative të cilat i rregullojnë çështjet nga fusha e informacioneve të klasifikuara të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji brenda afatit prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Kjo, para së gjithash, e nënkupton ndryshimin e akteve të tjera normative, ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave përkatëse në ligje të tjerë materia e të cilëve ka pika të përbashkëta me mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, megjithatë në mënyrë të tërthortë e nënkupton edhe nevojën për ndryshime eventuale dhe shfuqizimin e dispozitave të Kodit Penal me të cilat do të përcaktohen sanksione dënuese edhe për nivelet e tjerë të informacioneve të klasifikuara (edhe pse një gjë e këtillë aktualisht është mbuluar me këtë ligj), dhe jo vetëm për informacionet të nivelit "SEKRET SHITETËROR"⁶⁸, si dhe shfuqizimin e dispozitave për zbulimin e sekretit ushtarak dhe dispozitave të tjera joefektive.

⁶⁶ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 187/20.

⁶⁷ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 53/21.

⁶⁸ Kodi Penal, neni 317.

Neni 107

Certifikatat e sigurisë të lëshuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejné deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Në nenin 107 ligjvënësi ka parashikuar se certifikatat e sigurisë të lëshuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të vlejné deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre. Me atë që në të vërtetë pengohet që certifikatat e vlefshme të pushojné të vlejné vetëm për shkak të miratimit të ligjit të ri, veçanërisht që nuk ka nevojë të ndërpritet kontinuiteti i vlefshmërisë së tyre deri në skadimin e tyre, dhe pas kësaj vazhdimi i vlefshmërisë së të njëjtave dhe lëshimi i certifikatave të reja të sigurisë do të bëhet konform ligjit të ri.

Mosekzistimi i kësaj dispozite mund të shkaktojë krizë në punën e trajtimit me informacione të klasifikuara meqë menjëherë të gjitha certifikatat e vlefshme të subjekteve relevante në shtet do të bëhen të pavlefshme, në Drejtori do të paraqitet një numër i madh i kërkesave për certifikata të reja, ndërsa puna në shumë institucione mund të bllokohet me muaj, duke e pasur parasysh faktin se procedura zakonisht zgjatë më shumë.

Neni 108

Drejtoria e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara është themeluar me Ligjin për informacione të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 9/2004, 113/2007, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18), nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon të punojë si Drejtori e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në përputhje me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj.

Ligjvënësi siguron vazhdimësi në punën e Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara e themeluar me Ligjin për informacionet e klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/04, 113/07, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18) me atë se në nenin 108 parashikon se nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji e njëjta vazhdon të punojë si Drejtori e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin e ri.

Neni 109

Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara i emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Në nenin 109 ligjvënësi ka parashikuar vazhdimësi edhe në punën e drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara i emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji me atë që e ka rregulluar se i njëjti vazhdon ta ushtroj funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 110

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për informacione të klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2004, 113/2007,

145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18).

Në nenin 110 ligjvënësi ka parashikuar se në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të pushojë të vlejë Ligji për informacionet e klasifikuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/04, 113/07, 145/10, 80/12, 41/14, 21/18 dhe 83/18), përkatësisht ligji paraprak me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e tij bëhet ligj i pavlefshëm.

Neni 111

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Në nenin e fundit 111 të këtij ligji është përcaktuar i ashtuquajtimi *vacatio legis*, përkatësisht periudha nga publikimi deri në hyrje në fuqi të ligjit, përkatësisht në këtë rast theksohet se hyrja në fuqi do të bëhet në ditën e tetë nga dita e publikimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

351.083.8(497.7)(094.5.072)

342.738(497.7)(094.5.072)

BAKRESKI, Oliver

Koment i ligjit për informacione të klasifikuara [Електронски извор] / Oliver Bakreski, Aleksandra Deanoska-Trendafilova. - Shkup : Qendra e gjenevës për kontrollin demokratik të forcave të armatosura - filiali Shkup DCAF, 2021

Начин на пристапување (URL):

<https://dcaf.ch/resources?type=publications>. - Начин на пристапување

(URL): <https://www.dbki.gov.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 116 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 01.07.2021. - Фусноти кон текстот
ISBN 978-608-66657-7-7

1. Deanoska-Trendafilova, Aleksandra [автор]

а) Класифицирани информации -- Заштита -- Македонија -- Коментирани закони

COBISS.MK-ID 54251525

